# ZGJIDHJE PËR MITROVICËN, JO NDARJE TË KOSOVËS

Raporti për Evropë nr.165 -- 13 shtator 2005

International Crisis Group
WORKING TO PREVENT
CONFLICT WORLDWIDE

## PËRMBAJTJA


**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME** ............ i

**I. HYRJE** ............ 1

**II. MITROVICA DHE VERIU** ............ 3

A. RAJONI DHE HISTORIA E TIJ ............ 3

B. MITROVICA PAS VITIT 1999 ............ 4

C. TRI KOMUNAT VERIORE ............ 6

**III. AKTERËT KRYESOR DHE INTEGRITETI TERRITORIAL I KOSOVËS** ............ 8

A. BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE ............ 8

B. BEOGRADI ............ 8

C. SHQIPTARËT E KOSOVËS ............ 9

D. SERBËT E VERIUT ............ 10

**IV. NATYRA E NDARJES** ............ 12

A. NJË QYTET I NDARË NË DYSH ............ 12

1. Topografia urbane e ndarjes ............ 12
2. Ndarja e nxitur nga një ekonomi e rrënuar ............ 12
3. Gjykatat ............ 13
4. Krijimi i një strehe në zonën e pakontrolluar ............ 14

B. MJEDISI I PAFAVORSHËM PËR KTHIME ............ 15

1. Të zhvendosurit ............ 15
2. Multietniciteti i kontrolluar ............ 16

C. MUNGESA E LIDERSHIPIT ............ 17

1. Duke Qëndruar nën parapet ............ 17
2. Të ndikuarit në opinion ............ 18

D. MITROVICA SI OFRUESE SHËRBIMESH ............ 20

**V. ÇELËSI I SIGURISË** ............ 23

A. VERIU JO I QETË ............ 23

1. Mjedisi strategjik ............ 23
2. Frika nga sulmi ............ 24

B. SIGURIA E MITROVICËS NË POZICION PAT ............ 25

1. Frikësimi i UNMIK-ut ............ 25
2. Gara për vendosje? ............ 26

C. TRANSFERIMI I POLICISË ............ 27

1. Heqja e zonave tamponë ............ 27
2. SHPK-ja e dobët në Veri të Mitrovicës dhe hijet e saj të fuqishme ............ 28
3. Komanda policore rajonale ............ 29

**VI. PROJEKTIMI I ZGJIDHJES** ............ 31

A. PROCESI ..... 31
1. Afati kohor ..... 31
2. Ndërtimi i kapaciteteve ..... 32
3. Ndërtimi i një vizioni për marrëveshje ..... 33
B. SUBSTANCIALE ..... 34
1. Transformimi i shërbimeve ..... 34
2. Organizimi i ri komunal i Mitrovicës ..... 35
3. Hapësirë për unifikim ..... 36
4. Ekonomia e qytetit ..... 36
5. Marrëveshet për sigurinë për veriun e Kosovës ..... 36
6. Strukturimi në Kontestin e Përgjithshm ..... 37

**SHTOJCAT**

A. HARTA E KOSOVËS ..... 40
B. HARTA E VERIUT TË KOSOVËS ..... 41
C. HARTA E MITROVICËS ..... 42
D. INDEXI I SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE ..... 43
E. PËR GRUPIN NDËRKOMBËTAR TË KRIZAVE ..... 44
F. RAPORTET DHE PUBLIKIMET TJERA PËR EVROPË TË GRUPIT TË KRIZAVE ..... 45
G. ANËTARËT E BORDIT TË GRUPIT TË KRIZAVE ..... 47

# ZGJIDHJE PËR MITROVICËN, JO NDARJE TË KOSOVËS

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Komuniteti ndërkombëtar me të drejtë ka deklaruar që statusi përfundimtar i Kosovës nuk duhet të përfshijë si mundësi ndarjen e territorit të saj. Mirëpo, ky deklarim nuk është mbështetur me veprime të mjaftueshme. Politika e Beogradit për të kërkuar një formë të ndarjes, është edhe më e fuqishme në qytetin e padëgjueshëm dhe të pa qetë verior të Mitrovicës dhe në brendësinë e saj. Për të shpëtuar apo evituar këtë situatë nevojitet një përpjekje e madhe politike, financiare dhe e sigurisë. Kapacitetet e nevojshme duhen ndërtuar menjëherë, dhe implementimi i tyre duhet të fillojë sapo Grupi i Kontaktit të deklarojë mbështetjen e vet për të ardhmen e Kosovës si shtet funksional me pavarësi të kushtëzuar brenda kufijve ekzistues.

Ruajtja e integritetit territorial është një politikë e drejtë sepse ndarja do të provokonte dyndje dhe shkëmbime të mëtutjeshme të popullatës brenda Kosovës dhe jostabilitet gjetiu në Ballkan, posaçërisht në Maqedoninë fqinje. Mirpo, ndarja mbetet një çështje aktuale, jo vetëm për faktin se ne Mitrovicë, Kosova është e ndarë në lumin Ibër dhe po ndahet gjithnjë e më shumë, por ngase misioni i KB-së (UNMIK-u) dhe forca e sigurisë e udhëhequr nga NATO (KFOR-i) kanë dështuar në zbatimin e mandatit të tyre. Në veriun e Mitrovicës dhe në komunitetet fqinje deri në kufi, hapësirë kjo që përmban ndoshta një të tretën e të gjithë serbëve të mbetur në Kosovë, Beogradi përpiqet që të ushtrojë ndikimin e vet përmes strukturave paralele qeverisëse, përfshirë këtu edhe prezencën e një policie që është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së.

Zgjidhja e çështjes së Mitrovicës në fazën e hershme të procesit të zgjidhjes së statusit përfundimtar presupozon paraprakisht kahjen e përgjithshme në të cilën shkon Kosova. Por, tani është koha që shtetet anëtare të Grupit të Kontaktit të ndalen së foluri për statusin përfundimtar si një proces i hapur me shumë opcione. Në fakt, prapa dyerve të mbyllura konsensusi ndërkombëtar tashmë po merr formë. Fillimi i manifestimit të këtij koncensusi, dhe forcimi i tij në Mitrovicë, do t'i kontribuonte një cikli të drejtë të stabilitetit dhe vizionit. Të lejohet që Mitrovica të shmanget nga kursi i paraparë rrezikon që çështja të realizohet ndyshe nga koncensusi i arritur.

Pavarësisht se për gjashtë vjet me radhë nuk është shënuar asnjë progres, Mitrovica nuk është e mbyllur ndaj transformime, transformimet mund te depërtojnë, të cilat do të rrisnin mundësitë për bashkimin e Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare do të duhej që të investonte kapital dhe energji për mbështetjen e një programi të qartë dhe të artikuluar për kompromis midis kërkesave maksimale të të dyja palëve. Hapi i parë do të duhej që, për periudhën përcaktuese për statusin, të emërohet një Përfaqësues Special për Mitrovicën, në rang të njëjtë me Zëvendës Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe me kompetencë të plotë që të koordinojë përpjekjet e nevojshme.

UNMIK-u dhe KFOR-i duhet që, nën drejtimin e Komisionerit special, të rimarrin me shpejtësi iniciativën për siguri në veri të lumit Ibër duke rritur nivelin e forcave dhe nivelin e sigurisë. KFOR-i në mënyrë të qartë duhet që Mitrovicën dhe veriun e saj ta vendos në fokus të operacioneve primare dhe të bëjë ristrukturimin e vet në përputhje me rrethanat atje. Stacionet ilegale të policisë së Beogradit duhet të largohen nga veriu i Kosovës, dhe Përfaqësuesi Special i zgjedhur duhet të negociojë zëvendësimin e radikalistëve obstrutiv (pengues) që udhëheqin atje me spitalin rajonal dhe me universitetin. Planet që komanda e brishtë policore rajonale e qytetit të Mitrovicës së ndarë etnikisht të transferohet në kontrollin vendor duhet të shtyhet derisa Përfaqësuesi Special të sigurojë një konsensus të zbatueshëm të sigurisë midis shqiptarëve dhe serbëve për veriun që barazpeshon ruajtjen e integritetit territorial me frikën e serbëve nga mbidominimi.

Me mbajtjen e gjendjes së sigurisë nën një kontroll më të mirë, korniza e zgjidhjes e cila duhet të ndiqet me përkushtim dhe me ngulm më të madh do të mund të përfshinte krijimin e një autoriteti komunal të ri për veriun e Mitrovicës. Ky autoritet do të ofronte siguri dhe përgjegjësi në adresimin e çështjes së kthimit të shqiptarëve, si dhe në krijimin e një qarku administrativ

qëndror i cili do të përdorej bashkarisht nga komuna e tashme e Mitrovicës dhe nga njësia e re e veriut të Mitrovicës ku do të vendosej bordi i përbashkët i qytetit për të pranuar nga donatorët fonde për zhvillimin e qytetit.

Nevojë strategjike është inkurajimi i serbëve të veriut të Kosovës -- dhe i Beogradit -- për të menduar më shumë për veriun e Mitrovicës që ajo pjesë të bëhet qendër e një përpjekjeje për të ofruar shërbime për të gjithë serbët e Kosovës. Qëllimi i bashkimit të anëve të lumit me një shtrirje të gjërë në qarkun qendror do të mund të reflektohej me bartjen e dy apo tre ministrive nga kryeqyteti; vendosjen atje të Gjykatës Supreme; mundësisht hapjen e një stacioni televiziv në gjuhën serbe që do të mbulonte tërë Kosovën; si dhe me vendosjen e disa elementeve të qeverisë qendrore të Kosovës të cilat do të përshtatmërisht do të ofrojnë një sistem autonom arsimor, shëndetësor, dhe të shërbimeve tjera sociale për serbët. Bashkësia ndërkombëtare dhe qeveria e Kosovës duhet të synojnë që brenda një kornize të caktuar kohore të inkorporojnë në këtë sistem strukturat paralele të Beogradit duke ofruar fonde të përshtatshme dhe një rol bashkëpunues dhe të garantuar për qeverinë e Serbisë.

Pa e njohur statusin e tij zyrtar të entitetit sipas modelit të Bosnës dhe Hercegovinës, veriut serb duhet t'i ofrohen elemente të autonomisë, përfshirë kompetencat e transferuara për komunat, liri për komunat që të lidhen në bazë vullnetare, si dhe rol koordinues dhe resourse të mudësuara dhe ofruara përmes njësive të propozuara serbe të ministrive të Qeverisë së Kosovës. Shqiptarët të bindur se mbështetja për pjesëmarrje në këto iniciativa, për t'iu dhënë shansë për sukses komunave të reja me shumicë serbe edhe në pjesë tjera të Kosovës, do të shuanin presionin për ndarje në vijën e lumit Ibër.

Thënë shkurt, nëse faktet nga terreni në Mitrovicë dhe madje edhe nëse dhuna do të përëritej nuk do të shkatërronte perspektivën për një zgjidhje stabile të statusit të Kosovës, bashkësia ndërkombëtare duhet të punojë edhe më shumë dhe në mënyrë kreative për të ndryshuar të menduarit strategjik të serbëve si dhe t'jua bëjë të njohur shqiptarëve nevojën për të marr pjesë në një ofertë konstruktive. Deklaratat kundër ndarjes, fatkeqësisht, nuk janë të vetërealizueshme.

## REKOMANDIMET

### *Hapat paraprakë, deri në fund të tetorit të vitit 2005*

### Për Grupin e Kontaktit dhe shtetet e tij anëtare si dhe për Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së:

1. Të emërohet një Përfaqësues Special për Mitrovicën, në rangun e Zëvendës Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së që të mbajë detyrën së paku deri në fund të vitit 2006, dhe i preferuar për këtë do të ishte dikush me të kaluar ushtarake dhe me përvojë implementuese në rrafshin civil.

2. Të përforcohen dhe të rikonfigurohen forcat ndërkombëtare të sigurisë në Mitrovicë dhe në veri të Kosovës duke zëvendësuar brigadën shumëkombëshe të veri-lindjes të komanduar nga KFOR-i francez me një forcë të dizenjuar që nga afër të mbështes Komisionerin Special, dhe duke formuar një njësi policore speciale ndërkombëtare paraushtarake siç është Forca e re e Xhandarmërisë Evropiane, e cila do të ishte nën kontrollin e drejtpërdrejt të Komisionerit Special.

3. Të përcaktohet platforma për zgjidhje të çështjes së Mitrovicës duke deklaruar qartë dhe publikisht se zgjidhja e preferuar e Grupit të Kontaktit për Kosovën është shtet funksional me pavarësi të kushtëzuar.

4. Të ftohet Beogradi që të marr pjesë në negociatat midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës për decentralizim me mbështejtejn dhe nën patronazhin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, me kusht që ai të pranojë deklaratën paraprirëse të Grupit të Kontaktit.

5. Të alokojnë, së bashku me BE-në, fonde për një program investimi në shumë aspekte në Mitrovicë.

### Për UNMIK-un:

6. Të ketë qasje më të matur në transferimin e komandave policore tek Shërbimi Policor i Kosovës në rajonin e Mitrovicës gjatë kohës së pritjes së zgjidhjes së statusit përfundimtar, të vendos policë ndërkombëtar dhe zyrtarë doganorë në kalimet kufitare në Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe të formojë një zinxhir komandues të modifikuar, duke i dhënë kështu Komisionerit Special kontroll mbi forcat e reja policore ndërkombëtare paraushtarake që do të vendoseshin në rajonin e Mitrovicës.

7. Të aktivizojë grupet punuese të partive shqiptare për statusin përfundimtar të Kosovës që të fillojnë të zhvillojnë një kornizë për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës dhe të veriut të Kosovës brenda parametrave që përjashtojnë ndarjen, që kushtëzojnë decentralizimin e vërtetë dhe që inkurajojnë kthime të sigurta të banorëve të mëparshëm në shtëpitë e tyre në të dy anët e lumit Ibër. Paralelisht me këtë, e njëjta gjë të bëhet me serbët përmes kryebashkiakëve të të tre komunave veriore, lidershipit të Listës serbe për Kosovë dhe Metohi, dhe (ndoshta në mënyrë indirekte) me Këshillin nacional serb.

8. Të bëhen përpjekje më të përkushtuara për edukimin e serbëve dhe shqiptarëve në Mitrovicë

lidhur me zhvillimet dhe kushtet ekzistuese në anën tjetër të lumit Ibër të ndarë duke mbështetur programe të reja për informimin e publikut dhe duke inkurajuar lajme relevante në mediat e tyre përkatëse lidhur me pjesën tjetër.

## Për Institucionet e Përkohshme të Vet-Qeverisjes (IPVQ) në Prishtinë:

9. Përmes grupeve punuese për statusin përfundimtar, në frymë konstruktive, të studiohet dhe përgatitet opinioni publik në Mitrovicë dhe kudo në Kosovë për opcionet e ndryshme të riorganizimit të Mitrovicës.

10. Të mundësohet krijimi i më shumë njësive komunale me shumicë serbe në jug të Ibrit, veçanërisht një komunë më e madhe e Graçanicës, që do të vepronte si kundërpeshë ndaj presionin e serbëve për ndarje.

## Për Beogradin:

11. Të bashkëpunojë me Komisionerin Special në identifikimin e kandidatëve të besueshëm për të udhëhequr universitetin dhe spitalin rajonal të Mitrovicës.

12. Të përgatisë mbylljen e stacioneve policore dhe gjykatave paralele në veriun e Kosovës, duke përfshirë negocijimin me Komisionerin Special për ofrimin e një sigurie të besueshme dhe plotësimin e vendeve të zbrazëta që mund të sjell largimi i tyre.

13. Të fillojë me dizajnimin e një strukture e cila bashkarisht me IPVQ-të do të merrte përgjegjësi që, për të gjithë serbët e Kosovës, të mbështeste një skeme joterritoriale për shërbime autonome shëndetësore, arsimore dhe sociale autonome për të gjithë serbët e Kosovës.

## *Hapat e negociatave, nga nëntori i vitit 2005*

## Për IPVQ-në/Grupet Punuese për Statusin Përfundimtar të Kosovës:

14. T'ju bëjnë serbëve një ofertë fisnike, përfshirë:

    (a) Gatishmërinë për të negociuar lidhur me mekanizmat për demilitarizim dhe mbikëqyrjen e përbashkët me serbët të sigurisë në rajonin e Mitrovicës, si dhe pajtueshmërinë se komunat e serbëve do të kenë fjalën e fundit në emërimin e shefave të tyre të policisë;

    (b) Gatishmërinë për të pranuar një komunë serbe në Mitrovicë e cila do të udhëhiqej nga një bord i përbashkët koordinues i qytetit që do të luante një rol unifikues për qytetin e Kosovës, dhe cili do të punonte për përmirësimin e të drejtave të shqiptarëve të zhvendosur brenda vendit;

    (c) Gatishmërinë që serbëve t'ju jipet hapësirë në qeverinë dhe institucionet qendrore, si p.sh duke zhvendosur disa prej tyre nga Prishtina në Mitrovicë (dhe në Graçanicë), dhe duke iu ofruar serbëve një post të zëvendës kryeministrit; dhe

    (d) Garancionet si shtetësia e dyfishtë, kufiri i hapur me Serbinë, dhe lidhjet telefonike me Serbinë të jenë me tarifa lokale (tarifa jo ndërkomëtare)

## Për Komisionerin Special për Mitrovicë:

15. Të konsultohet hollësisht dhe gjerësisht dhe të vendos deri në fund të vitit 2005 lidhur me modelet e administrimit dhe rolin e ardhshëm të qytetit:

    (a) nëse veriu i Mitrovicës duhet të jetë komunë më vete apo e kombinuar me Zveçanin;

    (b) lidhur me territorin e një qarku qendror ndërkomunal; dhe

    (c) lidhur me të drejtat zgjedhore të banorëve të saj, dhe të formës së ndonjë bordi të përbashkët të qytetit.

16. Të krijohet një trup koordinues për siguri serbo-shqiptaro-ndërkombëtar, me seli në qendër të Mitrovicës, i cili do të kërkonte konsensus lidhur me konceptin e sigurisë në rajonin e Mitrovicës dhe përfundimisht do të mbikëqyrte procesin e demilitarizimit.

17. Të mbikëqyrë dhe nëse është e nevojshme të përcaktojë si dhe (me ndihmën e KFOR-it) të zbatojë, deri në nëntor të vitit 2005, përzgjedhjen e drejtuesve të rinj të universitetit dhe spitalit rajonal.

## *Hapat për implementim, nga fillimi deri në fund të vitit 2006*

## Për Komisionerin Special:

18. Të dizenjojë në veriun e Mitrovicës një komunë të re me shumicë serbe, një qark qendror ndërkomunal dhe një bord koordinues të qytetit; të themelojë një sistem automatik të financimit për administratën dhe projektet e bordit të përbashkët në kuadër të buxheteve të komunave të veriut dhe të jugut të Mitrovicës; dhe të vendosë nëse në veri, fillimisht, të emërojë këshilltarët apo të fillojë menjëherë me zgjedhje komunale.

19. Të mbikëqyrë kthimin e shqipëtarëve në veri të Mitrovicës.

20. Të mbikëqyrë krijimin e fondeve përcjellëse për institucionet shërbyese të vendosura në Mitrovicë, përfshirë këtu spitalin rajonal, unversitetin, një kanal të ri televiziv publik në gjuhën serbe (RTK-2), dhe krijimin e një njësie të përbashkët Qendër Koordinuese/Ministri e Ekonomisë dhe Financave të Kosovës për rregullimin e strukturave paralele serbe në tërë Kosovën si një sistem autonom joterritorial për të ofruar shërbime arsimore, shëndetësore dhe sociale për serbët.

21. Të përgatisë terrenin për një marrëveshje midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës për menaxhimin e sigurisë në veri duke mbikëqyrë shpërbërjen e detyrueshme të stacioneve policore të Beogradit (MUP) në veri të Kosovës dhe implementimin e çdo lloj vendimi të arritur nga trupi i përbashkët koordinues për siguri lidhur me komandën rajonale të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës që ndodhet në jug të Mitrovicës.

22. Të mbikëqyrë futjen në përdorim dhe në fuqi të targave të Kosovës në veri të lumit Ibër.

### Për IPVQ/Grupet Punuese për Statusin Përfundimtar të Kosovës:

23. Të kërkojë partnerë serbë në Mitrovicë dhe në veri të Kosovës me të cilët do të arrihej pajtimi mbi menaxhimin e sigurisë së veriut, dhe të marrin në konsideratë mekanizma dhe teknika të caktuara si trupa të përbashkët mbikëqyrës, skema të rregullta të rotacionit, dhe personelit ndëkombëtar t'i lihen disa përgjegjësi ashtu që sovraniteti i Kosovës të mund të ushtrohet në përputhshmëri me brengat e serbëve që kanë ne lidhje me dominimin e mundshëm shquiptar.

24. Të krijojë njësi të reja të ministrive me personel shumicë serbë -- në Mitrovicë, Graçanicë dhe Prishtinë -- për të administruar sistemin e ri autonom të arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale për serbët në tërë Kosovën dhe t'i ofrohen Qeverisë së Serbisë mundësi për bashkëpunim në këtë sistem shërbimesh.

25. Të transferojë disa institucione qendrore të Kosovës në qarkun qendror të Mitrovicës, si p.sh. dy apo tri ministri dhe Gjykatën Supreme, si dhe të mbështetet krijimin i një kanali televiziv në gjuhën serbe (RTK-2) atje duke u mundësuar transmetimi i tij në tërë Kosovën.

26. Të ofrojë dispozita kushtetuese që, pa pranuar statusin zyrtar të entitetit, do t'iu lejonte zonave serbe që të ndërtojnë de facto autonominë, duke përfshirë transferimin domethënës të kompetencave tek komunat; liri për komunat që të bashkëpunojnë në baza vullnetare; si dhe rol koordinues dhe të resurseve të ofruara nga njësitë e reja serbe të krijuara si pjesë e ministrive qeveritare për të administruar sistemin arsimor, shëndetësor dhe shërbimet sociale.

**Prishtinë/Beograd/Bruksel, 13 shtator 2005**

International Crisis Group
WORKING TO PREVENT
CONFLICT WORLDWIDE

**Raporti për Evropë nr.165** **13 shtator 2005**

# ZGJIDHJE PËR MITROVICËN, JO NDARJE TË KOSOVËS

## I. HYRJE

Qyteti i ndarë i Mitrovicës e sfidon statusin e ardhshëm të Kosovës. Lumi Ibër që kalon nëpër të, jo vetëm që shënon kufijtë ku autoriteti i misionit të KB-së (UNMIK-u) dhe dominimi shqiptar lënë vend për rezistencën serbe dhe ndikimin e fuqishëm të vazhdueshëm të Beogradit, por ndarja de facto dhe shkëmbimet e popullatës së qytetit janë dukshëm në kundërshtim me vizionin e bashkësisë ndërkombëtare për një Kosovë të pandarë dhe multietnike.

Qyteti gjatë shpërthimeve periodike të dhunës priret të prezantohet vetëm si vend eruptiv dhe violent.[1] Por, për gjashtë vjet UNMIK-u dhe forca paqeruajtëse e udhëhequr nga NATO (KFOR-i) kanë dështuar në zbatimin e mandatit të tyre dhe heshturazi kanë pranuar patrullimet të cilat kanë zëvendësuar masat e sigurisë duke mbajtur disa mijëra njerëz larg shtëpive të tyre në anën e kundërt të bregut të lumit. Deri në kohën kur ndodhën trazirat e marsit të vitit 2004, KB-ja përfaqësonte pothuaj tërë Kosovën si një territor ku po arrihej progres i ngadalshëm drejt multietnicitetit falë politikës së "Standardeve para statusit", në të cilin territor Mitrovica dallohej si një anomali e shëmtuar.[2] Megjithatë, trazirat kishin efekt shkatërrues. Bashkësia ndërkombëtare kishte pushuar së mbështeturi sinqerisht Kosovën e dominuar nga shqiptarët si mjet për realizimin e multietnicitetit. Në vend të ndërtimit të autoritetit qendror në Prishtinë, si garantues i vlerave të civilizuara, tani kërkon që kompetencat në Kosovë të fragmentohen përmes decentralizimit përgjatë kufijve të brendshëm etnik.

Në fakt, bashkësia ndërkombëtare, për gjashtë vjet me radhë, në Mitrovicë ka ndjekur politika dykuptimëshe, në kundërthënie me synimin e deklaruar për multietnicitet në Kosovë. Si masë e arsyeshme, në verën e vitit 1999 KFOR-i kishte ndarë me kordonë veriun e Mitrovicës dhe zonat e brendshme të saj për të krijuar një vend të sigurtë për serbët si masë kundër marrjes nën kontroll nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe të parandalonte spastrimet etnike që po ndodhnin në pjesët tjera të Kosovës. Megjithatë, në shkurt të vitit 2000 KFOR-i bëri shumë pak që të parandalonte serbët atje që të përshpejtonin me forcë shkëmbimin e popullatës. Kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së (PSSP) Michael Steiner, në fund të vitit 2002, vendosi një administrim të përkohshëm të UNMIK-ut për veriun e Mitrovicës, ai pas zhvendosjes së dhunshme të popullatës i akordoi kësaj administrate legjitimitet në bazë të shumicës së re de facto serbe. Kjo ra ndesh me praktikat e komunitetit ndërkombëtar në pjesët tjera të Kosovës (dhe në Bosnjë). Megjithëse para luftës shqiptarët përbënin afërsisht gjysmën e popullatës së veriut të Mitrovicës, vetëm serbët ishin të ftuar që të aplikonin në poste, dhe bordi këshillues i emëruar nga zytarët e zgjedhur përbëhej nga gjashtë serbë dhe vetëm një shqiptar.[3]

A duhet që së pari të zgjidhet çështja e Mitrovicës në mënyrë që të zgjidhet statusi i Kosovës, apo zgjidhja e kësaj të fundit do të jetë çelës për zgjidhjen e çështjes së Mitrovicës? Kjo pyetje është parashtruar dhe me afrimin e procesit të statusit përfundimtar po shtrohet gjithnjë e më shpesh. Por, kjo nuk është vetëm një pyetje që përsëritet shpesh. Mitrovica dhe bagazhi i saj do të kenë ndikim të madhë në cilësinë e zgjidhjes së përgjithshme për Kosovën. Çfarë do të ndodhë në dy kilometra katrorë të

[1] Ky është një ritëm poashtu i vëzhguar nga Grupi i Krizave në raportet e publikuara pas incidenteve të njëpasnjëshme të dhunës masive në Mitrovicë në shkurt të vitit 2000, në prill të vitit 2002 dhe mars të vitit 2004. Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.96, *Grackë për Kosovën: Tejkalimi i Ndarjes së Mitrovicës*, 31 maj 2000; Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.131, *Albatrosi Kosovar I UNMI-ut: Gozhdimi i Ndarjes nëMitrovicë*, 3 qershor 2002; dhe Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.155, *Kolapsi në Kosovë*, 22 prill 2004.

[2] Së pari e përkrahur nga UNMIK-u në prill të vitit 2002, kjo politikë fitoi mbështetjen e Grupit të Kontaktit dhe hyri në "funksion" në fund të vitit 2003. Bazuar në të, Institucioneve të Përkohshme të Vet-Qeverisjes të Kosovës (IPVQ) iu caktuan standardet në një sërë fushash si qeverisja dhe të drejtat e njeriut, siç janë liria e lëvizjes dhe kthimi i komuniteteve të zhvendosura. Bashkësia ndërkombëtare theksoi se do të shpërblente të arriturat duke inicuar një proces për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Grupi i Kontaktit, i krijuar në vitin 1994, koordinon politikat e shteteve kryesore të interesuara për Ballkanin. Ai ka luajtur një rol të rëndësishëm në negociatat e mëparshme për Bosnjën dhe Kosovën. Gjashtë anëtarët e tij janë: SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia.

[3] Bordi gjithashtu përfshin edhe një boshnjak.

veriut të Mitrovicës do ketë ndikim në aranzhimet e pjesës tjetër të Kosovës prej 10,875 kilometrave katrorë.

Edhe pse -- siç treguan trazirat e marsit të vitit 2004 -- autoriteti i UNMIK-ut është i dobët në tërë Kosovën, ai veçanërisht është i sfiduar në veriun e Mitrovicës, e vetmja pjesë që është ende nën administrim direkt të UNMIK-ut. Popullata e saj serbe atje mezi toleron prezencën dhe institucionet e UNMIK-ut, të cilat i sheh si agjent të një projekti shqiptar për një Kosovë të pavarur, dhe në vend që t'i respektojnë ato ata bëhen lojalë ndaj Beogradit, institucioneve të tij paralele dhe nënkontraktuesit politik lokal, Këshillit Nacional Serb (KNS). Serbia e ka mbajtur veriun e Mitrovicës për të penguar kontrollin e UNMIK-ut dhe të shqiptarëve në Kosovë dhe si një letër për t'u luajtur në procesin e statusit përfundimtar. Tutje Mitrovicës, tri komunat veriore të dominuara nga serbët Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi janë rreshtuar plotësisht në institucionet e Kosovës të krijuara nga UNMIK-u, siç janë autoritetet e zgjedhura komunale, Shërbimi Policor i Kosovës (ShPK) dhe gjykatat e UNMIK-ut. Mirëpo, institucionet qeveritare paralele serbe -- arsimi, shëndetësia, sigurimi social, drejtësia dhe të tjera -- si dhe autoriteti politik i kombinuar i Beogradit dhe KNS-së poashtu e balancojnë autoritetin e UNMIK-ut atje, ku kufiri me Serbinë e bën popullatën shumicë më të guximshme se sa në enklavat më të brishta serbe në Kosovën qendrore. Sistemi i telefonisë është riintegruar me atë të Serbisë, dhe shumica e banorëve shpresojnë se do të pasojnë edhe lidhje të tjera të shërbimeve.

Veriu i Mitrovicës është qendra e fundit domethënëse urbane serbe e mbetur në Kosovë. Përafërsisht 15,000 serbët që tani jetojnë atje frikësohen se do të rrezikohen dhe do të ndiqen nga 60,000-70,000 shqiptarët e jugut të qytetit. Një e treta e këtyre serbëve ishin zhvendosur nga pjesët tjera të Kosovës dhe insistojnë që, nëse nuk mund të kthehen të sigurtë në shtëpitë e tyre, shqiptarët nuk duhet të kenë pretendime legjitime për t'u kthyer në veriun e Mitrovicës.

Pafuqia e UNMIK-ut për ta kontrolluar veriun e Mitrovicës ilustrohet në shumë mënyra. Përgjegjësit për sulmet mbi policinë e UNMIK-ut apo për vrasjen e shqiptarëve gjatë pesë vjetëve të fundit ende nuk janë arrestuar. Shumë vetura atje më parë lëvizin pa targa se sa të përdorin targat e Kosovës. UNMIK-u ishte i shtrënguar të protestojë pafuqishëm kur ministria e arsimit të Serbisë në maj të vitit 2004 e emëroi radikalistin e kohës së Millosheviqit Radivoje Papoviqin si rektor të ri të universtetit në veriun e Mitrovicës dhe ai i cili shkëputi lidhjet e sapokrijuara të këtij universiteti me UNMIK-un dhe me ministrinë e arsimit të Kosovës.

Me zvogëlimin e pranisë së UNMIK-ut dhe përgatitjeve të tij që në muajt në vijim të transferojë kompetencat për policinë dhe drejtësinë tek institucionet vendore në Mitrovicë dhe në veri, ku konfliktit shqiptaro-serb mezi i është dhënë fund, bashkësia ndërkombëtare duhet që më në fund të mbrojë bindshëm autoritetin e saj. Çdo prishje apo rrezikim i rendit do të kishte pasoja për pjesën tjetër të Kosovës.

# II. MITROVICA DHE VERIU

## A. RAJONI DHE HISTORIA E TIJ

Mitrovica gjendet në skajin verior të Kosovës, që kufizohet me kodrat e Shalës që shtrihen në drejtimin verior nga krahu i saj lindor, dhe lumin Ibër i cili rrjedh në qytet nga perëndimi dhe kthehet kah veriu nëpër një luginë të ngushtë që çon drejt vendit që dikur ishte zemra e mbretërisë mesjetare serbe. Në jug të Mitrovicës, lugina e lumit Sitnica zgjerohet drejt Kosovës qendrore, duke e bërë kështu qytetin portë natyrale midis Kosovës dhe Serbisë. Mbetjet e kalasë së Zveçanit, që ruante minierat e Mitrovicës gjatë periudhës së sundimit Bizantin, zënë vend në një kep të lartë në veri të qendrës së qytetit. Në vitet 1180-ta shteti mesjetar serb u zgjerua në këto rajone, të cilat mbetën nën kontrollin serb deri në mesin e shekullit XV, kur Turqit e futën në kontrollin e Perandorisë Otomane. Nën pushtimin Otoman, Mitrovica ishte një qytet i kthyer në një garnizon përmes të cilës kalonte një linjë të rëndësishme e tregtisë me argjend.

Aty afër ku është edhe sot, Trepça ka qenë minierë që nga mesjeta. Mitrovica në shekullin XIX u zhvillua si një qendër industriale e lidhur me kompleks minierash. Gjatë periudhës së Jugosllavisë, qyteti dhe kompleksi përcjellës ishte një sinonim, me afërsisht 20,000 vende pune që vareshin nga Trepça. Ndonëse që nga vitet 1980-ta e pa aftë për të sjell profit dhe me nevoja për investime të reja masive dhe ndoshta joekonomike për të ristartuar prodhimin në shkallë të gjerë, kompleksi ende shikohet si një trofe i çmueshëm nga të dy palët si nga shqiptarët ashtu edhe nga serbët.[4] Me Trepçën e cila nuk ka prodhuar asgjë që nga fillimi i vitit 2000 e deri në gushtin e vitit 2005 kur rifilloi puna ekserimentale në disa miniera. Duhet konstatuar se një vrimë e zezë ekonomike e ka gllabëruar Mitrovicën, duke kontribuar kështu në çrregullimet tjera të shkaktuara nga ndarja e qytetit.

Derisa nuk ishte i ndarë, qyteti shërbente si udhëkryq natyral rajonal: me Malin e Zi në perëndim, Sanxhakun në Veriperëndim, dhe me Beogradin në Veri. Një linjë e vjetër hekurudhore e shoqëron linjën magjistrale dhe veriun e lumit Ibër, që lidhet me Rashkën, Kralevën dhe Beogradin e përtej. Magjistralja e dytë vazhdon në perëndim nga jugu i Mitrovicës, duke e shoqëruar lumin Ibër dhe liqenin e gjatë të Gazivodës prej nga lidhet përmes Zubin Potokut me Malin e Zi dhe me detin Adriatik. Me linjën e vet hekurudhore ekzistuese jofunksionale veri-jug, dhe me magjistralen e re të projektuar për lëvizje në lindje-perëndim e cila do të shkonte nga Nishi përmes Kosovës qendrore deri në Durrës, Mitrovica rrezikon të anashkalohet.

Rajoni i Mitrovicës ishte një nga vatrat e lëvizjes kombëtare shqiptare. Rregullimet administrative otomane për një periudhë e vendosën atë në Vilajetin e Kosovës, edhe pse për një kohë, ishte pjesë e Sanxhakut të Novi Pazarit, qark administrativ me gjuhën serbo-kroate si zyrtare që mbulonte pjesë të Malit të Zi dhe të Serbisë dhe që shtrihej deri në juglindje të Bosnjës.[5] Mitrovica mbeti pjesë e Sanxhakut deri në Luftën e Parë Ballkanike më 1912, kur Serbia e rimori dhe e inkorporoi atë në një qark të veçantë, të ashtuquajtur "Territoret e Reja" apo "Serbia e Vjetër". Falë pozitës gjeografike, Mitrovica nuk ishte konsideruar gjithmonë pjesë e Kosovës, dhe kjo vazhdoi deri në gjysmën e dytë të shekullit XX kur autoritetet komuniste të Jugosllavisë në mënyrë administrative i bashkuan ato. Kontrolli gjerman në Luftën e Dytë Botërore përsëri ndau këtë rajon nga Kosova qendrore (të administruar nga Italia).

Mitrovica u shpall qytet në vitin 1947 dhe shtatë vjet më vonë u vendos që ajo të bëhet një nga pesë rajonet e Kosovës, me dhjetë njësi përbërëse të vogla komunale. Rajonet ishin shpërbërë në favor të komunave më të mëdha gjatë riorganizimit territorial të viteve 1959-1960. Pesë komunat që u krijuan në rajonin e Mitrovicës janë: Vushtrria, Mitrovica, Zubin Potoku, Leposaviqi dhe Skenderaj. Gjatë fundit të viteve 1940-ta dhe 1950-ta, u bënë ndërrime të kufijve të Kosovës brenda Serbisë. Qarku verior i Leshakut u shkëput nga Serbia dhe i ishte bashkuar komunës së Leposaviqit. Në juglindje një pjesë e territorit rreth fshatit Cerevajka iu bashkangjit Serbisë. Informacione të sakta lidhur me këto ndryshime është vështirë të gjinden në Kosovë, ku me të madhe besohet se në këto ndërrime kufijsh ishte përfshirë më shumë territor. Kjo ka inkurajuar disa që të spekulojnë lidhur me shkëmbimet e mëdha si pjesë të një marrëveshjeje për status përfundimtar të Kosovës, që Serbia të mbajë veriun e Kosovës në shkëmbim të heqjes dorë nga "Kosova Lindore": komunat e Preshevës, Bujanovcit, dhe ndoshta Medvegjës.

Në vitin 1965, komuna e Zubin Potokut ishte shfuqizuar dhe përvetësuar nga komuna e Mitrovicës. Në vitin 1987 ky vendim u anulua. Nën sundimin e Millosheviqit në vitin 1991 u krijua komuna e Zveçanit dhe u shkëput nga komuna e Mitrovicës. Ky vendim nuk u njoh nga shqiptarët të cilët gjatë viteve të 1990-ta i ruajtën

---

[4] Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.82, *Trepça:Dhënia e kuptimit Labirinthit*, 26 nëntor 1999, dhe raportin e Iniciativës Evropiane për Stabilitet (ESI) punuar nga Michael Palairet, "Trepça: Gjiganti industrial i Kosovës", në http://www.esiweb.org/ kosovo/palairet.php.

[5] Për Sanxhakun e sotëm, shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.162, Sanxhaku i *Serbisë: Ende e Harruar*, 8 prill 2005.

strukturat paralele komunale, por në vitin 1999 PSSP Bernard Kouchner e konfirmoi Zveçanin si komunë.

Komuna e Leposaviqit është me shumicë serbe, siç janë edhe territoret që tani ndodhen në komunat e Zubin Potokut dhe Zveçanit. Shkëputja e vazhdueshme e tyre nga komuna e Mitrovicës gjatë 30 vjetëve të fundit ka krijuar njësi të afërta administrative të dominuara nga serbët dhe balanci etnik i vet komunës së Mitrovicës ka anuar edhe më tej në favor të shqiptarëve. Nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i bërë në vitin 1991 del se 78.9 përqind janë shqiptarë dhe 10.2 përqind janë serbë.[6] Në fund të viteve 1990-ta vetëm dy kilometra katrorë të veriut të qytetit të Mitrovicës ruajtën një balans të përafërt, ndoshta 10,000 shqiptarë dhe po aq serbë për secilën anë.[7] Pjesa jugore e qytetit ishte gati tërësisht shqiptare.

## B. MITROVICA PAS VITIT 1999

Gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s në pranverë të vitit 1999, forcat serbe të sigurisë dëbuan shumicën e popullatës shqiptare të Mitrovicës dhe shkatërruan qindra shtëpi. Kur shqiptarët u kthyen në Kosovë në qershorin e vitit 1999, disa patën mundësi të kthehen në shtëpitë e tyre në veri të qytetit, si p.sh. në mahallën e boshnjakëve,[8] në bregun verior të lumit Ibër. Disa prej tyre madje kishin qëndruar atje edhe gjatë luftimeve. Por, me rreshtimin e serbëve në një forcë mbrojtëse për të parandaluar hyrjen e shqiptarëve në veriun e qytetit dhe me ndarjen me kordonë të urës nga KFOR-i francez, shumica e banorëve të mëparshëm shqiptarë nuk patën mundësi të ktheheshin atje. Shtëpitë e pakta të serbëve në jugun e Mitrovicës u bënë cak hakmarrjeje duke u djegur dhe plaçkitur nga shqiptarët, të cilët gjithashtu shkatërruan lagjën në të cilën kishin jetuar 6,000 romë.

Gjatë pjesës tjetër të vitit 1999 ndarja e qytetit u sforcua, me KFOR-in që kufizonte lëvizjen matanë urave dhe meshkujt serbë që formuan një forcë paramilitare - Rojat e Urës, për t'u mbrojtur nga kalimi i shqiptarëve përtej urës dhe kthimi eventual i tyre. Pavarësisht nga tensionet, disa institucione etnikisht të përziera vazhduan të ekzistonin për një kohë, përfshirë këtu edhe spitalin rajonal dhe staiconin e zjarrëfikësve. Prijësi i Rojave të Urës, Oliver Ivanoviqi, takohej një herë në javë me kryebashkiakun e caktuar nga UÇK-ja, Bajram Rexhepin.[9]

Në shkurt të vitit 2000, një valë e re e dhunëss thelloi ndarjen dhe shkaktoi shpërnguljen e një të tretës së shqiptarëve të mbetur në veri. Me 2 shkurt një sulm me granatë raketa-hedhëse mbi një autobus të UNHCR-së vrau tre serbë të Mitrovicës, dhe të nesërmen një granatë e vendosur në hyrje të një kafiterie në veri të Mitrovicës plagosi disa serbë dhe mbyti një shqiptar. Derisa turma të shqiptarëve dhe serbëve konfrontoheshin njëra me tjetrën në urat e ruajtura nga KFOR-i, banda serbësh shkuan nëpër banesa në veri të Mitrovicës, duke vrarë, plagosur dhe dëbuar shqiptarët, boshnjakët dhe turqit. Pesë shqiptarë dhe turqë u vranë, dhe më shumë se 1,500 shqiptarë u dëbuan drejt jugut. Përleshjet vazhduan për disa ditë me radhë. KFOR-i përforcoi brigadën shumëkombëshe të udhëhequr nga francezët me trupa amerikane, britaneze, gjermane dhe italiane ("Operacioni Ibri"), të cilët kontrolluan për armë në tërë qytetin dhe mbajtën turmat e serbëve dhe shqiptarëve tek urat, veçanërisht më 21 shkurt, kur disa mijëra shqiptarë marshuan nga Prishtina dhe Drenica.

Në fund të shkurtit të vitit 2000, UNMIK-u përgatiti një plan për të krijuar një ambient të sigurtë për bashkëjetesë dhe kthim për një periudhë katër deri gjashtë muajshe. Trupat franceze të KFOR-it krijuan një zonë të mirëbesimit, rreptësisht të mbrojtur, rreth urave qendrore. KFOR-i ktheu disa familje shqiptare në tre blloqet e rrokaqiejve në bregun verior dhe ndërtuan një urëkalim këmbësorësh për ndërlidhjen e tyre me jugun. Plani parashikonte vendosjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe zhbërjes graduale të strukturave paralele të Serbisë. Janë gjeneruar disa vende pune në institucione publike, por përveç vendosjes së një gjyqtari dhe prokurori ndërkombëtar në gjykatën rajonale në veri të Mitrovicës, Përgjegjësit përbërës institucional nuk sollën ndonjë progres, dhe kthimet as që filluan. Në gushtin e vitit 2000, UNMIK-u dhe KFOR-i mbyllën shkritoren e plumbit të Trepçës në Zveçan, sepse ajo po ndote ajrin në Mitrovicë. UNMIK-u mbajti një të tretën e forcës punuese, kryesisht serb, për pastrimin e atyre hapësirave dhe pagoi 2,000 paga të tjera. Serbët e veriut të Mitrovicës bojkotuan zgjedhjet komunale të tetorit të vitit 2000 të mbajtura në

[6] Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991 në Kosovë ishte përgjithësisht i përafruar. Shqiptarët e bojkotuan atë, duke protestuar për largimet nga puna të bëra disa muaj më parë të punëtorëve nga Zyra e Statistikës së Kosovës.

[7] Pothuajse është e pamundshme të gjinden shifra të besueshme. Shqiptarët insistojnë se ishin shumicë. Burime tjera pretendojnë se serbët e ruajtën shumicën edhe pse rritja e popullsisë shqiptare po e zvogëlonte atë.

[8] Fjala turke *mahalle* (*mahalla* si përdoret në Kosovë) shënon një lagje të veçantë të një fshati apo qyteti ku është vendosur, një grup etnik minoritar të caktuar, ose një familje të gjerë e të madhe. Në Kosovë, në dekadat e fundit kjo fjalë është zëvendësuar me fjalë shqipe *lagje*, mirëpo si shprehi dhe bazuar në histori fjala *mahallë* ende ka mbetur në përdorim në lagje të njohura urbane, tradicionalisht të banuara nga boshnjakët, romët apo ashkalinjtë.

[9] Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Grackë për Kosovën*, fq. 1.

Kosovë të cilat vendosën administratën komunale të udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)[10].

Në fund të janarit të vitit 2001, të rinjtë shqiptarë u ngritën kundër trupave franceze të KFOR-it pas të shtënave dhe sulmeve me granata nga serbët mbi mahallën e boshnjakëve që kulmuan me vrasjen e një djaloshi pesëmbëdhjetë vjeçar. Në reagimin e bërë më 1 shkurt, UNMIK-u dhe liderët politik të shqiptarëve të Kosovës u pajtuan që ta revitalizojnë strategjinë e vitit të kaluar me forca të shtuara të sigurisë, krijimin e një zone të zgjeruar të mirëbesimit dhe përpjekje të reja për të siguruar lirinë e lëvizjes dhe kthimin. Mirëpo, me insistimin e shqiptarëve për implementim dhe serbëve që e kundërshtonin atë, në veri të Mitrovicës dhuna shpërtheu më 17 mars. Pas arrestimeve të serbëve të dyshuar për sulme ndaj policisë, bandat sulmuan policinë e UNMIK-ut duke hudhur mbi ta bomba benzine, duke i tërhequr zvarrë nga banesat dhe duke i rrahur ata. UNMIK-u u tërhoq nga veriu i qytetit për disa javë.

Në shkurt të vitit 2002, UNMIK-u themeloi një zyrë për komunitete në veri të Mitrovicës, si një hap i parë drejt zëvendësimit të strukturave paralele serbe duke ndërlidhur serbët atje me autoritetet komunale të dominuara nga shqiptarët. 70 pozitat vendore që u hapën ishin plotësuar vetëm pjesërisht, dhe të punësuarit serbë shpesh merrnin kërcënime nga Rojat e Urës.[11] Në mars, UNMIK-u u ndodh para një fakti të kryer kur kompania shtetërore serbe e telekomunikacionit PTT instaloi në Zveçan një qendër transferuese digjitale, shkyçi veriun e Mitrovicës dhe të tre komunat veriore nga rrjeti i Kosovës dhe i rikyçi ato në sistemin e saj.

Në shkurtin e vitit 2002, tensionet u ngritën përsëri në veri të Mitrovicës pas arrestimit të dy serbëve të akuzuar për vrasje. Më 8 prill, Rojat e Urës sulmuan policinë e UNMIK-ut me gurë, armë dhe granata në pjesën veriore të urës kryesore ku policët kishin ngritur një postbllok trafiku dhe kishin arrestuar një udhëheqës të Rojave të Urës; 26 policë ishin plagosur. KFOR-i francez ishte kritikuar për dështim në ofrimin e ndihmës, dhe personeli ndërkombëtar ishte tërhequr nga veriu i lumit Ibër deri në muajin maj.[12] Më 1 tetor, PSSP Michael Steiner propozoi një "Plan shtatëpikësh" për Mitrovicën. Kjo iu premtonte serbëve se UNMIK-u dhe KFOR-i do të parandalonin çdo "sulm të papritur nga jugu" dhe projektoi që, serbët e veriut të Mitrovicës që kishin filluar t'i bashkangjiteshin Shërbimit Policor të Kosovës[13], deri në fund të vitit do të mund të patrullonin pjesët e tyre të qytetit. Nuk ishin përmendur asnjë nga prioritetet e mëhershme siç janë lehtësimi i kthimeve apo zgjerimi i zonës së mirëbesimit. Stimulimet ekonomike të parashikuara sipas planit ishin gjithashtu të orientuara drejt sigurimit të bashkëpunimit me serbët, duke përfshirë zhvendosjen e propozuar të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit në veri të Mitrovicës dhe "pas zgjedhjeve të suksesshme", p.sh. nëse serbët nuk do të përsërisnin bojkotin e vitit 2000, dhe organizimin e një konference donatorësh për Mitrovicën.

Në esencë, Steiner mbajti një premtim për serbët e veriut të Mitrovicës se ata do të kenë njësinë e vet komunale të veçantë nga komuna e gjerë e Mitrovicës. Si kusht për për të pasur këtë ata, së pari ata duhej të merrnin pjesë plotësisht në zgjedhjet e dyta komunale në Kosovë, të mbajtura më 26 tetor 2002, dhe të hynin në koalicion në nivelin komunal me shumicën shqiptare.[14] Megjithatë, serbët përsëri bojkotuan zgjedhjet komunale.

Në fund të nëntorit të vitit 2002, Steiner, me mbështetje nga Beogradi, lansoi një plan të modifikuar. Në veri të Mitrovicës ishte vendosur një administratë e udhëhequr drejtpërdrejt nga një zyrtar i UNMIK-ut, me një bord këshillues vendor. Pothuajse të 100 postet iu kishin dhënë serbëve. UNMIK-u, kështu, krijoi autoritetin e tij zyrtar përmes një kompromisi dykuptimësh me agjendën serbe të ndarjes dhe duke pranuar strukturën e ndryshuar etnike të pasluftës si bazë për organizimin e admistratës. Fillimisht kjo, megjithatë, ishte përshëndetur madje edhe nga shumë shqiptarë si "riunifikim". Tensioni u zvogëlua dhe zyrtarët komunalë shqiptarë dhe serbë, nën mbështetjen e UNMIK-ut, u takuan rregullisht. Një zyrtar i UNMIK-ut madje edhe deklaroi se problemi i Mitrovicës "u zgjodh".[15] Mirëpo, në gusht, kur fëmijët e plagosur serbë nga të shtënat në Gorazhdec ishin hospitalizuar në veri të Mitrovicës,[16] rreth "tre rrokaqiejve" dhe lagjes së boshnjakëve, ndodhën sulmet me granata të pasuara edhe me incidente të tjera. Lëvizjet në fund të vitit për të transferuar kontrollin e urës kryesore nga KFOR-i tek SHPK-ja ushqyen frikën e serbëve, derisa shqiptarët u ndien të poshtëruar kur UNMIK-u e minimizoi një incident në të cilin serbët duke

[10] Partia e Kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova, LDK-ja, në zgjedhjet e tetorit të vitit 2000, kishte fituar në shumicën e komunave në jug të lumit Ibër, dhe me këtë ka zëvendësoi kryetarët e komunave të emëruar nga UÇK-ja.

[11] Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Albatrosi Kosovar i UNMIK-ut*, fq. 11-12.

[12] Po aty, fq. 4-5.

[13] Marrëveshja midis PSSP Steiner dhe Zëvendës Kryeministrit të Serbisë Nebojsha Qoviq në mesin e vitit 2002 hapi rrugën që serbët në veri të Mitrovicës të inkuadroheshin në SHPK.

[14] Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.143, *Dilema Etnike e Kosovës: Nevoja për Kontratë Qytetare*, 28 maj 2003, fq. 18-20. Njësi komunale të tilla për "komunitete të mëdha jo-shumicë" do të duheshin krijuar në gjithë Kosovën.

[15] Biseda të Grupit të Krizave, korrik 2003.

[16] Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Kolapsi në Kosovë*, fq. 11, për rastin e vrasjes së dy fëmijëve serbë dhe plagosjes së katër të tjerëve në fshatin Gorazhdec në Kosovën perëndimore.

gjuajtur gurë rrethuan restoranin kur ndodhej Kryeministri Rexhepi.[17]

Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) më 16 shkurt 2004 publikoi raportin e vet, "Njerëzit apo territori? Një propozim për Mitrovicën".[18] Ideja udhëzuese ishte që, duke bashkuar veriun e Mitrovicës me Zveçanin, të krijohet një komunë të re e cila t'iu ofronte serbëve një shumicë të mundshme. Në këtë mënyrë, do të ofrohej siguri e mjaftueshme për akomodimin e shqiptarëve të kthyer, derisa pakica e re joserbe përtej lumit Ibër, e konsiderueshme në komunë, do të stimulonte marrëdhëniet praktike dhe do të mundësonte planifikimin zhvillimor të mbarë qytetit.[19]

Më 16 mars 2004, tre fëmijë shqiptarë u mbytën në lumin Ibër dhe pasi që lajmet në televizion lanë përshtypjen se fajtorë për këtë ishin serbët, të nesërmen, rreth urës kryesore ndodhën trazira me ç'rast katër shqiptarë u vranë dhe qindra të tjerë u plagosën.[20] Serbët e fundit të mbetur në jug të lumit Ibër -- që përbëjnë bashkësi të vogla afër kishës ortodokse në jug të Mitrovicës dhe në fshatin Frashër -- më 18 mars, kur turmat shqiptare i dhanë flakën të dy vendeve, u larguan në drejtim të veriut. KFOR-i mbylli urën kryesore për disa javë, dhe pastaj, gradualisht, relaksoi kontrollin derisa ajo iu kthye SHPK-së në qershor 2005. Në atë kohë, një plan për ta hapur atë për trafik rrugor hidhëroi serbët dhe ata organizuan protesta. Pasi që u dukën se ishin qetësuar, UNMIK-u, në gusht, dorëzoi komandën e stacionit policor në veri të Mitrovicës tek zyrtarët serbë të SHPK-së.

## C. TRI KOMUNAT VERIORE

Duke lëvizur (shkuar) drejt komunave të dominuara nga serbët: Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçan, fryma luftarake, organizimi radikal luftarak dhe banditëria, që e veçojnë Mirovicën, janë më pak të shprehura. Dominimi serb atje shihet si më legjitim dhe më pak i kontestuar, prandaj ujdia me UNMIK-un përbëhet nga një pozicion krahasues i sigurtë, dhe shpërthimet e dhunës janë më të rralla. Atje ka pak shqiptarë, dinari i Beogradit është valutë e pranuar, dhe shumë institucione shtetrore të Serbisë ende funksionojnë.[21] Një zyrtar i UNMIK-ut pranon se: "Këtu është Serbi. Prezenca e UNMIK-ut dhe IPVQ-ve është vetëm në dukje, e mbajtur në vend vetëm nga doza të mëdha të imunizimit nga presioni".[22]

Këto komuna, kryesisht rurale, janë të vogla. Të dhëna të sakta mungojnë, por Zubin Potoku dhe Zveçani secila kanë më pak se 10,000 banorë, përderisa Leposaviqi ka përafërsisht 15,000 banorë. Në në të tri komunat, sektori publik është i rëndësishëm -- paga të dyfishta për shërbyesit civilë, të paguar nga UNMIK-u dhe nga Beogradi, ka bërë që ata të jenë në krye të listës në kategorinë e zhvillimit njerëzor në Kosovë.[23] Ato pak ndërmarrje shoqërore që ndodhen atje janë thuajse krejtësisht joaktive, të shkatërruara dhe jokonkurruese si çdokund tjetër në Kosovë, dhe dallojnë vetëm në atë se transformimet e pronës të bëra në kohën e Milloshevriqit gjatë viteve 1990-ta nuk kishin përfshirë largimin masiv të shqiptarëve nga puna, sepse punëtorët e këtyre ndërmarrjeve ishin serbë.

Këto tri komuna morën pjesë në zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2002 në Kosovë me çka i kanë zgjedhur kuvendet komunale. Në këto kuvende dominojnë deputetët e dalur nga koalicionet e formuara midis Partisë Demokratike të Serbisë, partia e Kryeministrit të Serbisë Koshtunica (DSS) dhe Këshillit Nacional Serb të Kosovës. Dy serbët që vendosin për pothuajse çdo gjë në veri të Mitrovicës poashtu kanë mandate në këto kuvende komunale. Marko Jakshiq është deputet në kuvendin komunal në Zubin Potok si përfaqësues i DSS-së, përderisa Milan Ivanoviq është nënkryetar i kuvendit komunal të Zveçanit, si përfaqësues i KNS-së. Edhe pse të gjithë liderët komunalë vijnë nga këto dy grupe, ekziston një ndryshim i konsiderueshëm në kuvendet komunale. Politika komunale e Leposaviqit, në veçanti, është më pak e vënë nën regjim. Ajo "e ka pranuar" UNMIK-un më herët sesa të tjerët, dhe atje ka më shumë debat mes partive.

[17] Po aty, fq. 12-13.
[18] http://www.esiweb.org/kosovo/.
[19] Raporti zgjoi interesim të konsiderueshëm në Kosovë mirëpo klima e përshtashme për shqyrtim u dëmtua nga trazirat e 17-19 marsit të vitit 2004. Raporti është një kontribut i çmueshëm për mundësinë për të menduar për çështjen e Mitrovicës dhe me raportin simotër të saj, "E ardhmja Post-Industriale? Ekonomia dhe Shoqëria në Mitrovicë dhe Zveçan", i cili ofron një mori informacionesh. Nëse ka dobësi, ato janë supozimi gatshëm i dëshirës së mirë në mes të protagonistëve; vlerësimi i pamjaftueshëm për Mitrovicën si vijë frontale e një konflikti të vazhdueshëm; si dhe mosdurimi për të zvogëluar burimet e konfliktit dhe transformimin e tij në çështje ekonomike dhe të pronësisë.
[20] Shih Raportin e Grupit të Krizave, Kolapsi në Kosovë.
[21] Në mënyrën e tij, Kryeministri i mëparshëm Haradinaj e pranoi kontrastin: "Zveçani dhe veriu i Mitrovicës janë pikat shqetësuese -- vetëm 300 njerëz atje kanë luajtur me ne gjatë këtyre gjashtë viteve". Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 21 janar 2005.
[22] Intervistë e Grupit të Krizave, 26 gusht 2005.
[23] Shih Raportin e Zhvillimit Njerëzor të UNDP-së, "Kosova 2004", fq. 25-26. Arritjet e mëdha në edukim lartësuan Leposaviqin dhe Zubin Potokun; në Zveçan të ardhurat ishin poashtu një faktor në vendosjen e këtij vendi në mesin e pesë komunave të para të Kosovës për zhvillim njerëzor.

Të tri autoritetet komunale ruajnë strukturat qeveritare serbe dhe përdorin simbolet e shtetit serb. Ata vetëm pjesërisht janë integruar me UNMIK-un, duke i pranuar zyrtarët dhe institucionet siç janë Zyrat për Komunitete Minoritare, dhe takohen me përfaqësuesin rajonal të UNMIK-ut dhe grupet punuese si këshillat për parandalim të krimit dhe -- më shumë rastësisht -- komitetet për komunitete. Edhe pse i mbajnë komunitetet shqiptare pakicë larg vetes, ata kryesisht veprojnë në përputhje me rregullat e UNMIK-ut të "financimit proporcional". Përveç fondeve të pranuara nga ministritë e Serbisë, ata marrin të holla edhe nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Ekziston një tendencë e madhe për t'i refuzuar të hollat nga buxheti i Kosovës që ndahen për shëndetësi ndërsa ato që ndahen për arsim pranohen derisa në përdorim janë planprogramet mësimore të Serbisë. Në Zveçan, për dy vjet, Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Kosovës nuk ka aprovuar mallra dhe shërbime apo investime kapitale. Komuna e ka bartur pjesën më të madhe të buxhetit të vet për nevojat shkollore. Investimet për projekte kapitale kanë ardhur nga donatorët dhe nga Beogradi.

Leposaviqi në vitin 2000 ishte e para nga tri komunat që pranoi policë serbë të SHPK-së. Pak kohë më pas ky veprim u ndoq edhe nga Zubin Potoku, por Zveçani (dhe veriu i Mitrovicës) këtë e bënë vetëm në fund të vitit 2002. Një burim i UNMIK-ut e përshkroi policinë e Leposaviqit si "një shërbim paralel në uniforma të SHPK-së", të korruptuar dhe lehtë të ndikueshëm.[24] Në Zubin Potok SHPK-ja nuk ka gjetur vendstrehim. Kryetari i komunës refuzon të flasë me komandantin, dhe atje ka sulme të herë pas herëshme mbi stacionin e policisë. Në të gjitha këto komuna ka stacione paralele të policisë së Serbisë, të drejtuara nga policë në rroba civile. Që nga mesi i vitit 2002, Beogradi ka inkurajuar profesionistët juridik serbë të Kosovës që t'i bashkohen sistemit gjyqësor të UNMIK-ut. Në fillim të vitit 2003 në Leposaviq, Beogradi i mbylli gjykatat e veta paralele. Në Zubin Potok dhe Leposaviq, UNMIK-u hapi gjykatat komunale për kundërvajtje të vogla, përderisa komuna e Zveçanit e shtyu një vendim të tillë. Megjithatë, bashkëpunimi i Beogradit me sistemin juridik të UNMIK-ut, gjatë vitit 2003 shënoi ngecje. Gjykatat paralele vazhdonin të funksiononin në Zubin Potok dhe ato u rihapën në Leposaviq. Që atëherë asnjë gjykatës serb nuk iu bashkua gjykatave të UNMIK-ut që ende nuk kishin staf të mjaftueshëm. Ende mbetet e paqartë nëse pjestarët serb të SHPK-së dhe gjykatësit serbë në komunat e veriut do të pranojnë transferin e autoritetit të UNMIK-ut tek ministritë e reja të drejtësisë dhe të punëve të brendshme të Kosovës.

Përderisa këto tri komuna do të preferonin autoritet të plotë të serbëve në Kosovën veriore, ato kanë qenë pragmatike sa i përket bashkëpunimit me Prishtinën. Në maj të vitit 2005, zyrtarë të Leposaviqit vizituan zyrën e Kryeministrit Kosumi për të diskutuar lidhur me buxhetet. Kryetarët e komunave (tre serbë, tre shqiptarë, që përfaqësonin dy pjesët e ndara të lumit Ibër) kanë marrë pjesë, së bashku me gjashtë kryetar nga rajoni i Mitrovicës, në disa takime me PSSP Jessen-Petersen për të diskutuar "shqetësimet e përbashkëta".

Por, forma alternative e tyre e shkrirjes ishte "Unioni i komunave serbe dhe marrëveshja për Kosovë dhe Metohi", i krijuar në fillim të vitit 2003 me deputetë komunalë që kishin fituar mandate në zgjedhjet lokale të tetorit 2002. Ky union u takua në Zveçan dhe shfaqi mbështetje për komunat e veriut dhe KNS-në. Në koordinim me iniciativën e Kryeministrit të ndjerë të Serbisë Gjingjiq, ata kërkuan federalizimin e Kosovës në dy entitete -- një të komunave dhe enklavave serbe që do të funksionin si pjesë e Serbisë, dhe një entitet shqiptar me autonomi substanciale.[25] Me afrimin e vendimeve për statusin përfundimtar, shtrohet pyetja se a do të rishikohet shkrirja e këtyre entiteteve; nëse po, a do të jetë qëllim i këtyre komuniteteve që ta shfrytëzojnë këtë si një shtyetje serioze për ndarje apo thjesht për të përmirësuar pozitën e tyre gjatë bisedimeve; dhe a do të përfshihen enklavat jugore serbe në iniciativën e tyre? Konsultimet e fundit tregojnë se liderët vendor më shumë favorizojnë të kenë më shumë komuna se sa vetëm një entitet të madh.[26]

---

[24] Intervistë e Grupit të Krizave, Mitrovicë, 16 gusht 2005.

[25] Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Dilema Etnike e Kosovës*, fq. 20-21, për shpjegime të plota.

[26] Intervistë e Grupit të Krizave me një burim të UNMIK-ut, 26 gusht 2005.

## III. AKTERËT KRYESOR DHE INTEGRITETI TERRITORIAL I KOSOVËS

### A. BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE

Lobimi i PSSP Jessen-Petersen ndihmoi që në prill të vitit 2005 të arrihet deklarimi i Grupi të Kontaktit dhe Bashkimit Evropian (BE) se ata nuk do të pajtohen për ndarjen e Kosovës apo bashkimin e saj me ndonjë shtet tjetër (p.sh. Shqipërinë),[27] për një konfirmim të integritetit territorial të Kosovës brenda kufijve të vitit 1974 që dukshëm kufizon zgjidhjet e mundshme të statusit përfundimtar. Domosdoshmëria gjeopolitike për të hedhur poshtë ndarjen etnike është e qartë. Megjithatë, mungesa e përpjekjeve konkrete deritani për të përkrahur këtë deklaratë në lidhje me ndarjen gjashtë vjeçare të Mitrovicës dhe ndikimin e vazhdueshëm të Beogradit në veri të lumit Ibër po kthehet si bumerang. Kjo po shkakton dyshime lidhur me përkushtimin e Grupit të Kontaktit për deklaratën e bërë, apo së paku gatishmërinë për t'u marrë me detajet. Muajt në vijim do të tregojnë se a është bashkësia ndërkombëtare e përgatitur për barrën e rëndë të nevojshme për ta kthyer kushtin e shprehur si negativ në mbështetje pozitive për qeverisje funksionale dhe të integruar në tërë Kosovën.

Derisa të ndodh kjo do të ketë së paku dyshim se deklarata ishte menduar vetëm për të ngadalësuar apo për ta fshehur përkohësisht rezultatin e ndarjes që bashkësia ndërkombëtare nuk ka energji apo dëshirë ta parandalojë. Vërtet, ky është sugjermi i dalë nga përvoja e Mitrovicës. KFOR-i dhe menaxhmenti i UNMIK-ut në Mitrovicë ka arritur pak më shumë sesa një ushtrim të vrazhdë për ti ndarë protagonistët nga njëri-tjetri. Stabiliteti është interpretuar si mungesë e luftimeve. UNMIK-u ka marrë rrugën më së paku të kundërshtueshme, duke e negociuar drejtimin e saj me Beogradin brenda një roli zyrtar në veriun e Mitrovicës që i kushtoi me shtrembërim të parimeve të zakonshme për qeverisje. Madje, edhe shefi i tanishëm aktiv i UNMIK-ut ka investuar shumë pak energji për t'u marrë me Mitrovicën.

Përgjigja "jo" për ndarjen është provuar nga KFOR-i dhe UNMIK-u si një palë rroba të reja të perandorit. Si njëri ashtu edhe tjetri së fundi kanë dhënë deklarata sikur mos të kishte fare problem të Mitrovicës -- se nuk ka ndarje atje, dhe se qyteti është si çdo vend tjetër në Kosovë.[28] Jo detyrimisht me vetëdije, dhe pa dëshiruar të konstatojnë hapur një qëllim të tillë, prapëseprapë, UNMIK-u dhe KFOR-i hap pas hapi kanë përgatitur rrugën për një komunë veriore të ndarë të Mitrovicës, më shumë bazuar në de-facto-n e tanishme sesa në popullatën e para luftës. Kjo i lë punët e papërfunduara dhe popullatën e zhvendosur e mban pezull, pa asnjë masë të ndërmarrë për t'i kompenzuar apo ristrehuar. Bashkësia ndërkombëtare ka ngelur midis mungesës së energjisë dhe cinizmit realist të çasjes së vet në terren dhe parimeve mbi të drejtat e njeriut, multietnicitetit, dhe kthimit prapa të spastrimit etnik që teoritikisht i përshkruhet.

Nëse Kosova duhet të mbetet e pandarë, shtytja dhe gatishmëria duhet të vijnë nga bashkësia ndërkombëtare, e cila nuk mund të mbështetet në protagonistët për të kompensuar çfarëdo mungese. Prishtina është ndarë në dysh sa i përket asaj se çfarë duan. Beogradi gjithnjë e më shumë preferon ndarjen dhe e ka përgatitur terrenin për një gjë të tillë. Është bashkësia ndërkombëtare ajo që ka interesin më të qartë për integritetin territorial ashtu që misionet e KB-së dhe NATO-s të mos duken si dështime, me shpenzime përkatëse për autoritetin e atyre institucioneve dhe rrezikun e stabilitetit territorial gjetiu në rajon. E gjithë kjo rrezikohet në Mitrovicë.

### B. BEOGRADI

Pozicioni i Serbisë për Mitrovicën -- emëruesi më i vogël i përbashkët që reflekton pjesërisht dallimet e brendshme ndërmjet politikanëve të vet lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës -- kërkon që të mbahet status-quo-ja derisa ta përgatisë terrenin për ndarje të mundshme. Të gjithë politikanët e Beogradit e shohin në përgjithësi veriun, dhe në veçanti Mitrovicën, si kufi që duhet mbajtur kundër zgjerimit të mëtutjeshëm të shqiptarëve. Përderisa ata diskutojnë për planet dhe për pjesëmarrje në institucionet e Kosovës, ekziston një qëndrim gati unanim se nëse arrihet pavarësia, kjo duhet të bëhet pa veriun. Ndonëse ata duken se ende nuk e kanë menduar mirë dinamikën e veprimit, ndarja është pozicioni bazë kthyes për konsens.

Ndoshta zëri më i qartë është ai i autorit me influencë Dobrica Qosiq, libri i fundit i të cilit -- i quajtur thjesht *Kosova* -- ofron argumente që do të mbështestin ndarjen.[29] Përgjithësisht mendohet se kryetari Tadiq pajtohet me

[27] Grupi i Krizave poashtu rekomandoi këta hapa si etapa drejt zgjidhjes së statusit të Kosovës. Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr. 161, *Kosova: Drejt Statusit Final*, 24 janar 2005, rekomandimi 1b), fq. ii.

[28] Komandanti i KFOR-it gjeneral Yves de Kermabon, në intervistën e 10 qershorit 2005, insistoi se "Mitrovica nuk duhet të trajtohet si rast i veçantë. Nuk ka ndarje të Kosovës". Në konferencën javore të UNMIK-ut për gazetarë më 22 qershor, zëdhënësi i tyre Neeraj Singh, hodhi poshtë sugjerimet e gazetarëve se UNMIK-u asnjëherë nuk ka pasur kontroll të plotë në veriun e Mitrovicës.

[29] Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Kosova: Drejt Statusit Final*, fq. 17, për diskutim të idesë së Qosiqit për Kosovën dhe ndikimin.

shumë nga idetë e tij. Një numër i politikanëve tjerë kryesorë në Beograd poashtu pajtohen me këtë qasje edhe pse asnjë nga ata me të cilët bisedoi Grupi i Krizave nuk pranoi të fliste zyrtarisht.

Për t'u përgatitur për ndarje, Beogradi ka implementuar politika të disenjuara për të integruar veriun në Serbi dhe të shkëpusë të gjitha lidhjet me zonat me shumicë shqiptare, në mënyrë tipike duke bërë që ministritë e tyre të tentojnë të ushtrojnë autoritet mbi veriun e Mitrovicës dhe mbi të tre komunat me shumicë serbe në veri. Poashtu ka shpenzuar resurse të shumta për të krijuar infrastrukturë të veçantë si p.sh. linjat telefonike të cilat tani e anashkalojnë Prishtinën. Përgatitjet janë duke u bërë për të ndërtuar një sistem të ndarë për furnizim me ujë për Zveçanin dhe veriun e Mitrovicës, edhe pse rryma elektrike ende vjen nga termocentralet e Kosovës në Obiliq. Ndërtimi i një rruge që çon nga veriu i Mitrovicës dhe Zveçani në Zubin Potok do t'iu mundësojë serbëve që ti shmangen zonave ku jetojnë shqipëtarët.

Në terren, kundërshtimi i Grupit të Kontaktit ndaj ndarjes mbetet shumë larg nga hapat e bërë nga Beogradi. Një diplomat i lartë perëndimor bëri një vërejtje: "Beogradi mund ta zbulojë mungesën e apetitit tonë për të vazhduar me kontrollin policor të kufirit që ata nuk e njohin".[30] Madje edhe tani, pavarësisht nga deklaratat se ndarja, nuk vjen në konsiderim, Beogradi duket se po e parandjen se bashkësia ndërkombëtare po heziton që të ndërmarrë ndonjë veprim për të bërë retorikën realitet praktik.

Për Beogradin, rebusi është se si të arrihet kjo ndarje me dëme minimale ndaj pozicionit të vet ndërkombëtar ndonëse duke i ruajtur pretendimet ndaj tërë Kosovës si mjet kushtëzues për bisedime. Ndonëse Serbia i frikësohet konfrontimit të hapur ushtarak me bashkësinë ndërkombëtare, ndarja e ngadalësuar nënkupton se ajo tashmë është duke shkuar rrugës së prezantimit të një fakti të kryer. Nëse Kosovës i jipet pavarësia, parlamentari serb Milorad Todoroviq thotë: "ndarja do të ndodhë spontanisht, si rezultat i pamundësisë implementuese të zgjidhjeve tjera".[31]

Nuk do të thotë se Beogradi ka frikë nga një shpërthim tjetër të dhunës nga shqiptarët. Sulmet e përtërira mbi serbët dhe minoritetet tjera në të vërtetë do të ishin të mirëseardhura për disa qarqe, sepse ato do të ofronin justifikimin brenda vendit që të konsolidonin veten e tyre hapur për të mbrojtur bashkëkombasit me gjithë rrezikun e mundëshëm të një izolimi ndërkombëtar.

Ndërkombëtarisht, Serbia shpesh e vë në dyshim validitetin e kufijve të brendshëm dhe të jashtëm republikan të përcaktuar me kushtetutën e vitit 1974 të Jugosllavisë. Nëse një precedent vendoset në Kosovë për t'i vënë ato anash, disa politikanë të Beogradit besojnë se kjo do ta poziciononte Serbinë më mirë, që përfundimisht ta inkorporojë entitetin serb të Bosnjë-Hercegovinës; për të qenë në gjendje që të aktivizojë ambicjet për territorin rreth Kumanovës ku jeton një një numër i konsiderueshëme I serbëve në rast të çalmit të procesit paqësor të Ohrit në Maqedoni; dhe të absorbojë territorin e banuar nga minoriteti i madh pro-serb në Mal të Zi nëse ata nuk dëshirojnë t'i bashkohen pjesës tjetër të republikës në referendumin për pavarësi që ka mundësi të mbahet në vitin 2006.

## C. SHQIPTARËT E KOSOVËS

Garancioni për "jo ndarje" është pranuar dhe është mirëpritur nga shqiptarët por, ata nuk ishin forca shtytëse që e kërkonte këtë. Shqiptarët, aktualisht, zotohen për kufijtë e vitit 1974 dhe shtetësinë e Kosovës por, ky vizion mund të ndërrojë nëse bëhen ndërrime territoriale. Një editorial i botuar në *Zëri* në mars të vitit 2005 ngriti shqetësimin se disa politikanë udhëheqës mund të jenë të gatshëm të japin veriun dhe kërkoi që të gjithë të deklarojnë përkushtimin e tyre për integritetin territorial të Kosovës. Më 1 gusht gazeta paralajmëroi se "Beogradi zyrtar po mundohet të gjejë një partner në Prishtinë që të riforcojë idenë e ndarjes së Kosovës".

Spekulimet e mediave në kohën e fundit sugjerojnë se shqiptarët e Kosovës do të ballafaqohen me sfida të sigurisë, përfshirë fluksin e mundshëm të forcave paramilitare dhe jo të rregullta serbe, të cilat gjatë përcaktimit të Statusit të Kosovës, vitit të ardhshëm mund të hyn në veri të lumit Ibër. Çka ende nuk kanë bërë nga pala Kosovare është zvoglimi i rrezikut për ndarje duke kërkuar të zvogëlojnë ndasinë me serbët e veriut të Kosovës, në veçanti duke ofruar një bazë negociuese bindëse për siguri afatgjate dhe autonomi të komuniteteve të tyre ku jetojnë ata. Mungesa e një vizioni të sigurisë për Kosovën i mban serbët të frikësuar ndërsa bashkësinë ndërkombëtare mosbesuese. Shqiptarët duhet ta kuptojnë se nëse çështja mbetet e hapur gjatë bisedimeve për statusin përfundimtar, Beogradi do të jetë në pozicion më të mirë për të kërkuar ndarje si çmim për pavarësinë.

Elita politike shqiptare e Kosovës brengoset se do të lihet anash nga grupe më ekstreme me agjendë pan-shqiptare por ajo nuk është mjaft koherente për të zhvilluar një vizion të përbashkët apo të avansohet përtej kërkesës maksimaliste për një Kosovë të bashkuar nën autoritetin e Prishtinës. Një komentues brengoset për cilësinë e demokracisë në Kosovë nëse kufijtë ndryshojnë: "ne kemi nevojë për serbët këtu për të ndërtuar një shoqëri

[30] Intervistë e Grupit të Krizave, janar 2005.
[31] Fjalimi në seminarin Rose-Roth të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Shën Stefan, Mal i Zi, 18 qershor 2005.

jopërjashtuese dhe demokratike".[32] Një tjetër brengoset për orientimin politik në Kosovë që do të mund të përkeqësohej shpejt në një nacionalizëm të madh shqiptar -- "ideja e Kosovës do të vdiste"[33] -- dhe një ambient në të cilin grupet radikale të armatosura do të kërkonin kompenzim territorial në territoret e afërta të banuara nga shqiptarët, posaçërisht në Maqedoni. Përderisa Serbia mund të shkëmben pranimin e pavarësisë së Kosovës me veriun e Kosovës, shqiptarët sipas të gjitha gjasave do të merrnin parasysh një shkëmbim ku Serbia do të heqte dorë nga territoret e "Kosovës lindore" të Preshevës, Bujanovcit dhe ndoshta Medvegjës. Duke mos e përkrahur dhe pranuar një marrëveshje të tillë territoriale, disa shqiptarë shprehin gatishmërinë që t'i kundërvihen ndarjes me anë të forcës së armëve.[34]

Pyetja që ndërlidhet është nëse elita e Prishtinës e ka vullnetin dhe motivimin për të bëj diçka në emër të Mitrovicës. Edhe pse të gjitha partitë e mëdha e përkrahin pavarësinë brenda kufijve të vendosur, për ta financuar një kompromis të komplikuar për Mitrovicën dhe veriun mund të nevojiten resurse të mëdha buxhetore. Dështimi që në korrik të vitit 2005 të sigurohet një kontribut modest prej 200,000 Euro të premtuara për projektin e ndërtimit të lagjes së romëve në Mitrovicë mund të jetë një tregues se mungon përkushtimi praktik. Nëse një marrëveshje do të përfshinte transferimin e disa ministrive qendrore apo departmenteve në Mitrovicë, do të ketë rezistencë të konsiderueshme praktike. Politikat e Kosovës të interesave të kufizuara dhe patronazhi pengojnë shqiptarët nga përgatitja e një oferte e cila do të mundësonte bashkimin e Mitrovicës së ndarë.

Tani që Grupi i Kontaktit dhe BE-ja kanë përjashtuar ndarjen si mundësi, shumica shqiptare mund të mos e sheh nevojën për ofrimin e koncesioneve për të involvuar veriun në dialog sipas kushteve të jo ndarjes dhe të mbetjes së saj brenda Kosovës. Në anën tjetër, politikanët shqiptarë të Kosovës mund të pengohen nga kompleksiteti dhe mundësia, në dukje margjinale, e suksesit për të arritur marrëveshje të qëndrueshme për siguri serbët dhe për veriun. Në vend që të ballafaqohen me brenga të vazhdueshme të sigurisë dhe një kufi të vështirë për t'u kontrolluar, ata mund të shohin dobi në braktisjen e veriut. Vërtet, edhe pse politikanët shqiptarë të Kosovës nuk do ta thonin këtë publikisht, disa shohin dobi në vendosjen përafërsisht përgjatë lumit Ibër të kufirit ndërkombëtar të Kosovës. Nëse Prishtina edhe me shtetësi nuk do të kishte mundësi të kontrollojë plotësisht veriun, ata e shohin si përfitim braktisjen, e cila do të lironte shtetin e ri nga të drejtat minoritare të cilat bashkësia ndërkombëtare do të insistonte të respektoheshin. Me veriun e humbur, presioni mbi serbët e mbetur që të largohen do të ishte enorm. Tokat dhe pronat serbe në jug të lumit Ibër -- shumica e tyre, të cilësisë më të mirë sesa në veri -- me gjasë do të bëheshin dhe do të vëheshin në disponim për shqiptarët e Kosovës me një çmim më të ulët sesa vlera aktuale e tregut. Një faktor që e ndalon një mënyrë të tillë të të menduarit është miti i vazhdueshme për Trepçën. Nëse ndërmarrja do të ringjallej, shqiptarët do të ishte vedhe me një vlerë më shumë dhe më e qëndrueshme për ta mbajtur veriun. Anasjelltas, likuidimi përfundimtar i Trepçës mund ti nndryshonte kalkulimet. Së fundi, natyrisht, një marrëveshje për ndarje mund të ishte atraktive për nacionalistët shqiptarë si diçka që padyshim po e dobëson qëndrimin e dytë të Grupit të Kontaktit, se është kundër bashkimit të Kosovës me ndonjë territor tjetër.

## D. SERBËT E VERIUT

Për pjesën më të madhe serbe të veriut, perspektiva e qënrimit në një Kosovë të pavarur të dominuar nga shqiptarët duket si jonatyrale, e padrejtë, dhe si kërcënim për ekzistencën e vet të vazhdueshme. Nxjerr në pah injorancën lidhur me enklavat serbe në jug të lumit Ibër dhe me sa duket shpreh pak interesim se manovrimet e tyre kanë pasoja negative për ta. Në vend të ndjekjes së një identiteti të përbashkët për serbët e Kosovës, veriu luhatet midis përpjekjes për rikthim në Serbi dhe kërkesës nga Prishtina për autonomi. Braktisja e jugut po zvarritet madje edhe në retorikën e politikanëve më të moderuar. Dragisha Kërstoviqi i Listës serbe për Kosovë dhe Metohi flet për ndarje dhe evakuim të serbëve në veri nga zonat si Graçanica si garancioni më i mirë për paqë, edhe pse ai pranon se për këtë nuk është konsultuar me serbët e Graçanicës dhe se është i pasigurtë nëse ata do të pajtoheshin.[35] Sinjalet nga Beogradi përbëjnë pjesë të madhe të këtyre qëndrimeve. Siç tha një serb i Mitrovicës, vetëm Beogradi mund të ndërtojë një lidhje midis serbëve

[32] Intervistë e Grupit të Krizave me analistin Lulzim Pecin, drejtor i KIPRED-it të Kosovës.

[33] Intervistë e Grupit të Krizave me Enver Hoxhajn, pedagog universiteti dhe anëtar i kryesisë së PDK-së.

[34] Luftëtarët potencial të intervistuar nga Grupi i Krizave gjatë dimrit 2004-2005 në Kosovën perëndimore kishin qëndrime të fuqishme lidhur me veriun. Ata tërhoqën një paralele midis lidhjeve të serbëve të veriut të Kosovës me Serbinë dhe lidhjen e tyre me Shqipërinë, dhe i panë ato si legjitime përderisa nuk cenoheshin kufijtë territorial të Kosovës, nuk shkelnin kufirin forcat e armatosura serbe si dhe përderisa mbahej bashkëpunimi me institucionet qendrore të Kosovës. Përndryshe, ata do të sulmonin dhe mposhtnin veriun. Një zyrtar i lartë politik shqiptar i Kosovës i dalë nga UÇK-ja poashtu i ka thënë Grupit të Krizave se çfarëdo ndarje e "njëanshme" e veriut do të ndeshej me reagim ushtarak. Ngjashëm, Ylber Hysa, Kryetar i Grupit Parlamentar të partisë ORA, në seminarin e Institutit të Paqës të SHBA-ve mbajtur në janar të vitit 2005 në Washington D.C., ka paralajmëruar se "mund të ketë reagim të shqiptarëve".

[35] Intervistë e Grupit të Krizave, Leposaviq, 23 qershor 2005.

të veriut dhe atyre të jugut aq të qëndrueshme sa që të bindë pararendësin se ata janë të gjithë "në të njëjtën barkë"[36]. Mirpo Beogradi nuk po e bën këtë. Në kohën e Kryeministrit të ndjerë Gjingjiq, bartja e disa departamenteve të universitetit të veriut të Mitrovicës në Graçanicë dhe dërgimi i arsimtarëve nëpër enklava u duk sikur e paralajmëronte një përpjekje të tillë, mirëpo mesazhi i Serbisë ka ndryshuar kohëve të fundit.

Veçanërisht pasi që Koshtunica u bë Kryeministër në vitin 2004, forcë kryesore politike në veri të Kosovës u bë Këshilli Nacional Serb. Fillimisht i krijuar në vitin 1998 dhe 1999 nga serbët e Kosovës të cilët dëshironin t'i përfaqësonin interesat e tyre pavarësisht nga Milloseviqi dhe SPS i tij, pas luftës fraksione të reja u zhvilluan në veri dhe në Graçanicë. Dr Marko Jakshiqi i spitalit rajonal të Mitrovicës dhe zyrtar i lartë i partisë DSS të Koshtunicës së fundi e ka konsoliduar udhëheqjen e tij, dhe Koshtunica ia ngarkoi atij shumicën e kompetencave lidhur me funksionet dhe emërimet Kosovë. Si shpërblim apo kompenzim, KNS-ja i dërgoi serbët e Kosovës në Beograd që të marrin pjesë në një demonstratë kundër kundërshtarit të Koshtunicës, Kryetarit Tadiq, në vitin 2004 dhe i siguroi 99 për qind mbështetje thirrjes së tij për bojkot të serbëve në zgjedhjet e përgjithshme të tetorit të vitit 2004 në Kosovë, duke turpëruar madje edhe politikanët më të moderuar serb të Kosovës të vendosur në Mitrovicë si Oliver Ivanoviqin dhe Tadiqin. Gjatë vizitës së tij në shkurt të vitit 2005, Tadiqi i lejoi vetes që më parë të shoqërohet nga personalitete të KNS-së sesa me serbët më të moderuar të cilët e kishin pranuar thirrjen e tij për të marrë pjesë në zgjedhje, duke vërtetuar përceptimin se KNS-ja përfaqëson interesin kryesor të Serbisë në Kosovë.

Përderisa humbi një pjesë të bazës së tij politike në parlamentin e Serbisë dhe kur Koshtunica ia ndërpreu fondet në fillim të vitit 2004, Nebojsha Qoviqi kërkonte të shtrijë kontrollin e tij në veri përmes Qendrës Koordinuese për Kosovë dhe Metohi (QKK).[37] Qysh nga atëherë, për institucionet paralele të Serbisë më shumë financime kanë shkuar përmes ministrive qeveritare, përderisa KNS-ja ka mbikëqyrje nëse jo edhe kontroll direkt mbi këto fonde, që siç thuhet për veriun e Mitrovicës dhe Zveçanin rrumbullaksojnë shumën prej €1.6 milionë në muaj.[38] Bile edhe përfaqësuesi i ri i QKK-së në veri të Mitrovicës u emërua përmes Jakshiqit.[39] Duke kundërshtuar armiqësisht çfarëdo lidhje me Prishtinën, KNS-ja ka provuar që në vitin 2002 kur UNMIK-u vendosi administratën e vet në veri t'i ndërpresë lidhjet e tilla të cilat ishin krijuar me qeverinë e përkohshme të Kosovës (IPVQ) dhe Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.[40] Hapat që u ndërmorën për të bashkuar spitalin rajonal dhe universitetin në veri të Mitrovicës me ministritë e shëndetësisë dhe arsimit të IPVQ-ve dhe për t'i përfshirë në Buxhetin e Konsoliduar dështuan. Të dyja mbijetojnë ekskluzivisht nga buxheti qeveritar i Serbisë.

Serbët e veriut janë të zemëruar për shkakun se Mitrovica është nënvizuar si një problem diskret, duke thënë se nëse bëhet kjo, injorohet konteksti në të cilin dhjetëra-mijëra serbë në tërë Kosovën gjatë gjashtë vjetëve të fundit nuk kanë qenë në gjendje që të kthehen në shtëpitë e tyre.[41] Ata me vrullshëm se liria e lëvizjes që do të ofronte hapja e urës kryesore në Mirovicë do të ishte vetëm në njërin drejtim -- shqiptarët do të shkonin në veri, por asnjë serb nuk do të rrezikonte të shkonte në jug sepse, siç insistoi njëri, "ne kemi përvojë të mjaftueshme që të dijmë se kur shqiptarët lejohen të jenë të barabartë ata dëshirojnë që të dominojnë…. Sapo shqiptarëve t'iu lejohet barazia në Mitrovicë ata do të bëjnë presion mbi serbët që të largohen….Për ata, vlen e thëna se "E imja është vetëm e imja. E jotja është e jona".[42]

---

[36] Intervistë e Grupit të Krizave, 18 shkurt 2005.

[37] Në fund të gushtit të vitit 2005 Koshtunica shkarkoi tërësisht nga posti Qoviqin.

[38] Shih raportin e Iniciativës Evropiane për Stabilitet (ESI), "E ardhmja post-industriale? Ekonomia dhe Shoqëria në Mitrovicë dhe Zveçan", 30 janar 2004, në www.esiweb.org.

[39] I zgjedhuri, Momir Kosaloviq, vjen nga fshati i lindjes së Jakshiqit dhe qartazi është vartës i tij.

[40] Pagat dhe pagesat tjera që i paguhen nga ky buxhet veriut të Mitrovicës ende arrijnë shumën prej €500,000 në muaj. Shih ESI, "E ardhmja post-industriale?".

[41] "Serbët nuk mund të japin sqarime të arsyeshme se pse shqiptarët nuk duhet të lejohen të kthehen apo të kenë qasje në Veri. Bashkësia ndërkombëtare me shkathtësi na ka manipuluar që ne të dukemi keq. Por, pse bashkësia nderkombëtare nuk ushtron presion të ngjashëm edhe mbi shqiptarët, p.sh. për kthim në Burim (ish Istog)?" Intervista e Grupit të Krizave me Nenad Radoslavleviqin, Leposaviq, 23 qershor 2005. "Unë gjithmonë isha kundër nxerrjes jashtë të Mitrovicës nga çështja e gjithmbarshme e Kosovës. Shumë liderë shqiptarë e ngrisin Mitrovicën si shembull shumë të keq, por nuk e shohin spastrimin etnik të serbëve gjetiu si problem. Ata e vënë këtë jashtë ekuacionit të Mitrovicës. Kthimi i serbëve nëpër shtëpitë e tyre në tërë Kosovën do të zgjidhte problemin e Mitrovicës". Intervistë e Grupit të Krizave me Dragisha Krstoviq, Leposaviq, 23 qershor 2005.

[42] Intervistë e Grupit të Krizave me Nenad Radosavleviqin, Leposaviq, 23 qershor 2005.

# IV. NATYRA E NDARJES

Situata sociale, institucionale dhe ekonomike në Mitrovicë gjatë gjashtë vjetëve të fundit formon bazën prej nga hartuesit e politikave duhet të fillojnë për të hartuar një zgjidhje. Është thelbësore që të bëhet me kujdes dizajnimi -- një kornizë e gjerë për Kosovën mund të mbijetojë ose të fundoset në valët e lumit Ibër.

## A. NJË QYTET I NDARË NË DYSH

Nuk ekzistojnë forume adekuate për dialog midis këtyre komuniteteve të ndara. Edhe pse eksisitojnë disa radio dhe stacione televizive në Mitrovicë dhe rreth saj, asnjëra palë nuk transmeton emisione në gjuhën e tjetrit lidhur me çështjet e Mitrovicës.[43] Kolapsi ekonomik ka ndihmuar dhe thelluar ndarjen. Të rinjtë në jug të Mitrovicës duken të lodhur nga dhuna, dhe ekziston një kërkesë e heshtur sociale për dialog[44], por ka vetëm pak mundësi për këtë.

Ata që janë në pushtet, në dy anët e lumit, nuk tregojnë aspak interesim për ndërtimin e paqes. Një OJQ që mirret me zgjidhje të konflikteve raporton se iniciativat e mirëfillta që fillojnë në nivelin bazë groposen në nivelin komunal në jug. [45] Në anën e serbëve, KNS-ja vazhdimisht ushqen opinionin për një kërcënim të pashmangshëm nga shqiptarët. Për shkak të mungesës së kontakteve dhe gatishmërisë nga të dy anët për mobilizim për betejë, çdo incident është rrezik për eskalim, përderisa nuk ka strukturë përmes së cilës të mund të hulumtuhen mundësitë për ndërtim të besimit.

Në vet qytetin e Mitrovicës të dy komunitetet e injorojnë shumë njëra-tjetrën. Serbët e shohin territorin në jug të lumit Ibër si armiqësor, djerrinë një etnike ku ata nuk dëshirojnë të rrezikojnë të shkojnë.[46] Përveç që e dijnë se e ndajnë së bashku të njëjtën varfëri të mjerë, shqiptarët dijnë pak për jetën matanë bregut verior. Ata supozojnë se është nën kontrollin e Beogradit dhe gabimisht besojnë se, për shkak të dominimit të tij në paraqitje në lajmet televizive shqiptare të Kosovës, Oliver Ivanoviqi ka ndikimin më të madh atje. Disa duket se kishin dëgjuar për Jakshiqin apo Milan Ivanoviqin, liderët e KNS-së të cilët janë ata që vendosin.

Është paradoksale që të dy komunitetet ndihen se janë buzë disfatës. Ekonomia e shembur vë një re të zezë mbi të gjithë. Serbët gjithnjë e më shumë shfaqin një ndjenjë të pashmangshmërisë lidhur me pavarësinë. Shumë pak prej tyre planifikojnë një të ardhme në Mitrovicë, dhe ata që munden ta bëjnë këtë kanë investuar në shtëpi në Serbinë. Shqiptarët shprehin pesimizmin e tyre lidhur me status-quo-n, për të cilën mendojnë dhe ndjehen të pafuqishëm ta ndërrojnë, duke besuar se ndarja e qytetit është e planifikuar më parë nga bashkësia ndërkombëtare.

### 1. Topografia urbane e ndarjes

"Thënë troç -- serbët e morën Trepçën, dhe ne e morëm stacionin e autobusave. Së paku ne e kemi kënaqësinë që jemi në anën më me diell të Mitrovicës -- Në veri bën më ftohtë", thumboi me fjalë një satirist shqiptar i Kosovës në dhjetor të vitit 1999.[47] Sot lidhjet e ashpra të qytetit ende pengojnë jetën e të dy komuniteteve -- një çmim që serbët ende janë të gatshëm ta paguajnë për të kthyer sigurinë e fituar. Shumica e ndërtesave më moderne dhe të larta gjenden në veri, një qendër qyteti e zhvendosur e ndarë nga zonat e brendshme apo shtëpitë e ndërtuara private që formojnë fshatin e madh të jugut të Mitrovicës. Varrezat muslimane të para vitit 1999 janë në veri, ndërsa ato ortodokse janë në jug. Godinat kulturore dhe sportive janë në jug, spitali rajonal është në veri. 20,000 nxënës shqiptarë ndrydhen në po të njëjtin numër shkollash në jug sa kanë edhe 4,000 serbë në veri. Mitrovica e bashkuar që dikur ishte burim për tërë Kosovën tani i mohohet të dyja komuniteteve. I largët është mendimi se Mitrovica mund të ndihmojë në përparimin e zhvillimit të Kosovës, ajo tashmë është bërë një qytet fantazmë, prej nga kanë ikur shumica e njerëzve me ambicie.

### 2. Ndarja e nxitur nga një ekonomi e rrënuar

Të gjithë të intervistuarit në Mitrovicë falsin se si individë, familje dhe grupe të fuqishme, në të dyja anët e ndarjes etnike, bashkëpunojnë në kontrabandë, trafikim, vjedhje veturash, dhe aktivitete tjera të paligjshme duke mbajtur një ambient politik dhe social që e bën tabu për qytetarët e thjeshtë që të punojnë së bashku.[48]

---

[43] Stacioni televiziv privat shqiptar në Mitrovicë transmenton disa emisione në gjuhën boshnjake, që dallon shumë pak nga gjuha serbe. Bëhet e ditur se OSBE-ja ka hedhur poshtë një projekt-propozim në vlerë prej 50,000 Euro për pajisje që do t'i mundësonin stacionit televiziv shqiptar TV Mitrovica dhe radio stacionit Serb Kontakt Plus shkëmbimin e raporteve televizive dhe lajmeve. Informacioni iu mundësua Grupit të Krizave nga një burim i UNMIK-ut, gusht 2005.

[44] Intervista të Grupit të Krizave, në Jug të Mitrovicës, 3-9 qershor 2005.

[45] Intervistë e Grupit të Krizave me stafin e Nansen Dialogue të Kosovës, 1 dhjetor 2004.

[46] Për dallim, serbët në enklavat më në jug në muajt e fundit janë bërë gjithnjë e më shumë aventurierë.

[47] Adem Mikullovci në një transmetim të RTK-së në vitin 1999.

[48] Arrestimi i bërë së fundi i një serbi dhe një shqiptari – që të dy pjesëtarë të SHPK-së që bashkëpunonin në përcjelljen e një kamioni që kontrabandonte mallra nga veriu në jug është një

Gjendja e vështirë ekonomike skajshmërisht për të dyja komunitetet gjithnjë e më shumë po e kundërshton dhe sfidon çështjen e statusit. Gjeneratat e vjetra e mbështesin besimin e tyre në potencialin e kompleksit Trepça. Të intervistuarit e rinjë shohin një ekonomi më të larmishme në të ardhmen, duke theksuar zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. "Shtytja e shpejtë ekonomike" e paramenduar e planit të PSSP-së Steiner për të bartur Agjensionin Kosovar të Mirëbesimit (AKM) nga Prishtina në veri të Mitrovicës nuk u materializua kurrë - stafi i saj nuk deshi të shkonte në një vend të tillë provincial dhe plot dhunë, dhe ideja gradualisht u shua.[49] Ndërrimi i lojalitetit në veri të Mitrovicës nga Oliver Ivanoviqi tek Milan Ivanoviqi dhe radikalët KNS e ka sjellur kontrollin në rritje të resurseve të kufizuara buxhetore të këtyre të fundit, mundësitë për punësim, dhe gatishmërinë e tyre për të përdorur frikësimin. Investimet e reja do të tërhiqnin njerëzit në një drejtim tejtër politik. Një pjesë e serbëve në veri janë të zemëruar për çmimin ekonomik të cilin e paguajnë për shkak të shkëputjes nga pjesa tjetër e Kosovës. Të tjerët, duke u brengosur për pavarësinë, thonë, "vetëm sikur të kisha një vend pune, nuk do të kisha menduar shumë për këto gjëra". Një shqiptare theksoi kërkesën e madhe nga serbët e veriut të Mitrovicës për vende pune me pagesë mujore prej €250 në një gazetë të re shumëgjuhëshe që ajo po e përgatit për për treg.[50] Pronari serb i një kompanie ndërtimore në afërsi të urës ndarëse të komunës vërejti se shqiptarët kanë filluar të shkojnë tek ai për të kërkuar punë: "ata nuk shqetësohen se kush jam unë dhe kanë filluar të fokusohen plotësisht në biznes".[51]

Të dyja komunitetet e akuzojnë UNMIK-un për neglizhencë totale për ekonominë; disa në jug e kritikojnë edhe pasivitetin e Prishtinës. Një banor i veriut u ankua: "Çdo gjë që bën UNMIK-u në veri të Mitrovicës është kaotike, e pakoordinuar dhe nuk iu përgjigjet nevojave të njerëzve. Ata po na ndërtojnë sheshe lodrash në vend se të gjenerojnë vende pune. Pikërisht për shkak të këtyre gabimeve grupet radikale dhe kriminale -- kryesisht të mbledhur rreth Milan Ivanoviqit -- i kanë fituar pikët e tyre, të hollat dhe pushtetin".[52] Dyqanet dhe kiosqet përgjatë arteries veriore në Mitrovicë rrugës 'Mbreti Petër' nuk janë të sistemuara apo nuk i paguajnë tatim UNMIK-ut por për mbrojtje iu paguajnë të holla bosëve kriminal të veriut. Të hollat që krijuan gjallërimin jetëshkurtër, përfshirë ato nga diaspora shqiptare dhe nga donatorët, më parë u përdorën për ndërtime sesa për ndërmarrje prodhuese. Fondet nga donatorët, Beogradi dhe nga Prishtina ndahen joformalisht nga elita lokale. Një biznismen vendor komentoi:

> Të hollat ishin investuar keq, sikur në Bosnjë, dhe jo vetëm pse shumica e tyre përfundoi në xhepat e dikujt, por për shkak të vet projekteve ….Ndërtimi i ndërtesave [është]…më lirë dhe mundëson që më lehtë të vidhen paratë, përderisa nëse investon në prodhim duhet kohë më e gjatë, keqpërdorimi është shumë më i komplikuar.... Donatorët ishin të interesuar vetëm për të bërë diçka shpejt dhe bukur, me 'rezultate' konkrete.[53]

## 3. Gjykatat

Këmbëngulja e Serbisë dhe mungesa e strategjisë dhe pushtetit të UNMIK-ut lejojnë që ndarja juridike të shtresohet. Gjykatat serbe dhe ato të UNMIK-ut ekzistojnë pranë njëra-tjetrës në veri të Kosovës, dhe qytetarët e përdorin cilëndo nga ato që e konsiderojnë se mund t'ua zgjidhë problemet. Adresimi në ligjin e Kosovës është më mbizotërues në pjesën e administrimit formal të UNMIK-ut në veri të Mitrovicës dhe në Zveçan (ku përdoren gjykatat e Mitrovicës) sesa në vendet më të largëta si Zubin Potok dhe Leposaviqi. Vërtet, gjykata rajonale e UMMIK-ut në Mitrovicë është një ishull kurreshtar, me shumicë shqiptare, e bashkuar me jugun përmes një autobusi për shkuarje dhe ardhje,[54] prezenca e të cilit tolerohet nga KNS-ja dhe që kryesohet nga një kryetar shqiptar i cili jeton në Zveçan. Megjithate, pranimi i gjykatës nga shoqëria është i vogël ende . Me vetëm një numër të vogël të serbëve të gatshëm që t'i bashkohen sistemit dhe administrimit gjyqësor të UNMIK-ut, përparësia e tij prishet në jug të lumit Ibër. Prokurorët shqiptarë nuk mund lëvizin përpara në një mjedis serb, dhe gjykatësit aplikojnë paraburgimet më me rreptësi tek serbët, të cilët përndryshe mund të ikin shumë lehtë në Serbi.

---

shembull se si bashkëpunimi ndëretnik është kufizuar në sferën klandestine për "persona të caktuar". Burimet policore bëjnë të ditur se pronarët shqiptarë të një hoteli të madh në rrugën në jug të Mitrovicës janë të përfshirë në forma të ngjajshme të bashkëpunimit, duke pranuar për çdo muaj vetura me femra të trafikuara nga Serbia.

[49] Jo shumë kohë më parë, afërsisht €1.2 milionë ishin shpenzuar për të renovuar objektin në veri të Mitrovicës në të cilin ishte paraparë që të vendosej AKM-ja. Në fund të vitit 2002, duke pasur parasysh tendencën e natyrshme për dhunë që ekzistonte në Mitrovicë, shefi i atëhershëm i AKM-së Jurgen Mendritsky kërkoi që të ndërtohej një derë me mure çeliku pranë zyres së tij në katin e sipërm. Intervistë e Grupit të Krizave me një ish-punëtor të Shtyllës së Bashkimit Evropian brenda UNMIK-ut, 29 korrik 2005.

[50] Intervistë e Grupit të Krizave me Valdete Idrizin, drejtuese OJQ-së Ndërtimi i Komunitetit në Mitrovicë, 16 shkurt 2005.

[51] Intervistë e Grupit të Krizave, 27 qershor 2005.

[52] Intervistë e Grupit të Krizave, 2005.

[53] Intervistë e Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, 27 qershor 2005.

[54] Para pak kohësh UNMIK-u ka ndërprerë qarkullimin e autobusit. Është bërë e ditur se, KNS-ja ka ndërhyrë që të financojë qarkullimin e tij.

Mosnjohja e dokumenteve personale të UNMIK-ut nga Serbia dhe shumë shtete tjera ka krijuar një treg për shërbimet për dokumente të gjykatave paralele serbe. Megjithatë, një zonë ku gjykatat e UNMIK-ut kanë përparësi është kompetenca e tyre, për shkak të rritjes së SHPK-së pranë policisë së UNMIK-ut në veri, me qëllim që t'i ekzekutojnë vendimet e tyre (siç janë urdhërat për dëbime) nga trupa legjitime. Zhvillimi i sektorit bankar në veri ka inkurajuar përdorimin më të madh të gjykatave të UNMIK-ut pasi që kontratat për kredi gjithashtu kërkojnë një mekanizëm zbatues të besueshëm. Kjo sugjeron që UNMIK-u mund të konsolidojë gjykatat e veta dhe aplikimin e ligjeve të Kosovës edhe më tej duke ndihmuar zhvillimin e më shumë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe duke përmirësuar dhe zhvilluar me mirë zyrat e regjistrimit të pronës. Sapo të përcaktohet statusi përfundimtar i Kosovës, dokumentet personale zyrtare që tani lëshohen nga autoritetet e Kosovës me sa duket do të njihen si të vlefshme edhe më gjerë në rajon dhe në botë, që poashtu do të ndihmonte që sistemi i gjykatave në Kosovë i zhvilluar nga UNMIK-u të fitojë një mbështje më të madhe.

## 4. Krijimi i një strehe në zonën e pakontrolluar

KNS-ja ka përfituar nga ambienti relativisht i paligjshëm duke mobilizuar shumë nga të zhvendosurit serbë nga pjesë të tjera të Kosovës -- që përbëjnë një të tretën e të gjithë serbëve në veri. Shumë nga këta të zhvendosur janë vendosur në shtëpitë e shqiptarëve, dhe rreziku nga demonstratat dhe kundërshtimet e tyre eventuale ka vështirësuar punën e Drejtoratin të UNMIK-ut për Çështje Pronësore Banesore (HPD) që t'i sistemojë ankesat e prezantuara në veri të Mitrovicës.[55] Kjo gjiathashtu iu mundëson udhëheqësve lokal që të kenë mbulesë për grabitje dhe mashtrime të organizuara në lidhje me shtëpitë e uzurpuara. Ngjashëm, situata kaotike që mbretëron lidhur me targat e veturave ndihmon rrjetin e vjedhjes së veturave.[56]

Ndonëse mund të thuhet se disa po e shijojnë jetën e tanishme në Mitrovicë, shumë serbë, siç njoftohet, përfitojnë nga paga të shumëfishta qeveritare. Mungesa e një autoriteti të vetëm dhe të padiskutueshëm gjithashtu nënkupton se atje nuk ka mekanizma që bëjnë presion për pagesën e faturave të shërbimeve komunale. Këta faktorë bëjnë që vakumi ekzistues i pa definuar të jetë më i përballueshëm. Biznesi më i madh, kontrabandimi dhe ndikimi i krimit ka bërë që ambienti dhe shoqëria të orientohen drejt nevojave të tyre ndonëse tërheq mbështetje reciproke me KNS-në. Disa serbë nga veriu i Mitrovicës ankohen për influencën e "grupit të Kolashinit" nga Kollashini i Ibrit nga rajoni i Zubin Potokut.[57] Disa figura udhëheqëse të KNS-së vijnë nga ky rajon, përfshirë Jakshiqin, ish udhëheqësin e rojave të urës Vlladimir Rakiqin, dhe udhëheqësin e ri të QKS në veriun e Mitrovicës, Momir Kosalloviqin. Një politikan i njohur serb i veriut të Kosovës tha se dominimi i grupit ka ngulfatur depërtimin e njerëzve të rinjë dhe të politikave të reja. Asnjë nga vëzhguesit nuk ka dashur që të lëshohet në detaje, duke tërhequr vëmendjen se marrëdhëniet e pazgjidhura me shqiptarët ende mbesin problemi numër një për serbët e veriut të Kosovës,[58] por një biznesmen lokal lidhur me grupin e Kolashinit that se "I gjithë tensionimi rreth sigurisë dhe kriminalitetit në Mitrovicë vjen prej tyre".[59]

Elita e biznesit dhe politikës së serbëve të veriut, përfshirë edhe KNS-në, për shkak të mungesës së kontrollit efikas që Prishtina ka mbi vijën kufitare administrative me Serbinë, përfitojnë nga TVSH, doganat dhe mbledhja indirekte e taksave. Influenca e tyre mbi zyrtarët serbë të policisë kufitare të SHPK-së dhe shërbimit doganor të UNMIK-ut të cilët kontrollojnë vendkalimet në Leposaviq dhe në Zubin Potok po shfaq vështirësi për të dy komandat e shërbimeve.[60] Pavarësisht nga heqja zyrtare, bazuar në kodin e ri të Kosovës të paraqitur në qershor 2005, UNMIK-u lejon këto "porta" për të përdorur procedurat e shpejta të cilat në fakt lejojnë kamionët që bartin shumicën e ushqimit që importohet në Kosovë dhe mbledhjen e taksave. Si rezultat i kësaj si p.sh. ngarkesa me alkohol, kafe, cigare dhe karburante "zhduken" gjatë rrugës për në terminalin doganor që gjindet në jug të Mitrovicës. Lëndë druri, bagëti, pajisje elektronike dhe prodhime tjera vendore gjithashtu qarkullojnë përmes këtyre dy portave

[55] Drejtorati për Çështje Pronësore Banesore (HPD) është pjesë përbërëse e veçantë e Administratës Civile të UNMIK-ut (shtylla II) me juridiksion të vetëm mbi tre lloje apo forma të pretendimeve për prona banesore: nga individë që kishin humbur pronën përmes diskriminimit pas 23 marsit të vitit 1989; që kishin hyrë në transakcione joformale që nuk kishin mundësi të regjistroheshin për shkak të ligjeve diskriminuese midis 24 marsit 1989 dhe 13 tetorit 1999; dhe që pa vullnetin e tyre kishin humbur pronat pas 24 marsit të vitit 1999. Shih www.hpdkosovo.org.

[56] Pasi që targat e Kosovës janë të padëshirueshme, shumë vetura lëvizin pa to. Policia nuk vepron, prandaj një veturë e vjedhur mund të jetë shumë lehtë anonime.

[57] Intervista të Grupit të Krizave, maj 2005.

[58] Intervista të Grupit të Krizave, veri i Mitrovicës dhe Leposaviq, 23 qershor 2005.

[59] Intervistë e Grupit të Krizave, 27 maj 2005.

[60] Në Prishtinë, një zyrtar i lartë i doganave të UNMIK-ut kishte vërejtur: "Mitrovica është problem politik. Njerëzit tanë të doganave atje lart veshin uniformat tona por në realitet ata kontrollohen nga rojat e urës. Arsyeja e vetme se pse serbët pranuan të bëheshin zyrtarë të doganave të UNMIK-ut, dhe…pse ata u lejuan që të pranojnë vendin e punës janë të ardhurat e ndaluara që u shkojnë bosëve të tyre në veriun e Mitrovicës, dhe vet atyre….Ato dy porta i furnizojnë me mjaft para rojat e urës dhe KNS-në. Intervistë e Grupit të Krizave, 22 korrik 2005.

derisa UNMIK-u vazhdon ti mbyll sytë, ndërsa propozimet për të plotësuar personelin me zyrtarë shqiptarë i cilëson si provokim për sigurisë.

KNS-ja demonstron rolin e saj si mbrojte e interesit të biznesit në veriun e Kosovës kur në janar-shkurt 2005 organizoi me sukses protestën kundër rregullave të reja të Beogradit për mbledhjen e TVSH-së në mallrat që hyjnë në Kosovë dhe pozicionimin e zyrtarëve doganorë në vendkalime.[61] Protestat kishin një sukses të dyfishtë. Udhëheqësi politik i KNS-së, partia DSS e Kryeministrit të Serbisë Koshtunica, bëri trysni tek partneri i ri i koalicionit G-17 Plus -- anëtar i së cilës është ministri i financave -- që të zbusë masat. Derisa G-17 Plus akuzonte për krijimin e një "lobimi të kontrabantistëve", argumentimi i DSS ishte se rregullorja përbënte një legjitimim jopatriotik se Kosova ishte një territor i humbur. Nga komromisis që doli, DSS dhe KNS-ja morën atë që dëshironin të marrin. Ata heqën dorë nga TVSH-ja dhe vazhdojnë që për çdo biznes të regjistruar në Beograd të importojnë mallra nga Serbia në Kosovë. Kjo përjashtoi kompanitë e shqiptarëve dhe kështu mundëson monopolin në importet nga Serbia të liruara nga TVSH-ja.

## B. MJEDISI I PAFAVORSHËM PËR KTHIME

### 1. Të zhvendosurit

Komunitetet e zhvendosura shqiptare dhe serbe të Mitrovicës, që të dyja, kanë mbetur -- viktimë dhe riprodhues të tensionit ndëretnik. Ato janë shumë josimetrike, të përbëra nga shqiptarët nga Mitrovica dhe nga serbë të dëbuar nga pjesë të tjera të Kosovës, një numër i madh nga perëndimi i Kosovës në vitin 1999, dhe vala tjetër nga qendra e Kosovës në marsin e vitit 2004.

Në Prishtinë gjallëria e tregut të pronave dhe puna e Drejtoratit të UNMIK-ut për Çështje Pronësore Banesore (HPD) kanë lejuar që shumë serbë së paku të marrin kompenzim për humbjet e shtëpive dhe një mundësi që të rifillojnë jetën diku tjetër, por pjesë e pasurive të banorëve të Mitrovicës janë bllokuar. HPD ka marrë, përafërsisht, numër të barabartë të ankesave (1,287 and 1,266) për shtëpitë në veri dhe jug të lumit. Derisa një numër i madh i serbëve të zhvendosur që pronat i kanë në jug, ua kanë shitur ato blerësve shqiptarë, në veri është një gjendje pa rrugëdalje për shkak të okupimit ilegal të pronave nga të zhvendosurit serbë dhe banorët lokal, gjë e cila kufizon mundësitë e HPD-së që me efikasitet t'i dëbojë ata nga atje; mungesës së kapitalit dhe vullnetit të mirë në veri për të blerë pronat; dhe mungesës së vullnetit të shqiptarëve për t'i shitur pronat në veri. Për pasojë, pronat përtej lumit Ibër janë më pak të vlefshme, dhe ka pak fuqi blerëse. E tërë kjo i ka kontribuar përcaktimit të serbëve për të bllokuar kthimin e shqiptarëve në veri. Shumë nga 6,000 romët të cilët kanë jetuar në lagjen tashmë të shkatërruar në bregun jugor kanë lëshuar Kosovën. Të tjerët gjinden në pjesët e rrezikshme dhe të ndotura në Zveçan. Megjithatë, romët nuk janë të gatshëm që të bashkëpunojnë me planet për rindërtimin e lagjes, e kjo për shkak se ata të cilët tani jetojnë jashtë Kosovës frikohen se do të kthehen me forcë.

Përcaktimi i numrit të popullatës së zhvendosur shqiptare që ka mbetur pa u definuar është i vështirë por i rëndësishëm për përcaktimin se ç'lloj konfiguracioni të komunës do t'i bënte serbët të sigurtë për të pranuar kthimin e shqiptarëve. Propozimi i ESI-t pretendonte se shumica e nevojshme serbe do të mund të vihej në skenë me bashkimin e veriut të Mitrovicës me Zveçanin. Para luftës popullata shqiptare në veri të Mitrovicës pretendohet të ketë qenë rreth 10,000 por mund të ketë qenë edhe më e vogël, rreth 8,000. Përafërsisht 2,100 është numri i atyre që aktualisht janë në veri, duke mos numëruar 6,000 deri 8,000 të zhvendosur. Disa prej tyre tashmë i kanë shitur shtëpitë e tyre dhe të tjerë orvaten që ta bëjnë këtë, ndonëse ata nuk kishin pasur sukses në këtë si dhe ishin rrezikuar që të izoloheshin nga komuniteti i tyre. Serbët në veriun e Mitrovicës aktualisht numërojnë 12,000 deri 15,000, përfshirë të zhvendosurit nga pjesë të tjera të Kosovës, si dhe specialistë dhe studentë nga Serbia. Kjo popullatë është e kërcënuar nga rënia e numrit të popullatës, derisa popullata shqiptare ka tendenca të rritjes së saj në masë të madhe për shkak te natalitetit të lartë.

Banorët e qytetit nga të dy anët, për efektin dëmtues të pretenduar, fajësojnë pjesëtarët e anës tjetër të ardhur pas luftës. Me të zhvendosurit të cilët tash përbëjnë një pjesë të madhe të komunitetit të tyre, serbët provojnë t'i shohin shqiptarët dhe poretendimet e tyre në veri si një kërcënim kryesor: "…një shqiptar erdhi 'vetëm që t'i bënte pagesat e apartamentit të tij të vjetër'. Ditën tjetër ai u kthye me HPD…."[62] Megjithatë, disa mund të parashikojnë se mund të jetojnë me shqiptarët e vërtetë që janë kthyer, "të cilët kanë jetuar atje para vitit 1999", dhe deklarojnë, "ne nuk frikohemi nga banorët e Mitrovicës, por nga të

[61] Përveç importeve të ndaluara në Serbi përmes Kosovës, ministri i financave Dinkiq ishte i shqetësuar se TVSH-ja nuk po mirrej parasysh apo po kompenzohej për mallrat serbe që po hynin në Kosovë bazuar në pretendimet jobindëse se ato po destinoheshin për export, apo me dokumente adekuate nga shërbimi doganor i UNMIK-ut se TVSH-ja është paguar. Pasi që Serbia para qershorit të vitit 2005 nuk kontrollonte kufinjtë e Kosovës me Maqedoninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi dhe nuk bashkëpunonte me Doganat e UNMIK-ut, nuk kishte asnjë mënyrë të verifikimit të këtyre pohimeve.

[62] Intervistë e Grupit të Krizave me një serb të veriut të Mitrovicës, me prejardhje nga Gjakova, qytet në Kosovën perëndimore, maj 2005.

ardhurit tjerë të cilët nuk na shohin si individë".[63] Një banor serb që për një kohë të gjatë jeton atje i frikësuar nga sulmet e shqiptarëve përgjatë lumit, në korrikun e vitit 2004, tha; "Banorët e Mitrovicës kurrë nuk do të na sulmonin neve, sepse para luftës kemi jetuar mirë me njëri tjetrin, dhe tash në të dy anët e qytetit jemi lodhur nga fshatarët e ardhur këtu -- e edhe më herët kishim pasur mjaft të tillë".[64] Njëlloj, shumë të zhvendosur shqiptarë janë të bindur se janë të zhvendosurit serbë, dhe jo ish fqinjët e tyre, ata që e pengojnë kthimin e tyre.[65] Në të vërtetë të intervistuarit e Grupit të Krizave në veri zbuluan se të zhvendosurit serbë orvaten që shqiptarëve t'iu referohen me terme nënçmuese për dallim nga banorët serbë të cilët për një kohë të gjatë jetojnë atje.

Në Mitrovicën e para luftës një pjesë më e madhe e serbëve, më shumë se sa në pjesë të tjera të Kosovës, kanë folur gjuhën shqipe, derisa banorët shqiptarë janë mburrë me faktin se "kanë folur gjuhën serbe më mirë sesa shumica e serbëve të Kosovës " dhe shpresohet se identiteti i Mitrovicës do të mund ta mposhtë ndarjen etnike. Organizimi i një demonstrate të përbashkët ku do të merrnin pjesë të zhvendosurit serbë dhe shqiptarë nga Mitrovica për të protestuar lidhur me mungesën e progresit në procesin e kthimit do të ishte një postulatë optimiste.[66] Një tjetër përpjekje që vlen të përmendet është ajo e përfaqësuesve të më se njëzet organizatave vendore të shoqërisë civile për të mbrojtur Kishën Ortodokse serbe në jug të Mitrovicës më 18 mars 2004, para se ata të ishin të vërshuar dhe të rrahur nga një turmë njerëzish.[67]

## 2. Multietniciteti i kontrolluar

Siç theksojnë shumë serbë nga veriu i Mitrovicës, gjysma e qytetit të tyre mund të bëhet hapësira më multietnike urbane në Kosovë. Më shumë se 2,000 shqiptarë qëndrojnë, shumica në tre lokacione. Afërsisht 1,000 prej tyre jetojnë në "tre rrokaqiejtë" afër lumit dhe një numër i ngjashëm i tyre në Lagjen e Boshnjakëve. Në brendinë e thellë të veriut të Mitrovicës, jetojnë diku 500 shqiptarë në rrethinën e lagjes së përzier Kodra e Minatorëve ("Kodra Coca Cola"). Me 1,000 deri 2,000 boshnjakë, turqë dhe romë, joserbët përbëjnë rreth një të tretën e popullatës së veriut të Mitrovicës

Megjithatë, ndarja de facto kufizon qarkullimin e lirë për shqiptarët, veçanërisht të të rriturve. Ndonëse postblloku i KFOR-it dhe telat me gjemba janë larguar, shqiptarët nga lagja e boshnjakëve dhe nga "tre rrokaqiejtë" nuk rrezikojnë që të shkojnë brenda në veri. Jeta e tyre është e ndërlidhur me jugun përmes urëkalimit të ri për këmbësorë. Veturat mund të udhëtojnë prej dhe për tek "tre rrokaqiejt" përmes urës rrugore kah ana perëndimore e Mitrovicës, ku shtrihet fshati shqiptar Suhodoll në veri të bregut, i cili është i veçantë nga pjesa tjetër e veriut të Mitrovicës i përbërë nga shtëpi të përziera serbe dhe shtëpi të zbrazëta, të dëmtuara apo të shkatërruara shqiptare. Shqiptarët e lagjes së boshnjakëve -- një rrethinë në të cilën ata jetojnë së bashku me boshnjakët dhe serbët, edhe pse të ndarë së voni në bazë të rrugëve -- përdorin urën rrugore lindore për t'u lidhur me bregun jugor. Në javët para përpjekjeve të UNMIK-ut për të hapur urën kryesore për trafik rrugor, në qershor dhe korrik të vitit 2005, ata kishin filluar që ta përdorin atë urë për kalim në këmbë. Numër i kufizuar i veturave me targa të Kosovës gjithashtu filloi të qarkullojë midis dy zonave të afërta shqiptare. Veturat kalonin nëpër urën kryesore të pjesës veriore pa u përpjekur që ta kalojnë atë ku edhe ishini toleruar nga serbët. Që nga korriku 2005, rojat e urës kishin okupuar një shtëpi tek hyrja e lagjes nga ana e urës kryesore. Shtëpia kishte qenë postbllok i KFOR-it deri në fillim të verës. Banorët shqiptarë ankohen se kur kalojnë aty pari ata u ekspozohen fyerjeve dhe kërcënimeve.

Në lagjen, Kodra e Minatorëve, ekziston një përzierje e vërtetë midis banorëve shqiptarë dhe serbë, fëmijët e të cilëve madje edhe luajnë bashkë. Por kjo nuk tregon se këtyre shqiptarëve iu lejohet lëvizja e lirë në qendrën e qytetit në veri. Në maj UNMIK-u anuloi linjën e autobusit që shkonte dhe vinte që andej dhe e cila lidhte këtë komunitet me jugun. Një shërbim privat i kompanisë së autobusëve, që e kishte zëvendësuar atë, kushtonte 50 euro cent për secilin drejtim. Kështu gjithnjë e më shumë shqiptarët nga 'Kodra e Minatorëve' udhëtojnë në këmbë me gjithë rrezikun që u kanoset, përmes rrugës 'Mbreti Peter', për të arritur në jug. Kjo ushqeu etjen e serbëve për dhunë dhe në majin e vitit 2005 së paku një shqiptar ishte rrahur atje.

Frika kryesore e serbëve nuk është aq shumë nga një sulm i shqipëtarëve të armatosur përgjatë lumit sa është nga rrjedha demografike e veriut të Mitrovicës të cilën shohin se mund të kthehet kundër tyre, përfshirë edhe nga kapitali privat shqiptarë.[68] Për të parandaluar rënien në duart e

[63] Diskutime private të Grupit të Krizave, 4 qershor 2005.

[64] Blerim Xhemajli dhe Musa Mustafa, "Serbët do të sulmohen prapë, slogani më i përfolur në veri të Kosovës", *Koha Ditore*, 3 korrik 2004.

[65] Intervista të Grupit të Krizave, në Jug të Mitrovicës, qershor 2005.

[66] Pjesëmarrësit në një tryezë të rrumbullakët të mbledhur nga Grupi i Krizave, në Jug të Mitrovicës, 26 qershor 2005.

[67] Intervistë e Grupit të Krizave me Valdete Idrizin, Ndërtimi i Komunitetit në Mitrovicë, në Jug të Mitrovicës, 16 shkurt 2005.

[68] Disa serbë me tendencë citojnë pamundësinë që kishte "kultura e tyre e civilizuar" të mbijetonte në afërsi të ngushtë me "kulturën agresive" të shqiptarëve. Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kolapsi në Kosovë*, fq. 32-33, për diskutim lidhur me tendecat e shoqërisë së shqiptarëve të Kosovës për përjashtim të joshqiptarëve.

shqiptarëve, 'Qendra Koordinuese për Kosovën' e qeverisë së Serbisë financoi serbët për blerjen e shtëpive të vëna në shitje në kufi me komunitetin shqiptar në veriun e Mitrovicës: në 'Lagja e boshnjakëve', tek "tre rrokaqiejtë", dhe në 'Kodra e Minatorëve'.

Frika nga pamundësia për të kontrolluar ambientin e tyre, nga prania e shumë shqiptarëve të rinjë që bredhin në veri të cilët duhet ndjekur, e përforcon frikën serbe në hapin e parë të UNMIK-ut për hapjen e urës kryesore për tërë trafikun. Ky hap është poashtu një fyerje për shpresën e fshehur të serbëve për mbajtjen e shumëetnicitetit në një ambient të kontrolluar. Edhe pse KNS-ja është larg ndërtimit të një oferte të tillë, disa serbë të Mitrovicës së veriut nuk do të kundërshtonin normalizimin përmes kthimit të kufizuar dhe të kontrolluar të shqiptarëve, veçanërisht të fytyrave të njohura, përderisa të mund të garantojnë shumicën e tyre dhe fjalën e fundit për vendime në pjesën e tyre të qytetit.[69]

## C. MUNGESA E LIDERSHIPIT

Asnjëri nga komunitetet nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të siguruar mbështetjen e provincializmit vëllazëror të Kosovës dhe sundimit të kufizuar ambicioz. Shqiptarët e Mitrovicës kanë dështuar të bëjnë sa duhet që Prishtina të merret me ta apo të lobojnë përmes mediave për angazhim aktiv në problemet e tyre. Siç tha një ish banor: "Nëse fëmija nuk qan, nëna nuk e merr".[70] Liderët e KNS-së në veri duken se pajtohen me mungesën e legjitimitetit elektoral, duke preferuar që të ushtrojnë kontroll pa përgjegësi përmes përkrahjes dhe kërcënimit, një rregullim që u lejon atyre t'iu shmangen obligimeve reprezentuese dhe vazhdimisht të refuzojnë takimet me zyrtarët që nuk i pëlqejnë.[71] KNS-ja dhe autoritetet komunale në jug të Mitrovicës e konsiderojnë veten si çelës portash për lidershipin në kryeqytetet e tyre përkatëse, Beogradin dhe Prishtinën, duke mos dashur që të shqyrtojnë mundësitë politike me njëra-tjetrën. Mirëpo, KNS-ja ka filluar që në mënyrë diskrete të shqyrtojë mundësitë për inkuadrim në negociatat lidhur me decentralizimin.

### 1. Duke Qëndruar nën parapet

Të dy komuniteteve iu mungon respekti dhe besimi për udhëheqësit e tyre vendorë. Shumë nga veriu nuk e pëlqejnë Millan Ivanoviqin, duke e ndërlidhur atë me bandat vrastare dhe kriminalitetin. Ai e mban veten në skenë si lider përmes mbrojtjes, kërcënimit, anti-shqiptarizmit dhe mbështetjes nga Serbia. Megjithatë, shumica e mbështesin atë dhe KNS-në nga frika se askush tjetër nuk do të mund t'i mbronte ata.

Zhvillimi ideologjik i KNS-së është si i vonuar ashtu edhe i pakoordinuar. Personaliteti i saj, Jakshiq, nuk ka shkuar më larg në të menduarit mbi statusin përtej planit të Beogradit për decentralizim, të bërë publik në prillin e vitit 2004. Derisa sugjeron që "Tiroli Jugor" të jetë model për Kosovën, ai duket i pa aftë për të shpjeguar se çka nënkupton kjo.[72] Ai pranon idenë e ESI për bashkimin e veriut të Mitrovicës me Zveçanin, por zëvendësi i tij, Nebojsha Joviç, insiston që veriu i Mitrovicës të ketë autoritet të veçantë komunal.[73]

KNS-ja e zëvendëson anti-shqiptarizmin e madh, "I përafërt me Nazizmin dhe teoritë tjera racore ",[74] dhe preokupohet me territorin e shtetit dhe besnikërinë ndaj Beogradit për zhvillimin e ideve lidhur me çështjet ditore. Të ushqyerit e frikës nga një sulm i shqiptarëve shërben për mbajtjen e komunitetit serbë nën tension të vazhdueshëm, të gatshëm për mobilizim, dhe të varur nga politikanët radikal. Disa vëzhgues e konsiderojnë si thashetheme fushatën për valën e sulmeve të mundshme të cilat gjatë vitit të kaluar me padurim janë reflektuar prapa në Kosovë nga mediat e vendosura në Beograd për të qenë inspirm për KNS-në.

Kur veterani i Rojave të Urës, Oliver Ivanovoq, u inkuadrua në nivelet politike në Kosovë, ai tentonte t'i largonte njerëzit që kërkonin favore nga ai. KNS-ja mbante qëndrim të kundërt, duke shtrirë ndikimin përmes shpërndarjes së favoreve dhe përkrahjeve të një anshme, punësimit të njerëzve, shqyrtimit të marrëveshjeve me ta, dhe duke shpenzuar fondet e qeverisë në mënyrën e vet. Një vëzhgues i afërt me serbët KNS-në e quan "më e keqja e politikës serbe…një grup politik populistësh që

---

[69] Për shembull, Oliver Ivanoviqi parafytyron dhe parasheh se nëse veriut të Mitrovicës do t'i dhurohej autoriteti i vet komunal, zyrtarët e zgjedhur do të detyroheshin që të përballonin kthimet e shqiptarëve: "serbët ende do të ishin shumicë, por do të kishte më shumë shqiptarë sesa ka sot". Intervistë e Grupit të Krizave, veri i Mitrovicës, 23 qershor 2005.

[70] Linda Shala, ish menaxhere e ekipit basketbollistik Trepça, në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga Grupi i Krizave, në Jug të Mitrovicës, 26 qershor 2005.

[71] PSSP Jessen-Petersen ka thënë që ata kishin refuzuar të takoheshin me të. Megjithatë, KNS-ja takohet me zyrtarët e UNMIK-ut të vendosur në Mitrovicë. KNS-ja ndjek një etiketim me Grupin e Krizave, duke e bërë Nebojsha Qoviqin, njeriun e tyre të tretë komandues të disponueshëm për intervistime.

[72] Informacion i vënë në dispozion Grupit të Krizave nga Instituti për Raportim nga Lufta dhe Paqja (IWPR), korrespondenti i të cilit e kishte intervistuar në fillim të korrikut të vitit 2005.

[73] Intervistë e Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, 15 korrik 2005.

[74] Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar që kishte qëndruar në Mitrovicë për disa vite, 29 nëntor 2004.

pak brengosen për interesin e çiltër dhe afatgjatë të shoqërisë që e përfaqësojnë. Në vend të kësaj ata dalin me pozicione shkurtpamëse për t'i kënaqur përkrahësit, për ta mbajtur veten në fuqi dhe për të vazhduar me kontrollimin e buxhetit, tregut të zi dhe krimit të organizuar".[75]

Derisa Jakshiq është ideologu përgjegjës i KNS-së, mbështetësi i tij kryesor është Millan Ivanoviq, i cili udhëheqë spitalin rajonal -- qendrën më të madhe shëndetësore në veri të Kosovës. Serbët nga pjesët tjera të Kosovës gjithashtu mjekohen në këtë qendër, por kjo gjë iu mohohet shqiptarëve. Kjo qendër spitalore është një nga punëdhënësit kryesor në veriun e Mitrovicës, dhe Ivanoviqi shfrytëzon pozicionin e tij për të rritur kontrollin e tij në qytet. Personeli punësohet me kontrata afatshkurtëra për të siguruar dëgjueshmërinë. Një grup nga bërthama e Rojave të Urës është punësuar si roja të sigurisë aty. Shumë njerëz në veriun e Mitrovicës besojnë se krimi i organizuar është i koordinuar nga kjo qendër. Një nga ta pohon se KNS-ja "përdorë ngacmimet, rrahjet, dhe armët për të dërguar 'mesazhin' tek njerëzit, apo ofron favore dhe shërbime për 't'i mbajtur ata si borxhlinjë'".[76]

KNS-ja, gjatë muajve të fundit, ka organizuar disa peticione. Në njërën nga to kërkohej shkarkimi i PSSP-së Jessen-Petersen. Në një tjetër denoncoheshin politikanët serbë të Kosovës Oliver Ivanoviqi, Rangjell Nojkiqi dhe Slavisha Petkoviqi për "bashkëpunim" me UNMIK-un dhe me shqiptarët. Bëhet e ditur se, personeli i spitalit rajonal ishte i detyruar të nënshkruante, disave edhe pa iu dhënë kohë që të lexojnë dokumentet.[77] Çdo serb i veriut të Mitrovicës i cili shkon më larg se sa lejohet të bashkëpunojë me shqiptarët apo me agjendën e UNMIK-ut rrezikohet që të izolohet nga njerëzit e KNS-së. Një gazetar i cili publikisht kritikoi logjikën e serbëve për të bojkotuar zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë të mbajtura në tetorin e vitit 2004 thuhet se ishte ftuar "në qortim" nga Millan Ivanoviq me qëllim që ta sqaronte veten.

Ndonëse i margjinalizuar në veriun e Mitrovicës, oponenti politik i KNS-së, Oliver Ivanoviq, është i respektuar për shkak të udhëheqjes së Rojave të Urës gjatë muajve të vështirë në fillim të vitit 1999. Ai shikohet si jo i njollosur nga kriminaliteti dhe korrupsioni, gjëra këto të cilat e karakterizojnë KNS-në, më i mençur, më konstruktiv dhe njohës i më shume gjuhëve se sa Millan Ivanoviqi, i cili shikohet si "më i ngathët" dhe jo orator në gjuhën serbe, e aq më pak në atë angleze dhe shqipe sikurse që është Oliveri. Mirëpo, pa zgjedhje, populariteti relativ është më pak i rëndësishëm në krahasim me forcën e KNS-së. Kur më 8 shkurt 2005 një bombë shkatërroi veturën e Oliverit, me sa duket rriti shkallën e simpatisë për të dhe edhe më tej nxiu imazhin e KNS-së.[78] Ende qarkullojnë fjalë se, hudhja e bombave është shikuar nga autorët e krimit si afirmim i vetes.

Autoritetet komunale në jug të Mitrovicës janë një strukturë tipike e LDK-së,[79] shumica e personelit është e preokupuar me rritjen e rrjetit të tyre. Disa zona zgjedhore e akuzojnë atë për mungesë të transparencës, nepotizëm, dhe korrupsion në tendere,[80] mirëpo ajo ishte një nga tri komunat e vetme në Kosovë që pas auditimit të bërë në vitin 2002 ka dalë mirë.[81] Një hulumtim i sponzoruar nga OSBE-ja nxorri në pah komunikimin e dobët me zonat elektorale.[82] Një artist i spikatur vendor e quajti udhëheqjen komunale "tërësisht pasive dhe jokompetente. Ata nuk janë faktor në të cilët llogarisin njerëzit për të përmirësuar situatën ".[83] Kryetari i komunës Faruk Spahija për më shumë se një vit lufton me sëmundjen e kancerit. Gjatë trazirave të marsit 2004 ai ishte në Gjermani, në gjysmë të trajtimit shtatëmujorësh. Gjendja e tij kishte tërhequr simpati por gjithashtu kishte ngritur pyetje se ai ishte i përshtatshëm që në atë gjendje të udhëheqë me komunën më problematike të Kosovës. Të rinjtë, njëzet deri tridhjetë vjeç, tregojnë frustrimin që kanë në relacion me gjeneratat e vjetra të cilat po i mbajnë të monipolizuara pozicionet udhëheqëse.[84]

## 2. Të ndikuarit në opinion

Në shumë mënyra, vija radikale që ndjek KNS-ja në të vërtetë reflekton disponimin e serbëve të veriut të Mitrovicës. Kundërshtimi ndaj nje marrëdhënieje apo kontakti eventual me Prishtinën po thellohet gjithnjë e më shumë. Mirëpo, KNS-ja aktivisht punon në mbajtjen

[75] Intervistë e Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, 12 prill 2005.

[76] Intervistë e Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, 12 prill 2005.

[77] Informacion i vënë në dispozion të Grupit të Krizave, maj 2005.

[78] Oliver Ivanoviqi thotë se e din se kush janë autorët e krimit dhe i kritikon hetimet e policisë si të ngadalshme. Ministri për kthime Sllavisha Petkoviq e akuzon KNS-në për një granatë të hedhur mbi ministrinë e tij dhe zyren e partisë në Zubin Potok më 4 korrik 2005. Megjithatë, granata ishte vendosur në një karrige dhe paisje me vlerë që ishin larguar përkohësisht nga zyra, duke sugjeruar veprim të mundshëm nga brenda.

[79] Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.163, *Kosova pas Haradinajt*, 26 maj 2005, fq. 14-16.

[80] Intervista të Grupit të Krizave, në Jug të Mitrovicës, 3-9 qershor 2005.

[81] Intervistë e Grupit të Krizave me Auditorin gjeneral Inga-Britt Ahlenius, Prishtinë, 12 prill 2005.

[82] Izedin Krasniqi, "Komunikimi i mangët, qytetarët të margjinalizuar", *Koha Ditore*, 20 qershor 2005.

[83] Intervistë e Grupit të Krizave, jug i Mitrovicës, 16 shkurt 2005.

[84] Intervista të Grupit të Krizave, në Jug të Mitrovicës, 3-9 qershor 2005.

e publikut në ethe, duke fuqizuar dhe politizuar idenë se është e pamundshme të jetohet me shqiptarët duke parandaluar kontaktet të cilat mund të çojnë drejt një zgjidhjeje më kreative.

Ndonëse raportimi i radios lokale serbe 'Contact Plus' tenton të jetë i kujdesshëm duke ftuar kështu për një respekt të caktuar, agjenda e gazetave të Beogradit dhe televizioneve që dominojnë në tregun medial të veriut të Mitrovicës është e nxitur nga tregimet dhe historitë që reflektojnë kërcënim nga shqiptarët. Gazetaria lokale është e ndruajtur dhe e pazhvilluar. Një pjesë e vogël e komunitetit i kupton vështirësitë në të cilat ajo operon. Më 2003, kur një gazetar i konsideruar ishte vërejtur se po kalonte linjën, ishte përkujtuar se si të sillej, pasi që ai kishte "familjen në Mitrovicë".[85]

KNS-ja nuk pëlqente "konteinerin e dashurisë" projektin ndëretnik të të rinjve, një tendë me hapësirë për takime, kompjutorë, dhe pajisje të tjera e cila prej fundit të vitit 2002 deri në fillim të vitit 2004 ishte e vendosur menjëherë në jug të urës kryesore. Pohimi i tyre ishte përhapur dhe besuar në veriun e Mitrovicës se si një e re serbe dhe një femër e re boshnjake ishin rrëmbyer nga atje dhe ishin dhunuar nga shqiptarët të cilët pastaj janë larguar në jug të lumit. Një gjyqtar ndërkombëtar e hodhi poshtë rastin e ngritur kundër dy shqiptarëve, dhe femrat thanë se atyre iu pëlqyen meshkujt me të cilët u arratisën. Se ky kontakt do të shkaktonte bashkëveprime të mëtutjeshme ishte evidente, po ashtu, në një iniciativë private për dialog, gjatë së cilit serbët e veriut të Mitrovicës u pajtuan se mungesa e mediave në gjithë qytetin ishte një problem i madh; u befasuan kur mësuan se ndërprerjet e rrymës gjithashtu shkaktojnë vështirësi për shqiptarët; filluan të diskutojnë problemet e përbashkëta të qytetit; dhe mbështetën zhvillimin e dialogut.[86] Duke parë se marrëdhëniet ekzistuese të serbëve dhe shqiptarëve në 'Kodra e Minatorëve' po rleakosheshin tutje ngrohtësisht, dikush e pa të nevojshme imponimin e kontrollin nga jashtë. Në maj 2005, të 160 kryefamiljarët serbë nënshkruan një peticion me të cilin kërkonin që UNMIK-u të ndërpriste riparimin e pesë shtëpive të dëmtuara të shqiptarëve. Peticioni potenconte banorin e kthyer të riun Hakif Mehmeti ("Kiko"), veteran i UÇK-së, si një kërcënim për siguri,[87] duke protestuar se asnjë marrëveshje nuk ishte arritur me komunitetin serb për renovimin e shtëpive, dhe paralajmëruan se dhuna mund të pasojë, për çka UNMIK-u do të ishte përgjegjës..[88] Derisa disa e shohin se KNS-ja kishte dorë në këtë peticion, një vëzhgues i informuar vë në dyshim një lider të komunitetit shqiptar në 'Kodra e Minatorëve', interesat e të cilit mund të jenë të rrezikuara nga kthimi i pesë kryefamiljarëve.[89]

KNS-ja duket se I kundërvihet çdo lloj ndryshimi të status quo-së në Mitrovicë. Kështu, në fundin e prillit 2005 ajo nxiti të zhvendosurit romë që në zonat e ndotura nga plumbi në Zveçan të demonstrojnë kundër planit rindërtimit të lagjes rome në jug të Mitrovicës të cilën shqiptarët e kishin shkatërruar pas luftës.[90] Vëzhguesit ndërkombëtarë besojnë se KNS-ja madje ka shkruar fjalimet dhe ka përgatitur posterët, me parullat si: "Ne jemi me vëllezërit tanë serbë".

Marrëveshja e autoriteteve komunale të Mitrovicës të udhëhequra nga shqiptarët për një plan për rindërtimin e lagjes së romëve dhe kthimin e tyre është një çasje e re mirëpritjeje, në koherencë me përceptimin e ri të agjendës së bashkësisë ndërkombëtare për standardet. Më parë komuna kishte exprimuar tërë tokën ku kishin jetuar romët për nevojat e zhvillimit të saj, duke argumentuar se romët nuk kishin të drejta ligjore.[91] Kundërshtimi I KNS-së duket të jetë shkaktar në kundërshtimin e lëvizjes së re veri-jug. Në të vërtetë, çdo iniciativë e UNMIK-ut dhe IPVQ-ve që avancon multietnicitetin në jug mund të jetë pengesë për KNS-në. Ngjashëm, të zhvendosurit serbë të strehuar për më shumë se një vit në kushte të tmerrshme në Zveçan kanë refuzuar që të kthehen në shtëpitë e

[85] Kjo iu konfirmua Grupit të Krizave nga disa burime.
[86] Intervistë e Grupit të Krizave me një aktivist të Qendrës Kosovo Nansen Dialogue, korrik 2005.
[87] Hakif Mehmeti, aktivist i njohur dhe kontravers, drejton një OJQ lokale, "Shtëpia e paqes". Ai ishte i involvuar në trazirat e marsit të vitit 2004 në Mitrovicë, siç thuhet në rol udhëheqës dhe u plagos në këmbë, u ngarkua me disa kundërvajtje, por u shfajësua nga një gjykatë e UNMIK-ut në korrik të vitit 2004.
[88] Musa Mustafa, "Serbët e Kodrës së Minatorëve kundër rindërtimit të 5 shtëpive të shqiptarëve", *Koha Ditore*, 31 maj 2005; Intervistë e Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, maj 2005.
[89] Intervistë e Grupit të Krizave, Mitrovicë, 14 korrik 2005. Thëniet se orvatjet për rrëmbime nga ky lider komuniteti dhe një i afërm i tij kundër banorëve tjerë shqiptarë kanë dalur mbi sipërfaqe edhe më parë. Intervista të Grupit të Krizave, fund i vitit 2003.
[90] Zyrtarët ndërkombëtar e shohin KNS-në si forcë shtytëse prapa protestave të romëve. Intervista të Grupit të Krizave, 5 dhe 11 maj 2005. Presioni nga të afërm të romëve jashtë vendit mund ketë luajtur një rol, pasi që rehabilitimi i mahallës rome mund të ishte shfrytëzuar nga vendet nikoqire si dëshmi të ambientit të përmirësuar që do të justifikonte kështu urdhërin për deportimin e tyre; një konferencë e mbajtur në Parlamentin Evropian iu kushtua kësaj çështjeje më 27 qershor 2005.
[91] Komuna kishte nxjerrë marrëveshjen e tashme me UNMIK-un, OSBE-në, UNHCR-në, dhe DPB-në, që bashkërisht vepruan si "partnerë për mahallën e romëve". Përfaqësuesit e romëve kishin kërkuar nga ata që të negocionin me komunën në emër të tyre. Plani nënvizon se kushdo që mund të dokumentojë pronësinë e tokës mund ta merr prapa pronën. Banesa do të ndërtoheshin për banorët e tjerë të mëparshëm, dhe komuna poashtu do të ndërtonte një qendër sportive. Megjithatë, projekti duket se u ballafaqua me vështirësi financiare dhe nuk po shkon përpara.

ndërtuara në fshatin serb Frashër që gjendet në jug të Mitrovicës, për shkak, siç dyshon personeli ndërkombëtar, presionit të KNS-së.[92] Në marrëveshje me përkrahjen e re të agjendës për standardet, autoritetet komunale të Mitrovicës planifikojnë një shërbim autobusi i cili katër herë në ditë do të qarkullonte përmes Mitrovicës nga Zveçani dhe fshati Frashër.

Ashtu siç KNS-ja kundërshton kthimet nga jugu dhe dekurajon lëvizjet në drejtimin e kundërt, autoritetet komunale luajnë një rol në mbrojtjen e tabusë së shqiptarëve kundër shitjes së pronave në veri. Një ish zyrtar i UNMIK-ut përshkruan një "fushatë shqetësuese" të vazhdueshme nga mediat dhe liderët politikë kundër atyre që kanë shitur pronat e tyre atje.[93] Banorët e mbetur janë përpjekur të "identifikojnë dhe turpërojnë" ata që janë përpjekur t'i shesin pronat. Autoritetet komunale janë takuar me banorët e komunitetit shqiptar në veri të Mitrovicës, duke i stimuluar ata që të mos i shesin pronat para se qyteti të jetë bashkuar. Në korrik 2005, Kryetari Komunës Spahija i tha një gazete se shitjet në këtë kohë mund të dëmtojnë procesin e ribashkimit.[94] Në gusht, zëvendësi i tij adresoi një letër tek Kryeministri dhe UNMIK-u, duke ju bërë thirrje të ndalojnë valën e re të shitjes së pronave në "tre rrokaqiejtë" dhe në 'Lagja e boshnjakëve'. Shumëkush mendon se komuna nuk bëri sa duhet për përkujdesjen për të zhvendosurit nga veriu, të cilët i mban peng të një pozicioni politik maksimal.

Derisa Spahija, gjithashtu, i kishte këshilluar pronarët e pronave në veri se ata rrezikojnë të mashtrohen nëse në këto kushte shesin pronat,[95] gjë e cila nuk ishte vërtetuar. Kjo ishte pikërisht tabuja shqiptare për shitje të tilla që i detyron ata të jenë të manovruar nga ndërmjetës të paqartë. Burime policore tregojnë se rrjetet ndëretnike kriminale dhe ekstremiste e shohin tregun e nëntokës në këto prona si një përfitim nga status quoja ekzistuese.[96] Natyrisht, autoritetet komunale nuk tentojnë t'jua kthejnë mendjen shqiptarëve nga blerja e pronave serbe në jug të Mitrovicës. Letra e hapur e drejtuar së fundi kundërshtoi se blerja e pronave shqiptare nga serbët paraqet përpjekjen e përbashkët për të spastruar etnikisht veriun e Mitrovicës por shqiptarët kishin përdorur taktikë të njëjtë gjetiu në Kosovë -- aktualisht dhe shumë qartë në Çagllavicë, në jug të Prishtinës.

[92] Intervistë e Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, 13 prill 2005.
[93] Komunikim privat me Grupin e Krizave, gusht 2005.
[94] Bekë Abazi "Shitja e pasurive në veri do të ketë pasoja të rënda për procesin e integrimit të qytetit, thotë Spahija", *Zëri,* 14 korrik 2005.
[95] Ibid.
[96] Intervistë e Grupit të Krizave, korrik 2005.

## D. MITROVICA SI OFRUESE SHËRBIMESH

Po të mos ishte për gjashtë vjet gjendja shpërthyese në qytet, Mitrovica do të mund të ofronte shërbime rajonale, dhe kudo në Kosovë, veçanërisht për komunitetet serbe.

Është e paqartë se cilën zonë apo zona të vendit do t'i posedojnë bashkarisht apo ndaras gjysmat e qytetit atëherë kur të përcaktohet statusi i Kosovës, siç janë të paqarta edhe përgjigjet në pyetjet se a do të zhvillohen spitali rajonal dhe universiteti si institucione vetëm për serbët e veriut të Kosovës, për komunitetin e gjerë të serbëve të Kosovës, apo -- gjithësesi si më e dëshirueshmja do të ishte -- si qendra të përsosura që poashtu mirëpresin shqiptarët nga Mitrovica dhe ndoshta nga e tërë Kosova. Sa më e madhe që të jetë ajo zonë, perspektivat e Mitrovicës për rigjenerim do të jenë më të mira.

Qëndrimi i vet banorëve të qytetit do të jetë vendimtar. Derisa autoritetet komunale në jug të Mitrovicës vënë theksin në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, studimet e bëra kanë treguar se banorët e veriut të Mitrovicës "nuk dëshirojnë të punojnë në sektoret prodhuese". Prandaj, zyrtarët vendor u orientuan në shërbimet publike si shtyllë për zhvillim.[97] Pyetje tjetër është përkushtimi për Mitrovicën i specialistëve të sektorit publik në veri. Shumë prej tyre gjatë javës qëndrojnë vetëm për shkak të pagave të mëdha që aktualisht janë në dispozicion, derisa kohën e lirë e kalojnë në Beograd. Specialistët e tillë me sa duket do të mund të mbesin aty nëse do të krijohet ndonjë rol më i madh dhe rëndësia për Mitrovicën do të shtohet.

Gatishmëria e Prishtinës për transferimin e pjesëve të qeverisë apo të shërbimeve civile do të ndikojë pozitivisht në të ardhmen e qytetit. Drejtori i TV Mitrovica, Nexhmedin Spahiu argumenton se lëvizja e kryqendrës në Mitrovicë do t'ju ofronte serbëve perspektivë të shtuar duke qenë në zemër të jetës politike, administrative dhe sociale në Kosovë.[98] Një Mitrovicë multietnike do të mund të bëhej qendër më mirë se sa të mbetet e margjinalizuar. Joçuditërisht, kjo ide nuk ka zënë vend në Prishtinë. Ndërprerja e hapit për transferimin eAgjensionin Kosovar të Mirëbesimit vendosi një precedent të dobët. Ende, nëse ndarja e Ibrit do të jetë më e zbutur në Kosovën e post-statusit, Mitrovica është një kandidat evident për pranimin e elementeve të qeverisë për të mbështetur popullatën serbe. Një nga ato mund të jetë një sektor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, për të grumbulluar dhe shpërndarë fondet nga Kosova, Serbia

[97] Intervista, Mustafë Pllana, shef ekzekutiv i komunës së Mitrovicës, dhe Sllagjana Radoviq, shefe e sektorit për zhvilim ekonomik në administratën e UNMIK-ut në veri të Mitrovicës, citoi në *Kosova nën vështrim*, nr. 241, 25 shkurt 2004.
[98] Intervista të Grupit të Krizave, qershor 2005.

dhe donatorët tjerë tek institucionet serbe të "autonomisë kulturore dhe personale", në shëndetësi, arsim dhe në sfera të tjera.[99]

Institucionet e Mitrovicës siç janë spitali rajonal dhe universiteti në veri do të mund të ndihmonin në ofrimin e udhëzimeve për një zgjidhje të statusit përfundimtar duke filluar me supozimin për një mundësi rajonale apo mbarëkosovare. Mirëpo, ato instiutcione janë zënë rob nga udhëheqjet e përkrahura nga Beogradi të dedikuara për të bllokuar procesin dhe për të thelluar ndarjen. Mjekët shqiptarë dhe pacientët ishin larguar me forcë nga spitali në shtatorin e vitit 1999, falë "trimërisë së disa doktorëve më të rëndësishëm, në veçanti Dr. Marko Jakshiqit",[100] i cili orkestroi incidentet e dhunshme dhe një bllokadë. Kjo ishte një muaj pas asaj kur - PSSP Bernard Kouchner e quajti spitalin si simbol të shpresës, ku mjekët shqiptarë dhe serbë vazhdonin t'i trajtonin të gjithë pacientët. Administratori rajonal i UNMIK-ut, më 29 shtator 1999, iu premtoi infermiereve shqiptare se UNMIK-u do të punojë që spitalin ta bëjë "multietnik përsëri në të ardhmen".[101] Por, në gjashtë vjetorin e intervenimit, KNS-ja ka konsoliduar kontrollin e saj.[102] Bashkësia ndëkombëtare ka dështuar në tërheqjen e vëmendjes dhe në përdorimin e presionit.

Universiteti, i cili u hap në veri të Mitrovicës vetëm gjatë periudhës së UNMIK-ut, për një kohë të shkurtër premtoi se do të bëhej institucion urëlidhës. Mirëpo, në maj të vitit 2004 Qeveria e Serbisë ka mbërthyer prapa këtë ide, dhe menaxhmenti i ri i tij, qysh prej atëherë, ka provuar ta modelojë një forcë për ndarje. Që kur Ministria e Arsimit të Serbisë emëroi Radivoje Papoviqin në krye të univeristetit, ai shkëputi lidhjet e tij me Prishtinën dhe me UNMIK-un, dhe u orvat ta rimodelojë atë në stilin e tij radikal nacionalist serb. Emërimi i tij ishte një miratim ndaj personelit dhe politikave të Milloshevigit në Kosovë dhe një shuplakë në fytyrë për shqiptarët. Si rektor i Universitetit të Prishtinës në vitet e 1990-ta, ai kishte mbikëqyrë dëbimin masiv të shqiptarëve nga ky institucion.[103] Qasja e tij plotëson atë të KNS-së. Mirëpo, synimet e Jakshiqit se ai do të mund të përvetësonte universitetin nën patronazhin e KNS-së ishin refuzuar; Papoviqi është një person pa parti, një nga disa emërime të Koshtunicës që nuk ka shkuar përmes Jakshiqit. Në fillim Papoviqi dhe Jakshiqi bashkarisht zgjodhën dekanët e rinj të fakulteteve -- përgjithësisht radikalistë, disa i rizgjodhën nga koha e mëparshme në Prishtinë. Derisa rivaliteti midis tyre nxehej, shumica mbante anën Papoviqit.

Edhe Unioni i universiteteve të Serbisë, i mbështetur nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane, kundërshtoi emërimin e Papoviqit.[104] Më 5 maj 2004, Koshtunica justifikoi emërimin si një "masë e përkohshme",[105] por nuk ka mënyrë të lehtë për ta shfuqizuar atë, bazuar në ligjin e Serbisë për arsim të lartë, dhe me sa duket nuk ka as vullnet. Oliver Ivanoviqi nënvizon se Papoviqi "ka qenë i kujdesshëm në zbatimin e të gjitha hollësirave ligjore".[106] Edhe nëse ai do të ishte larguar, Aleancat e tij ende do të dominojnë në fakultetet e këtij universiteti.

Infrastruktura e universitetit, ndonëse e pa kompletuar, tani duket se është vendosur në veri të Mitrovicës.[107] Ndërtimi i objekteve të reja për fakultetet e filozofisë dhe filologjisë si dhe konviktet e studentëve duket se shënuan fundin e jetës nomade e cila kishte filluar kur shqiptarët okupuan Universitetin e Prishtinës në vitin 1999, kur shumica e fakulteteve gjetën akomodim në qytetet kudo në jug të Serbisë. Vetëm fakulteti teknik ishte në veriun e Mitrovicës deri atëherë kur qeveria e Serbisë ribashkoi të gjitha fakultetet atje në vitin 2002.[108]

Që nga viti 2002 e deri kur Papoviqi mori detyrën, ekzistonte një shkallë bashkëpunimi, përfshirë zotimet e bëra nga komiteti drejtues i Kthimit/Povratakut -- që njëkohësisht ishin pjesëtarë të Kuvendit të Kosovës, të cilët i mundësuan UNMIK-ut që t'jua plotësojë dëshirat dhe kërkesat e serbëve lidhur me ligjin për arsimin e lartë të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe Ministria e Arsimit për të licensuar universitetin, që si rezultat u braktis emri i vjetër i Prishtinës në favor të "Universitetit të Mitrovicës". Ndonëse Ministria e Arsimit nuk ofroi mbështetje buxhetore, disa fonde u dhanë nga donatorët, bazuar në marrëveshjen që universiteti të reduktohej në njëzet fakultete, të specializohet më shumë në nevojat e rajonit të Mitrovicës, dhe eventualisht të pranojë studentë shqiptarë.

---

[99] Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kosova: Drejt Statusit Përfundimtar*, fq. 12.
[100] Komunikatë për media e UNMIK-ut, "Spitali i Mitrovicës i Bllokuar", UNMIK/PR/57, 30 shtator 1999.
[101] Ibid.
[102] Me sa është thënë shqiptarët ishin në gjendje ta shfrytëzonin spitalin në baza individuale dhe diskrete, por jo edhe pas trazirave të marsit 2004.
[103] Njeriun të cilin e zëvendësoi, Gojko Saviq, është anëtar i grupacionit politik të Oliver Ivanoviqit, Listës serbe për Kosovë dhe Metohi, ish koalicioni Kthimi.
[104] "Deklaratë e Parlamentit të BE-së lidhur me shkarkimin e rektorit të Universitetit të Mitrovicës nga Ministri serb i arsimit", Bruksel, 2 qershor 2004.
[105] Takimi me PSSP Holkeri, e referuar nga u.d. PSSP Brayshaw në një letër të Kryeministrit Koshtunica, 15 qershor 2004.
[106] Intervistë e Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, 23 qershor 2005.
[107] Për shembull, i mungon një bibliotekë.
[108] Disa ishin vendosur në pjesë tjera të veriut të Kosovës: fakulteti i bujqësisë në Leposaviq, drejtimi eletro-teknik në Zubin Potok, dhe fakulteti i arteve në Zveçan (pjesë të të cilit më vonë u transferuan në Graçanicë por ka mundësi që janë kthyer në Zveçan).

Kjo i hapi rrugë universitetit për njohje evropiane në kuadër të sistemit të Bolonjës[109] dhe pjesëmarrje në shkëmbimin e studentëve, e gjithashtu në projektet ndërshoqërore. Në fakt, gjatë kësaj periudhe pengesa kryesore në progres ishte heshtja e shqiptarëve. Qeveria e Kosovës dhe liderët e Kuvendit nuk bënë përpjekje për të përmirësuar perceptimin dhe bindjen e përhapur midis shqiptarëve se universiteti ende ishte një strukturë paralele ilegale, edhe pse ata kishin pranuar amandamentet e bëra nga UNMIK-u në ligjin për arsimim të lartë.[110] Tashmë krejtësisht shqiptar Universiteti i Prishtinës nuk shfaqi interesim për asfarë ortakërie, edhe pse dy nga fakultetet e tij -- Shkolla e Lartë Teknike dhe Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë -- janë në jug të Mitrovicës. Ai refuzoi dy kandidatë serbë nga veriu i Mitrovicës për të ndjekur "universitetin veror", më 2003. Disa studentë të Mitrovicës u ankuan se edhe para Papoviqit, studentët shqiptarë nga Prishtina treguan pak interesim për bashkëveprim.[111]

Financimi nga donatorët ishte ndërprerë,[112] dhe Papoviqi përpiqej ta ruaj emrin "Universiteti i Prishtinës". Ky rikthim tek mënyra e operimit me qendër në Serbi kishte ndikim në ritmin e mësimdhënies, i cili tash është i organizuar vetëm një herë në muaj, kur ligjëruesit nga universitetet e Beogradit, Nishit dhe Novi Sadit janë të kontraktuar të ligjërojnë deri në gjashtë orë brenda një apo dy ditëve. Një profesor u ankua për këtë "organizim qesharak të universitetit", produkt i një "politike të qeverisë së Serbisë që me çfarëdo çmimi të mbaj një universitet në Mitrovicë". Ai tha se puna akademike nuk është serioze, dhe është e motivuar vetëm nga pagesat e larta.[113]

Fatmirësisht, gjatë të gjitha pjesëmarrjeve në trazira dhe në historitë e kaluara të Papoviqit në inkurajimin e aksioneve të turmave,[114] ai nuk tërhoqi me vete strukturën studentore. Shumica janë të pakënaqur me bagazhin politik që ka sjellur lidershipi i tij -- përjashtim këtu bën klika e studentëve nga Mali i Zi të cilët "e adhurojnë Papoviqin dhe sillen me arrogancë në mjediset e kompleskit universitar". Shumë studentë janë nga Serbia, dhe shumica prej tyre janë të brengosur se qasja e tij izoluese mund të dëmtojë dhe mos mundësoj pranim ndërkombëtar të diplomave të tyre si dhe ka zvogëluar mundësitë e shkëmbimit dhe tërheqjes së stafit akademik ndërkombëtar. Gjithashtu, disa janë irrituar se prania e tij ka përjashtuar mundësitë për më shumë projekte dhe bashkëpunim me shqiptarët.[115]

UNMIK-u reagoi dobët në emërimin e Papoviqit duke u kufizuar në një shqetësim të shkurtër verbal dhe në një protestë të shkruar drejtuar Koshtunicës se vendimi ka prekur autoritetin e tij që ka me Rezulutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së si dhe është shkelur Ligji i Kosovës për arsim të lartë. Pas sugjerimit që i bëri Koshtunicës se, "Emërimi i z. Papoviq dhe shkarkimi pasues ilegal …, ka vënë në rrezik licensimin e Universitetit të Mitrovicës." [116] UNMIK-u dështoi në aksionin e tij. Kjo edhe më shumë dëmtoi dhe reduktoi autoritetin e tij. Udhëheqësi i një misioni diplomatik në Prishtinë privatisht ka dënuar reagimin e dobët ndaj "provokimit të hapur që i është bërë bashkësisë ndërkombëtare" dhe sugjeroi se atje do të duhej dërguar KFOR-i për ta nxjerrë Papoviqin jashtë.[117]

[109] Një proces reformues i inicuar në vitin 1999 që kishte për qëllim të krijonte një zonë të përbashkët për arsim të lartë deri në vitin 2010. Serbia dhe Mali i Zi filluan të merrnin pjesë në vitin 2003. Këshilli i Evropës, "Bolonja për këmbësorët", në http://www.coe.int/T/DG4/HigherEducation/EHEA2010/BolognaPedestrians_en.asp.

[110] Në fillim të shtatorit të vitit 2005, zëdhënësi i qeverisë së Kosovës me sa duket kishte shprehur preferencën që universiteti të "zhdukej": "Universiteti serb nuk është i yni dhe ne nuk mirremi me çështjet e tij". Shih Musli Krasniqin, Hamdi Miftarin, dhe Rabie Balajn, "Qeverisë nuk i intereson as Universiteti serb i paligjshëm, as territori ynë 'ku ka banda'", *Epoka e Re*, 2 shtator 2005.

[111] Informacion i vënë në dispozicion të Grupit të Krizave, maj 2005.

[112] Austria, që ka traditë të gjatë të mbështetjes së arsimit në Kosovë, ka ndarë fonde për universitetin por ato kanë pak gjasa të mbeten në dispozicion pas fundit të vitit 2005 përveç nëse situata e tij ndërron. Intervistë e Grupit të Krizave me diplomatë austriak, Prishtinë, 2 shtator 2005.

[113] Intervistë e Grupit të Krizave me një student, maj 2005.

[114] Fjalimi i tij inagurues i referohej Kosovës dhe Metohisë si "djepi i shenjtë i Serbisë"; më 1998 ai mobilizoi studentët që të parandalojnë fizikisht dorëzimin tek shqiptarët të disa ndërtesave të Universitetit të Prishtinës nën marrëveshjen për arsim Milloshevìq-Rugova dhe më vonë shkarkimin e tij nga Milloshevìqi.

[115] Informacion i vënë në dispozicion të Grupit të Krizave, maj 2005.

[116] Letër e ushtruesit të detyrës të PSSP-së Brayshaw dërguar Kryeministrit Koshtunica, 15 qershor 2004.

[117] Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 14 janar 2005.

# V. ÇELËSI I SIGURISË

Vështrimi dhe interpretimi i komponenteve që ndajnë Mitrovicën, siç është përshkruar më lart, mund të ofrojë elemente për një pako zgjidhjeje e cila mund ta bëjë qytetin përsëri të bashkuar dhe të ndihmojë një ujdi të veriut të Kosovës me pjesën e saj poshtë Ibrit të dominuar nga shqiptarët. Aktivitetet e reja të përfaqësuesve rajonal të UNMIK-ut në inicimin e dialogut midis dy anëve të lumit lidhur me çështje siç janë menaxhimi i ujit janë shumë të dobishme. Mirëpo, si një varg dështimesh të adminitratorëve civilë të UNMIK-ut në Mitrovicë të cilët nuk dëshmuan se ishin në krye të detyrës, progresi kryesor do të mbetet pa arritur para se qështja e sigurisë ta sfidojë progersin. KFOR-i dhe UNMIK-u nuk punuan mirë së bashku apo me vendosmëri të mjaftueshme dhe qëllim të qartë, derisa Beogradi kishte shfrytëzuar këtë të metë për të ruajtur kontrollin e fortë.

## A. VERIU JO I QETË

Pasi që në korrikun e vitit 1999 mori kontrollin në Kosovë, NATO ofroi një mbulesë sigurie e cila teoritikisht i jepte fund luftës në territorin e Kosovës. Mirëpo, lufta ende nuk ka përfunduar te lumi Ibër, i cili për gjashtë vjet ka shërbyer si një vijë e ashpër ndarëse e kufijve të brendshëm midis fitores dhe humbjes. Mbajtja e veriut të mbrojtur kundër plotësimit të fitores së kryengritjes së armatosur të UÇK-së është burim i vazhdueshëm i ankesave të shqiptarëve.

Për dallim nga pjesët tjera të Kosovës, ku me qëllime jo të mira shqiptarët organizuan trazirat e marsit 2004 për të mbrojtur dominimin lokal, shqiptarët e Mitrovicës -- të cilët inicuan trazirat -- ishin humbës. Ata pësuan qindra të plagosur dhe humbje në terren, derisa serbët fituan në pikëpamje militante dhe në numër, ku shumë të zhvendosur shkuan atje nga jugu. Derisa bashkësia ndëkombëtare më pas i kushtoi më shumë vëmendje urgjente aspiratave të shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, kjo bëri që të vije në shprehje parimi i decentralizimit territorial për minoritetet etnike si ndëshkim për trazirat e shkaktuara. Siç i tha një ish zëvendës administrator i Mitrovicës Kryetarit të Komunës Spahija, "shqiptarët e Mitrovicës do të paguajnë çmimin për atë çfarë është duke iu ndodhur serbëve në pjesë të tjera të Kosovës".[118] Kjo ka bërë edhe më të pamundshme një ribashkim të thjeshtë të Kosovës dhe fuqizoi edhe më shumë vijën e demarkacionit në Ibër.

[118] Korrespondencë elektronike e Grupit të Krizave me Edward Joseph, 18 maj 2002.

### 1. Mjedisi strategjik

Nga mungesa e përgatitjeve të tyre, komuniteti diplomatik si dhe shqiptarët e Kosovës, duket se e kanë kuptuar që prishja e sigurisë është kërcënuese për Mitrovicën dhe veriun.[119] E përjavshmja *Zëri* ka cituar vlerësimin e burimeve diplomatike perëndimore se "shkalla e lartë e rrezikut" e mundshme gjatë përcaktimit të statusit final do të jetë veçanërisht akute në veri të Mitrovicës dhe veri të Kosovës. Një diplomat parasheh "bllokimin e rrugëve që lidhin Kosovën qendrore me Veriun, protesta masive dhe... formimin e një organi politik të serbëve, i cili do të krijonte një lloj të një "republike Serbe" në veri të Kosovës për ta kundërshtuar pavarësinë e Kosovës". Një analist shqiptar për siguri dha një vlerësim të ngjashëm.[120]

KFOR-i është prezent me disa trupa në veri të Ibrit, faktor ky jo i pavërejtur në vend dhe Beograd. Magjistralja Leposaviq-Zveçan shumë shpesh ka qenë e zbrazur nga trupat e KFOR-it, ndonëse kohëve të fundit është vërejtur një rritje e lehtë e lëvizjeve -aktiviteteve, siç janë patrullat Greke statike mbi Zveçan. Disa serbë shpresojnë se në momente ekstreme ushtria e Beogradit mund të niset nëpër rrugën magjistrale në Leposaviq dhe brenda disa orëve t'i marrë pozicionet në veri të bregut të Ibrit. Aftësitë e ushtrisë serbe janë në rënie dhe Beogradi mund të mos marrë atë rrezik për veriun e Kosovës. Sidoqoftë, në raste ekstreme si në rast të përsëritjes së trazirave të marsit apo më keq, nuk është mundësi që përjashtohet si dhe sinjalet e përziera nga Perëndimi do ta bënin këtë edhe më të mundshme.

Një burim i UNMIK-ut i afërt me mendimet e KNS-së, vëren se serbët e Mitrovicës "e dinë se janë në fundin e largët të litarit të gjatë dhe nuk mund të mbështeten në askënd. Prapa mburrjes së tyre qëndron fakti se ata e dinë që ndarja nuk do të shkojë përgjatë Ibrit. Në parim ata janë të rrethuar".[121] Me afrimin e statusit final, kjo mund t'i influencojë ata që të negociojnë një akomodim përbrenda Kosovës.

Brenga që serbëtkishin kah fundi i vitit 2004 lidhur me magjistralen Zveçan-Leposaviq vuri në plan skenarin e një konflikti të mundshëm. Incidentet paraprake përgjatë magjistrales kanë përfshirë përpjekjen e Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH) që qëndron në hije për të hedhur në ajër urën hekurudhore të Lozhicës në prill të vitit 2003[122] si dhe vrasja e policit indian të UNMIK-ut në

[119] Robert Fox, "1,000 trupa britaneze të gatshme për angazhim në Kosovë", The Independent, 26 qershor2005.
[120] Ramadan Qehaja, "Te gjitha rreziqet e sigurisë në Kosovë në kohën e statusit" Zëri, 30 qershor 2005.
[121] Intervistë e Grupit të Krizave, 26 gusht 2005.
[122] Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.153, *Pan-Shqiptarizmi: Sa i madh kërcënimi për stabilitetin në Ballkan?*, 25 shkurt 2004, fq. 8.

gusht të vitit 2003. Përgjatë pjesës më të madhe të shtrirjes, nga ana lindore magjistralja ka pamje nga malet e Shalës. Të banuara aty këtu nga shqiptarët, pa rrugë të përshtatshme përgjatë tyre, ato krijojnë lehtësime për zgjerimin e shqiptarëve drejt veriut të dominuar nga serbët si dhe në jug të Ibrit e plotësojnë vijën e përafërt demarkuese. Megjithatë, dy fshatra shqiptare në malet e Shalës prodhojnë një shkallë të brengosjes serbe për lëvizje qarkore; dhe çdo përpjekje për të krijuar për ata një lidhje rrugore për Podujevë e tutje në lindje do të krijonte frikë. Menjëherë mbi Zveçan, fshatrat Zhazhë, Boletin dhe Lipë janë në mënyrë delikate të balancuara në mes të vetpërceptimit të tyre si njësi të largëta të prekshme si dhe serbët i shohin ato si ura të rrezikshme shqiptare në veri.[123] Grumbulli më verior i fshatërave-Koshtovë, Bistricë dhe Cerajë- është edhe më e izoluar.

Teritori përreth Zubin Potokut të dominuar nga serbët është më i qetë. Vendbanimet serbe në jug të Ibrit kufizojnë komunat rurale shqiptare, si dhe një fshat shqiptar shtrihet në veri të bregut të Ibrit. Ndonëse serbët ankohen nga zhurma e bagëtive të shqiptarëve, aty ekziston shumë pak frikë. Rruga magjistrale shpie në bregdetin e Adriatikut dhe lirisht shfrytëzohet nga serbët dhe nga shqiptarët. Nga liqeni i Gazivodës, Zubin Potoku kontrollon furnizimin me ujë për regjionin dhe, së paku në teori, mund ta ndërpresë ujin në Mitrovicë si kundërpërgjigje nga çdo lëvizje kërcënuese nga ana e shqiptarëve. Për më tepër gjithmonë ka qenë e përbërë nga shumica serbe kështu që shqiptarët do të hasnin në vështirësi për ta justifikuar një sulm. Poashtu, udhëheqësisë komunale i mungon avantazhi militant të cilin e ka veriu i Mitrovicës apo Zveçani. Me statusin final të Kosovës ende në peshojë, preferohet ndjekja e drejtimit të mesëm duke mos kundërshtuar as KNS-në, as Beogradin e as fqinjët shqiptarë.

Megjithatë, nuk është çdo gjë e qetë. Stacioni policor i Zubin Potokut është sulmuar më 3 janar dhe 8 gusht[124] 2005 ashtu siç u sulmua natën më 24 korrik 2005 Zupça, një fshat serb që ndodhet në rrugën magjistrale, sulm ky i cili do të mund të ishte përpjekje e matur për ta ndryshuar atmosferën, me afrimin e bisedimeve për statusin final. Në orën 1:30 të mëngjesit, sulmues të paidentifikuar kanë shtënë mbi një shtëpi si dhe hedhur një granatë. Fshatarët u kundërpërgjigjën po të njëjtën ditë me bllokimin e rrugës magjistrale për disa orë rresht. Komandanti rajonal policor i UNMIK-ut ofroi mundësinë e formimit të një pike kontrolli gjysmë të përhershme të SHPK-së në afërsi të hyrjes së fshatit ku pika e kontrollit të KFOR-it danez ishte larguar disa muaj më parë. Kryetari i Zubin Potokut Slavisha Ristiq reagoi me logjikën e ndërvarshmërisë së sigurisë: "Në pesë e gjysmë vitet e fundit me arritjen e KFOR-it, qytetarët e fshatit shqiptarë të Çabrës kanë kaluar përgjatë fshatit serb të Zupçës. Deri tani nuk ka pasur probleme, por duke menduar për sigurinë e tyre ata po ashtu duhet të kenë parasysh sigurinë e serbëve që jetojnë në Zupçë".[125] Oliver Ivanoviç e shihte sulmin si një fillim të mundshëm të fushatës ekstremiste shqiptare në prag të bisedimeve për statusin në mënyrë që të trembin serbët dhe të ngrisin tensione në Zubin Potok, "e cila në një mënyrë e ndanë Kosovën në kufi të pjesës së Kosovës ku shqiptarët përbëjnë shumicën".[126] Në fakt, një ngritje e tillë e tensioneve do t'i përshtatej secilës anë të ekstremistëve.

## 2. Frika nga sulmi

Thashethemet për një "goditje të fundit" shqiptare janë shfaqur në veri të Mitrovicës që nga viti 1999 dhe janë forcuar edhe më shumë që nga trazirat e marsit to vitit 2004. Në fund të vitit 2004, televizioni Most i veriut të Mitrovicës raportoi se po përgatitej një sulm i ri shqiptar matanë lumit. Vala e re e brengosjeve shpërtheu në nëntor, e koncentruar në rrugën magjistrale që lidh serbët e Mitrovicës dhe Zveçanit përmes Leposaviqit me Serbinë. Fshatarët serbë në jug të Leposaviqit e morën afër zemrës deklaratën e transmetuar në radion lokale nga ana e kryetarit të komunës së Leposaviqit se magjistralja nuk është plotësisht e sigurt.[127] Zbulimi i vrimave apo kanaleve të reja si dhe të një grupi të njerëzve me uniformë ushtarake në afërsi të magjistrales, ishte bazë e publikimit alarmant të raporteve nga ana e gazetave të Beogradit si ajo *Kurir* ku deklarohej se Trupat e Mbrojtjes së Kosovës infiltroheshin në zonë dhe se militantët shqiptarë po ndërtonin hendeqe për ta ndarë magjistralen dhe për ta izoluar veriun e Mitrovicës dhe Zveçanin.[128] Thashethemet kanë qarkulluar në veri të Mitrovicës se luftëtarë të maskuar dhe të

[123] Të brengosur se mund të dëbohen nga serbët nëse shihen si ndihmues të pjesëmarrësve të trazirave, këta fshatarë kërkuan ndihmën e KFOR-it gjatë trazirave të marsit të vitit 2004. Megjithatë, KFOR-i e kuptoi këtë si taktikë diversante, për t'i tërhequr trupat larg nga vendi i vërtetë i trazirave.

[124] Në të dy rastet nuk kishte viktima. Të shtënat u drejtuan drejt ndërtesës pas orarit të punës, dhe u sulmuan veturat e parkuara të policisë. Stacioni policor ndan të njejtin objekt me autoritetin komunal.

[125] "Fshati serb nën siguri të lartë", B92, 25 korrik 2005.

[126] Intervistë me *Glas Javnosti*, e riprodhuar në UNMIK, "Belgrade Media Highlights", 25 korrik 2005.

[127] Intervistë e Grupit të Krizave me personelin e UNMIK-ut, Leposaviq, 18 nëntor 2004. Serbët vendor filluan të përdorin magjistralen pak dhe pasi binte terri nuk e përdornin fare. Intervistë e Grupit të Krizave me personelin e NANSEN Dialogue, veri i Mitrovicës, 29 nëntor 2004.

[128] Vizita e Grupit të Krizave më 18 nëntor të vitit 2004 shënoi se fshati dhe fshatrat simotra nuk ishin në gjendje apo në mendje që të kërcënonin magjistralen, dhe as raportet për hapje të hendeqeve dhe as ato për prezencë të SHPK-së nuk kishin bazë.

armatosur shqiptarë (AKSH) kanë ndaluar autobusët në magjistrale.[129] Marrë së bashku me raportin nga gazeta e Beogradit se UNMIK-u dhe IPVQ-të po përgatitnin një "goditje financiare" të shpejtë për ta thyer rezistencën serbe në veri[130], shumica e serbëve të veriut të Mitrovicës ishin bindur se përpjekja për t'i dëbuar ata ishte planifikuar për pranverën e vitit 2005.

Në korrik të vitit 2005, politikani veteran shqiptar i Kosovës Adem Demaçi, ndezi frikë të re me një paralajmërim të pakujdesshëm në *Blic* se nëse Beogradi dhe UNMIK-u vazhdojnë të mbajnë peng kërkesat politike të shqiptarëve në interes të minoritetit serb, ata mund të ballafaqohen me "dhunë të një dimensioni të tillë aq sa 17 marsi i vitit 2004 do të harrohej".

Gjenerimi dhe mbajtja e ndjenjës së kërcënimit shqiptar duket të jetë detyrë kryesore e "Qendrës Ndërkombëtare të Shtypit" serb në veri të Mitrovicës. Për shembull, më 22 qershor 2005, ajo shpalli se policia e UNMIK-ut kishte arrestuar në veri të Mitrovicës radikalin shqiptar zotërues të Kalashnikovit të njohur si anëtar i AKSH-së dhe udhëheqës i trazirave të marsit të vitit 2004. Televizioni BK i Serbisë e zgjodhi këtë për transmetim dhe e qortoi UNMIK-un për heshtje të këtij arrestimi. Si zakonisht, një hap prapa, UNMIK-u dhe SHPK-ja të nesërmen e hodhën poshtë këtë si trillim dhe lutën gazetarët që së pari t'i verifikojnë me ata raportet e tilla.[131] Çdo incident në Mitrovicë menjëherë shfrytëzohet nga mediat serbe si dëshmi e agresionit shqiptar, përpara se UNMIK-u të mund të reagojë. Për shembull, së fundi B92 raportoi një sulm të shqiptarëve me granata kundër një serbi në lagjen e boshnjakëve. Më vonë policia vërtetoi se granata ishte hedhur nga ana e dy serbëve me të cilët viktima ishte grindur.[132]

Asnjëri nga komunitetet nuk i beson shumë prezencës së sigurisë ndërkombëtare. Serbët ndjehen se UNMIK-u dhe KFOR-i i kanë thyer apo shkelur garancionet e dhëna me vendosjen e tyre, gjatë trazirave të marsit të vitit 2004, kanë arrestuar pak autorë krimi, dhe tani minimizojnë atë çka ka ndodhur duke folur vetëm për "ngjarjet e marsit". Në vend të përforcimit të sigurisë në fillim të trazirave, ata shohin zvogëlim të vazhdueshëm. SHPK-ja në veri të Mitrovicës humbi popullaritetin jetëshkurtër që e kishte fituar gjatë trazirave. Individualisht dhe kolektivisht serbët tentojnë të mbështeten në burimet e veta të sigurisë. Një individ tha: "unë e sigurova një revole për ta mbrojtur veten dhe familjen time, sepse nuk i besoj askujt. Këtu gjërat ndryshojnë brenda natës dhe sigurisht që nuk do të pres askënd të më mbrojë mua. Mundësitë e tyre për të na mbrojtur ata i treguan vitin e kaluar"[133]. Shqiptarët e jugut të Mitrovicës ndiejnë një afërsi të matur ndaj SHPK-së në pjesën e tyre dhe kanë konsideratë të lartë për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, por e urrejnë KFOR-in francez në Mitrovicë.

129 Një ish komandant i një stacioni policor në veri të Mitrovicës e hodhi poshtë këtë si një fantazi. Intervistë e Grupit të Krizave me Joe Napolitano, 4 mars 2005.
130 *Veqernje Novosti*, 10 nëntor 2004.
131 Bekë Abazi, "Demantohet lajmi i mediave serbe 'se policia e UNMIK-ut ka arrestuar personin që ia ka vënë zjarrin kishës serbe", *Zëri*, 24 qershor 2005.
132 Intervistë e Grupit të Krizave me një burim policor civil të KB-së, veri i Mitrovicës, 10 maj 2005.

## B. SIGURIA E MITROVICËS NË POZICION PAT

Secili nga protagonistët kryesor të qytetit -- serbët, shqiptarët, KFOR-i, UNMIK-u -- janë në dijeni se tejkalimi i kufijve të cilët janë vendosur për të krijuar një jostabilitet stabil do të shkaktonte një reaksion të dhunshëm. Vërtet, të gjithë kanë pranuar që dikush të bëjë kontrollim policor mbi ta. Iniciativa e fundit e UNMIK-ut për të hapur urën kryesore për qarkullim dhe të transferojë kompetencat mbi stacionin policor të veriut të Mitrovicës, pastaj komandën policore rajonale, mund të prish ekuilibrin pa e rritur perspektivën për zgjidhje.

### 1. Frikësimi i UNMIK-ut

Angazhimi i kufizuar i UNMIK-ut në veri të Mitrovicës ka qenë pjesërisht i kushtëzuar nga përkrahja e kufizuar e KFOR-it.[134] Një polic francez i tregoi Grupit të Krizave për "përvojën shumë të keqe me KFOR-in" gjatë shërbimit të tij në Mitrovicë gjatë viteve 2001-2002: "Policia ishte në gjendjen më të rrezikshme duke u ballafaquar me trazirat. KFOR-i refuzoi të na ndihmonte dhe vetëm na shikonin"[135] Një zyrtar i UNMIK-ut në Mitrovicë shpjegoi marrëdhëniet lokale të KFOR-it me organizatën e tij në vitin 2004 si "macja me miun".[136] Dështimi i KFOR-it që të zbusë klimën e ashpër të sigurisë ka krijuar hapësirë për UNMIK-un ta gjejë akomodimin e tyre me strukturat paralele serbe, grupe që punonin për t'i nënvlerësuar ata. Emërimi i Vladimir Rakiqit, zyrtar në departamentin për furnizim me ujë si dhe ish-udhëheqës i Rojave të Urës, i cili është siç thuhet është parë duke udhëhequr përpjekjet për t'i nxjerrë nga shtëpitë dhe rrahur policët e UNMIK-ut gjatë trazirave të marsit të vitit 2001, në bordin këshilldhënës të administratës së veriut të Mitrovicës,

133 Informacion i vënë në dispozicion të Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, maj 2005.
134 Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Grackë për Kosovën*, fq. 9-12; Raportin e Grupit të Krizave, *Kolapsi në Kosovë*, fq. 21-22.
135 Intervistë e Grupit të Krizave, 29 dhjetor 2004.
136 Intervistë e Grupit të Krizave, prill 2004.

është shembull i politikës së UNMIK-ut që kërkon të përshtatet me torturuesin e vet[137]

Policia e UNMIK-ut e dinë se mobilizimi i shpejtë i turmave (si dhe mosndëshkimi pasues për liderët e saj) do të pasojë çdo përpjekje për të kapur KNS-në apo ish liderët e Rojave të Urës dhe në këtë rast nuk mund të llogaritet në KFOR-in, prandaj ata i kufizojnë ambiciet e veta në pajtim me rrethanat.[138] Policët serbë të SHPK-së në stacionin verior e respektojnë KNS-në e shoqërisë së tyre të vogël. Prezenca e qindra policëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB ose MUP) të Serbisë në qytet edhe më tutje e mohon primatin e policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së. Veçanërisht natën, në veriun e Mitrovicës ekziston shumë pak mbrojtje kundër krimit për qytetarët, që nga vjedhja e veturave e deri tek sulmet fizike. Vendorët thonë "terri do të të hajë".

Kohë pas kohe, qendra e UNMIK-ut në Prishtinë urdhëron politikë më të vendosur por pa siguruar mjete për ta sfiduar efektivisht status quo-në e sigurisë ashtu siç ishte rasti me lëvizjen e lirë në urën kryesore. Rrjedhimisht, politika venitet ose me rezultate të ulëta ose në rastin më të mirë me sukses sipërfaqësor. Shpesh herë, që nga qershori i vitit 2005, çdo kush që kalon urën kryesore nga jugu në veri, gjatë kohës së shpallur nga UNMIK-u si të hapur, do të rrethohej nga civilët serb që kërkonin identifikimin. Shqiptarët kthehen prapa. KFOR-i është tërhequr, derisa policia ngurron që të ndërhyjë, e edhe me pak që ta ushtrojë autoritetin e vet. Më 23 Qeshor 2005, hulumtuesit e Grupit të Krizave u kontrolluan derisa policët e SHPK-së po pinin duhan me shpërfillje vetëm disa metra më tutje, ndërsa ushtarët e KFOR-it dhe policët e UNMIK-ut po pinin kafe në kafenenë Dolce Vita. Një ditë më parë, një kameraman shqiptar i KTV-së është ndjekur prapa nga indiferenca e ngjashme.[139] Në korrik, banorët shqiptarë të lagjes së boshnjakëve protestuan tek autoritetet komunale në jug të Mitrovicës ndaj jogatishmërisë së policisë për ta mbajtur premtimin e tyre për liri të lëvizjes.[140] Edhe pasi që u shpall hapja 24 orëshe e urës në mes të korrikut, një grua shqiptare u kthye prapa.[141]

[137] Dëshmi e një dëshmitari okular e vënë në dispozicion të Grupit të Krizave, maj 2002.
[138] Shih Raportin e Grupit të Krizave, Kolapsi në Kosovë, fq. 12-13.
[139] Intervistë e Grupit të Krizave me dëshmitarë okularë.
[140] Bekë Abazi, "Qytetarët i ankohen kryetarit Spahia se po provokohen nga ekstremistët gjatë lëvizjes nëpër urën kryesore të qytetit", *Zëri*, 4 korrik 2005.
[141] Shih artikullin e Astrit Gashi-it, "Serbët pengojnë lëvizjen", *Express*, 23 korrik 2005.

### 2. Gara për vendosje?

Vendimi i UNMIK-ut për t'u konfrontuar me serbët e veriut të Mitrovicës për urën kryesore nuk duket të jetë e lidhur me ndonjë iniciativë politike më të qartë dhe më afatgjateëpër të ndryshuar status quo-në, apo për të rritur përpjekjet e KFOR-it në qytet. Përpjekja është simbolike, ka të bëjë me standardin e parë "Liria e lëvizjes". Ura të tjera shfrytëzohen dhe nuk kontestohen. Megjithatë, në veri të Mitrovicës lëvizja shihet si përpjekje për ta thyer imazhin kryesor të rezistencës serbe -- "një hap i qëllimshëm provokativ, pjesë e strategjisë afatgjate për ti dëbuar serbët".[142] UNMIK-u deklaron se përpjekja është duke "shtyer përpara lirinë e lëvizjes dhe ndërton besimin në mes të komuniteteve",[143] por në një kohë të shkurtë e bëri urën kryesore më pak të shfrytëzueshme si dhe ngriti frikë tek serbët, e posaçërisht duke marrë parasysh dështimin e KFOR-it dhe UNMIK-ut për ta balancuar iniciativën me masa për ta shtuar sigurinë e serbëve. UNMIK-u, gjithnjë e më shumë, shihet si bashkëpunëtor i projektit të shqiptarëve të Kosovës për pavarësi dhe dominim në veri. KNS-ja i dërgoi porosi policisë së UNMIK-ut se po që se insistojnë në hapjen e urës "dhe ne ndihemi të kërcënuar, njerëzit tanë do të shfaqen me revole në rrugë. E pastaj do të jetë zgjedhje e juaj se a do të qëndroni para apo prapa nesh".[144]

Planet e UNMIK-ut për urën kryesore si dhe kontrollin policor në Mitrovicë duken çuditërisht të ndara nga diskutimi për statusin përfundimtar në veriun e Mitrovicës dhe brendësinë e saj si dhe nga konsiderimi i balancit të forcave në qytet. UNMIK-u ka zgjedhur që të bëjë një luftë të frikësimit me KNS-në dhe Beogradin, kur e zvogëloi prezencën e policisë së vet civile në veri të Mitrovicës nga 55 policë në qershor të vitit 2004 në 37 në qershor të vitit 2005, dhe më 17 gusht të vitit 2005 solli në pah planin për braktisjen e kontrollit të SHPK-së atje si dhe ripozicionoi pjesën e mbetur të policëve të KB-së në ekip monitorues prej 10 personash. Deklarata se "ne presim që njerëzit të kuptojnë kotësinë e këtij demonstrimi dhe do ta ndërpresin këtë"[145] mund të tregojë vlerësim të gabuar të asaj se kush posedon fuqi më të madhe për qëndrim dhe përcaktim. KNS-ja insiston se mund ti organizojë Rojat e Urës po qe se është nevoja duke sjell edhe përforcime nga Zubin Potoku dhe Leposaviqi. Në fakt, shkalla e lartë e papunësisë në qytet garanton disponueshmërinë e numrit të madh të vullnetarëve.

[142] Intervistë e Grupit të Krizave me Oliver Ivanoviqin, veri i Mitrovicës, 23 qershor 2005.
[143] Zëdhënësi i UNMIK-ut Neeraj Singh, konferenca javore e UNMIK-ut për media, 22 qershor 2005.
[144] Intervistë e Grupit të Krizave, në Veri të Mitrovicës, 23 qershor 2005.
[145] Zëdhënësi i UNMIK-ut Neeraj Singh, konferenca javore e UNMIK-ut për media, 22 qershor 2005

Në këtë betejë për vendosje, në javën e fundit të qershorit UNMIK-u u tërhoq nga plani për hapjen e menjëhershme dhe 24 orëshe të urës, duke shfrytëzuar ekipet kundër trazirave nëse do ishte nevoja për ta zbatuar dëshirën e vet dhe u kthye në planin origjinal për ta hapur urën në mënyrë graduale deri në arritjen e shkallës prej 24 orëve në mes të korrikut kur edhe shpallën fitoren. Protestat e serbëve u shuan por ura megjiathtë dhe pak vetura kolojnë nëpër të.

Policia e UNMIK-ut beson se ndoshta e ka arritur balancin kur injoroi paralajmërimet e KNS-së dhe arrestoi një Roje të Urës i cili kishte sulmuar një pensionist shqiptar më 9 korrik.[146] Në ditët që pasuan, në të vërtetë, vetëm një numër i vogël i njerëzve protestuan dhe poashtu incidentet e dhunshme pësuan ulje. KNS-ja mund të ketë zgjedhur që ta pranojë këtë në heshtje duke besuar se UNMIK-u do të kënaqej me një fitore të tillë të vogël për një çështje aq të vogël. Megjithatë, më tepër u shqetësua më 24 korrik kur policia e UNMIK-ut u orvat të arrestojë një serb të ri që po pinte në Dolce Vita, i cili gjuajti me shishe të birrës drejt policisë civile të UNMIK-ut duke shkaktuar përleshje me ç'rast u sulmuan policët dhe këta të fundit iu kundërpërgjigjën me të shtëna paralajmëruese dhe me shkopinj gome. Me braktisjen e stacionit policor në veri të Mitrovicës të komandantit Roger Philips, KNS-ja të nesërmen kërkoi shkarkimin e tij.

Me afrimin e marrjes në konsiderim të çështjes së statusit përfundimtar, prioriteti kryesor i KNS-së është që ta ruajë status quo-në e qytetit. Anëtarët udhëheqës të saj krenohen me, siç e quajnë ata, gjakftohtësinë e protestave të urës: "U them njerëzve të mi që ta mbajnë të qetë anën tonë. Lëshoni muzikë por mos hidhni gurë dhe mos bërtitni. Ne nuk mund t'i lejojmë vetes që të gabojmë. Mitrovica është shumë shpërthyese. Këtë herë nuk do të ndodhte si në marsin e vitit 2004. Këtë herë do të jetë me armë".[147]

Por një numër shumë i vogël i shqiptarëve e kanë kaluar urën që prej "hapjes" së saj. Televizioni shqiptar TV Mitrovica madje transmetoi një apel për të pritur që të ulen tensionet para se të provojnë ta kalojnë atë. Shqiptarët duket se janë kënaqur deri në një masë duke parë serbët që po bëjnë hapin e gabuar lidhur me urën dhe duke treguar vetëbesim të ri në pushtetin e tyre të vetëkontrollit dhe përmbajtjes. Kur në fillim të korrikut të vitit 2005 përsëri tre fëmijë shqiptarë u përmbytën në lumin Ibër, prindërit e tyre duke mbajtur zi u deklaruan shumë shpejt se vdekja e fëmijëve ishte aksident; PSSP-ja dhe titullarë të tjerë i vizituan ata dhe ndryshe nga marsi i vitit 2004, Mitrovica mbeti e qetë.

Së paku tani për tani, shoqëria e qytetit nuk është mjaft e thyeshme që ekstremistët të mund të nxisin shpërthim. Megjithatë disa burime shqiptare në Mitrovicë dhe Prishtinë bëjnë me dije se ekzistojnë aktivitete ekstremiste. Një gazetar tregoi se dy personat që qëllimisht e futën veturën e tyre në protestat e urës më 19 qershor duke inicuar përleshje me gurë, ishin vëllezër nga fshati Suhodoll të njohur si " ish pjesëtarë të UÇK-së dhe kriminelë". Ekziston brengosja se diçka mund të përgatitet që të përkojë me javët e fundit të vlerësimit të implementimit të standardeve që po e bën ambasadori norvegjez Kai Eide për Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së, apo gjatë procesit të statusit përfundimtar. Agjensionet e sigurisë po shqyrtojnë lidhjet e mundshme midis grupeve të ekstremistëve dhe kriminelëve serbë dhe shqiptarë në Mitrovicë dhe rreth saj.[148] Në anën e shqiptarëve, vëmendje e veçantë po i kushtohet grupeve radikale islamike -- të cilat gjinden në Mitrovicë dhe në fshatrat e komunës së Vushtrrisë dhe kriminelëve -- dhe afaristëve e kriminelëve të njohur nga Drenica për të cilët besohet të kenë luajtur rol në formimin e AKSH-së poashtu edhe në trazirat e marsit të vitit 2004 në Mitrovicë.

## C. TRANSFERIMI I POLICISË

### 1. Heqja e zonave tamponë

Me rritjen e tensioneve serbe lidhur me urën kryesore, UNMIK-u përshpejtoi transferimin e kontrollit të komandave lokale policore -- kjo gjë ndodhi me stacionin policor në veri të Mitrovicës më 17 gusht në vend se të bëhej në dhjetor ashtu siç ishte planifikuar paraprakisht -- dhe kjo duket më tepër si recetë për të ngritur një konflikt në mes të dy anëve të lumit dhe për të ndarë SHPK-në në vija etnike, se sa për ta stabilizuar qytetin. Transferimi i komandave duket të jetë bërë nga modeli i përgjithshëm për tërë Kosovën duke mos marrë parasysh në mënyrë adekuate klimën e veçantë të sigurisë në Mitrovicë.

Edhe pse stacionet jugore dhe stacioni verior i SHPK-së hyjnë nën komandën rajonale policore të Mitrovicës, ato i ndan lumi Ibër.[149] Shumica e policëve serbë të SHPK-së

[146] Një polic i UNMIK-ut tani pendohet se forca nuk kishte çasje eduhur para disa muajve. Ai i tha Grupit të Krizave menjëherë pas këtij incidenti se një individ që më parë ishte i lidhur me strukturat e sigurimit Serb kishte paralajmëruar, "ke kujdes, ata do të mund të gjuajnë në ty". Kur polici iu përgjigj se ai do ta kthente gjuajtjen, ai i tha, "vetëm po bëja shaka".

[147] Intervistë e Grupit të Krizave me Nebojsha Joviq, në Veri të Mitrovicës, 15 korrik 2005.

[148] Tregime të pankonfirmuara dhe ndoshta të paprovuara qarkullojnë në Mitrovicë se bosët dhe ekstremistët serbë dhe shqiptarë vendor të krimit u takuan në Hotel Palace në jug të Mitrovicës para trazirave të marsit të vitit 2004 dhe në qershor të vitit 2005, me të holla të ofruara për trazira.

[149] Ndarja komunale dhe mbi Ibër paraqesin problem kur një Serb i veriut vdes në mënyrë të dyshimtë, dhe nevojitet

frikohen nga urdhëri që ta kalojnë urën, si për shembull kur ata duhet ta kthejnë veturën në stacionin jugor ku nuk punon as një serb. Mungesa e komunitetit serb në jug të qytetit përjashton çdo shpjegim të arsyeshëm për prezencën e tyre. Disa policë shqiptarë punojnë në stacionin e veriut por ata merren vetëm me enklavat e vogla shqiptare ose janë pjesëtarë të njësiteve të specializuara rajonale, për të cilat ekziston mungesë e hapësirave për zyra në bazën rajonale në jug të lumit.

UNMIK-u e përshkruan si dëshmi të suksesit faktin se SHPK-ja po piqet dhe po integrohet duke iu referuar formimit të skuadrës shumë-etnike rajonale kundër trazirave gjatë vitit të fundit. Edhe pse 30 pjesëtarët e saj shqiptarë dhe 19 pjesëtarët serbë janë të vendosur ndaras në veri dhe jug të Ibrit, ata janë trajnuar së bashku, kanë pëcjellur kryetarin Tadiq gjatë vizitës së tij në shkurt të vitit 2005 edhe përkundër kërkesës së tij që asnjë shqiptar të mos përfshihet, si dhe kanë kontrolluar turmën shqiptare të basketbollit në jug të Mitrovicës. Por mbikëqyrës të informuar e pranojnë se tensionet ekzistojnë dhe se "ata nuk dëshirojnë të punojnë me njëri-tjetrin".[150] Një shpërthim në Mitrovicë mund të shkëpus lidhjen e hollë që e mban SHPK-në së bashku si një shërbim të unifikuar.

Ndërkombëtarët mezi kishin krijuar tampon zonë të mjaftueshëme ndërkombëtare në Ibër në mars të vitit 2004 kur vetëm intervenimi i shpejtë i policisë së UNMIK-ut parandaloi policët serbë dhe shqiptarë nga inkuadrimi në luftime në anë të kundërta. Tani rreziku qëndron në faktin se pjesëtarët shqipëtar dhe ata Serb të SHPK-së do të përpiqen për t'u pranuar nga komunitetet e tyre duke i mbrojtur ato nga komuniteti tjetër. Vendimi që ura kryesore të jetë nën kontrll të dy stacioneve, atij jugor dhe veri, me nderrime secili nga një muaj, e mban peng të ardhmen në një kohë kur tensionet rriten me afrimin e bisedave për statusin përfundimtar të Kosovës. Çfarëdo ndarje midis dy gjysmave etnike të SHPK-së në Mitrovicë mund të jetë kontribut dhe shënjestër për agjendat e ekstremistëve nga të dy palët, si asaj shqiptare ashtu edhe asaj serbe.

### 2. SHPK-ja e dobët në Veri të Mitrovicës dhe hijet e saj të fuqishme

Prania e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP) të Serbisë në veriun e Mitrovicës mund të jetë bërë edhe më e dukshme gjatë vitit të kaluar. Stacioni i MPB-së -- një prani e dukshme prapa kafenesë "Black Lady" në kundërshtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë së KB-së -- vepron e papenguar. I vetmi koncesion i dukshëm ndaj sundimit titullar të UNMIK-ut ishte se policët e tyre nuk mbajnë të veshura uniforma. Shefi i stacionit, Dragan Delibashiq, komandon me rreth 70 policë, duke e tejkaluar në masë të madhe numrin e dhjetë policëve civilë të mbetur të UNMIK-ut dhe duke u barazuar përafërsisht me SHPK-në në veri të Mitrovicës.

Stacioni i MPB-së (MUP) ka kryesisht detyrë vëzhguese dhe administrative. Pas marsit të vitit 2004, përafërsisht 50 ish-anëtarë u përpoqën të ngjallin Rojat e Urës, mirëpo MPB-ja i absorboi ata pjesërisht, duke kryer role të ngjashme por më pak imponuese, me policë të caktuar të cilët vëzhgojnë rrugë të caktuara. Beogradi siç duket dëshiron të ketë informacione më të drejtpërdrejta nga terreni dhe nga burime tjera të kontrolluara ashtu që të mos ketë nevojë të mbështetet në grupet lokale. Kjo poashtu iu dërgon sinjale banorëve se shteti serb është ende i pranishëm dhe është ai që tërheqë litarët. Stacioni luan një rol të veçantë në shoqërinë e veriut të Mitrovicës, duke i mohuar të njëjtën SHPK-së. Qytetarët i drejtohen MPB-së për intervenime autoritare gjatë zgjidhjes së konflikteve. Burimet policore të UNMIK-ut besojnë se 40% të ankesave kriminale, por ka mundësi që këto shifra të jenë më të larta, shkojnë përmes këtij kanali, dhe ka gjasa që të dyshuarit dërgohen në Serbi. Siç duket policët e MPB-së i filtrojnë ankesat dhe vendosin se cilat do t'ia dërgojnë UNMIK-ut dhe SHPK-së.

Me pak mundësi për të manovruar, policët e SHPK-së përpiqen t'i kontribuojnë komunitetit duke u marrë me krime të rëndomta siç janë vjedhjet, plaçkitjet dhe dhuna mes vet serbëve, si dhe vjedhje të veturave dhe përdorim të drogës nga ana e të rinjve. Ata druajnë të ndihmojnë të kthyerit shqiptarë, duke imponuar përdorim të targave të UNMIK-ut, duke arrestuar çdokënd që luftoi për çështjen serbe, duke hetuar sulmet ndaj shqiptarëve, apo raste tjera "të ndjeshme". Mesazhe anonime tekstuale të pranuara përmes telefonave mobil shpesh i paralajmërojnë që të tërhiqen nga raste të veçanta, dhe "policët veprojnë në përputhje të përkryer me atë se çka është kërkuar nga ata gjatë kërcënimeve".[151] Më 2 dhjetor të vitit 2004, me rastin e ceremonisë së dorëzimit të stacionit në Zveçan, prania e një grupi të shikuesve trupmëdhenj i dërgoi mesazh të qartë SHPK-së se ata vëzhgoheshin për së afërmi[152]

Shumica e policëve të KB-së dhe komandantëve të SHPK-së në stacionin verior të Mitrovicës e konsiderojnë transferimin e 17 gushtit të parakohshëm, sepse SHPK-së

autopsia. Nuk ka patolog serb në morgun e UNMIK-ut në Rahovec në jug të Kosovës, dhe transporti bëhet nga një kompani shqiptare, prandaj çdo rast provokon protesta të hidhura nga familjarët e të vdekurit.

[150] Intervistë e Grupit të Krizave me një polic civil të UNMIK-ut, qershor 2005.

[151] Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të SHPK-së, veri i Mitrovicës, 22 shkurt 2005.

[152] Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, Zveçan, 15 dhjetor 2004.

i mungon vetëbesimi, përvoja dhe numri i mjaftueshëm. Një vëzhgues i afërt komentoi: "kjo i ngjanë situatës kur shoferit të ri i jepet të ngasë një kamion shtatë tonësh" dhe tha që këshillimi shtesë disamujor nga ana e policëve nga Evropa Perëndimore dhe Brazili mund ta bënte tranzicionin më të mundshëm. Personeli i posatrajnuar e kishte ngritur numrin e policëve të SHPK-së nga 55 në 70, por policët e KB-së vlerësuan se 85 policë të aftë dhe me përvojë janë të nevojshëm. Janë vendosur disa patrolla, pasi që shumica e personelit është e zënë me detyra rreth urës dhe ruajtja e vet stacionit. Nga 70, vetëm 16 ish-policë të MPB-së u vlerësuan si të përshtatshëm. Shumica e tyre, e veçanërisht të posarekrutuarit janë përshkruar si "vetëm trupa".[153] Tranzicioni i përshpejtuar në të vërtetë vetëm se ka shkatërruar kapacitetet, pasi që policët ndërkombëtar dhe ndihmësit vendor gjuhësor ishin larguar.

SHPK-së në stacionin verior i mungon gjithashtu edhe guximi. Udhëzimet shpesh kryhen në mënyrë selektive, dhe patrollat rrugore shpesh shfaqin mungesë angazhimi. Ata ngurrojnë të bëjnë arrestime, duke preferuar të mbajnë situatën siç është, derisa policët ndërkombëtarë të arrijnë mirren me të dyshuarit.[154] Disa nga policët me sa duket mirëpresin pezullimet gjatë të cilave ata vazhdojnë të marrin pagë. Shumë iu bashkuan SHPK-së vetëm për pagë. Të tjerët janë të interesuar për përparim profesional por pajisjet joadekuate[155] dhe ndjenja e të paturit të marrëdhënieve jo të mira përbrenda policisë së Kosovës shkakton demoralizim.

Shumë nga policët e SHPK-së në veri të Mitrovicës dhe Zveçanit e shohin angazhimin e tyre në polici vetëm si të përkohshëm. Ata me kujdes shikojnë se kush nga jashtë strukturës së policisë e ngreh litarin dhe i përshtaten asaj. Një polic raportohet të ketë thënë se ai do të rrinte, "derisa të na thuhet ... nga ata, e dini, nga të cilët janë në kontroll, ata që kanë vendosur deri tani".[156] Një burim policor i UNMIK-ut tha: "KNS dikton se çka mund dhe çka nuk mund të bëjë pjesëtarët serb të SHPK-së".[157] Natyrisht, shoqëria e veriut të Mitrovicës është e vetëdijshme për këtë varësi, duke e zvogëluar edhe më tej besueshmërinë në SHPK. Siç tregoi marsi i vitit 2004, e vetmja mënyrë e sigurt që policët serbë të SHPK-së të fitojnë respekt në komunitetin e vet është ta mbrojnë atë nga sulmet që mund të vijnë nga jugu, d.m.th. duke vepruar si trupa etnike me elemente të rolit të Rojave të Urës. Së fundi, Beogradi ka ndikim shumë më të madh në këta policë se sa që ka komanda e lartë në Prishtinë.[158]

### 3. Komanda policore rajonale

Deri në fund të vitit 2005, UNMIK-u planifikon që të transferojë kompetencat mbi bazën rajonale policore të Mitrovicës tek vendorët -- komanda e fundit për t'u transferuar nga gjashtë komandat rajonale të Kosovës.[159] Disa njësite speciale rajonale do të transferohen edhe më herët. Njësiti rajonal i trafikut tashmë është transferuar. Nëse çdo gjë shkon sipas planit, transferimi i plotë do të vijë menjëherë pas krijimit formal të Ministrisë së punëve të brendshme dhe asaj të drejtësisë si dhe pasi që të ketë filluar procesi i zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës.

Ky është një plan optimist. UNMIK-u shpreson që të mbajë së bashku komandën rajonale duke graduar serbët në pozitat më udhëheqëse, përfshirë këtu edhe komandantin rajonal. Natyrisht, është e drejtë që një nga gjashtë bazat rajonale policore të Kosovës të ketë një jo-shqiptar në detyrë. Rajoni i Mitrovicës përbëhet nga tri komuna të dominuara nga serbët dhe tri nga shqiptarët. Kandidati i mundshëm për komandant rajonal, Ergin Mediq duket të ketë besim në ushtrimin e autoritetit të tij në këtë territor me popullsi të përzier. Poashtu, është raportuar se ai beson që profesionalizmi dhe etika e shërbimit gradualisht po zënë vend në SHPK gjë që do të ndihmojë në luftimin e presioneve nga jashtë.[160] UNMIK-u nuk planifikon që të sfidojë prezencën e stacioneve të

[153] Intervistë e Grupit të Krizave, qershor 2005.

[154] Një shembull i freskët ështe dështimi i tyre që të arrestonin një të dyshimtë të identifikuar për të cilin ishte shpallur fletëarresti dhe i cili po grindej në një kafene. Duke ia lënë këtë policisë civile të KB-ve, policët e SHPK-së e justifikuan mosveprimin e tyre me argumentin se i dyshuari ishte i lënduar.

[155] Për shembull, në fund të qershorit të vitit 2005 policia e KB-ve në stacionin verior u detyruan të blenin një akumulator për të zëvendësuar në veturën patrulluese sepse nuk kishte fonde për këtë qëllim në buxhetin e SHPK-së.

[156] Informacion i vënë në dispozicion të Grupit të Krizave, maj 2005.

[157] Një gazetar shqiptar e përshkroi një shembull të vogël lidhur me këtë. Kur ai u përpoq të kalonte urën kryesore në qershor të vitit 2005, një aktivist i njohur i KNS-së e vërejti atë dhe foli me një toger të SHPK-së. Disa minuta më vonë togeri dhe dy policë tjerë të SHPK-së iu afruan gazetarit dhe ia kërkuan letërnjoftimin. Pastaj shkuan prapë tek aktivisti i KNS-së për t'i raportuar. Intervistë e Grupit të Krizave, korrik 2005.

[158] Dhe natyrisht, Beogradi paguan paga paralele. Në qershor të vitit 2005, UNMIK-u kapi një shumë të madhe dinarësh të dërguar nga Serbia, të plotësuar me një listë të pranuesve të SHPK-së. Lorik Pustina, "Tradhtarët", *Express*, 17 qershor 2005. Burime policore ia konfirmuan detajet kryesore Grupit të Krizave.

[159] Tri prej gjashtë qendrave rajonale policore tashmë janë nën komandën vendore të SHPK-së. Një burim nga qendra policore rajonale e UNMIK-ut ishte i hutuar nga fakti se asnjë kriter apo qëllim nuk ishte vendosur si indikator i gatishmërisë për tranzicion. Intervistë e Grupit të Krizave, Korrik 2005. Në përgjithësi, UNMIK-u ka kritere të paqarta për planin kohor të transfereve të tilla dhe ka tendencë që të përdorë faktin e transferit si një tregues të pavarur të maturitetit të forcës dhe përmirësimit të sigurisë.

[160] Informacion i vënë në dispozicion të Grupit të Krizave.

MPB-së duke preferuar që përmes "trajtimit të pacientit" të rekrutojë më shumë policë të MPB-së përbrenda SHPK-së.[161] Oficerët e lartë të komunave, pothuajse njëetnike shqiptare, të Skenderajt dhe Vushtrrisë duket se nuk brengosen që të kenë komandantin rajonal të përkatësisë serbe. Ata më shumë brengosen që njësitet më të ndjeshme rajonale, si ajo e inteligjencës dhe ajo e krimeve serioze të ndahen në mënyrë më të drejtë se sa që janë të planifikuara tani, si dhe llogarisin në një zëvendëskomandant shqiptar -- bashkëveprues rajonal për stacionet komunale -- si ndhe mbështetjen e nevojshme dhe të menjëhershme për komandantin rajonal serb.[162]

Sidoqoftë, ambienti social, ekonomik dhe ai i sigurisë mund të jenë shumë të brishta që kjo të mund të funksionojë. Policët serbë të SHPK-së hezitojnë të punojnë nën Ministrinë e punëve të brendshme të Prishtinës. Disa kanë kërcënuar me bojkot nëse një shqiptar emërohet ministër.[163] Zyrtarët e lartë shqiptarë të selisë qëndrore të SHPK-së në Prishtinë nuk mund t'i vizitojnë në mënyrë të sigurt stacionet e tyre në veri të Ibrit[164], përderisa në qendër shumë pak serbë mbajnë pozita të larta. Serbët poashtu janë shprehur jo të gatshëm që të aplikojnë për pozita në qendrën rajonale në jug të lumit në qendër qytetit të Mitrovicës si dhe ata janë shumë pak të përfaqësuar në njësitet rajonale. Së paku një nga ato njësite ka ftuar serbët që të aplikojnë për pozita me ç'rast edhe kriteret e pranimit janë zbutur, por pa ndonjë rezultat. UNMIK-u ka nxitur gradimin e serbëve për të udhëhequr njësitet rajonale, mirëpo është raportuar se disa nga këta policë janë nën presion të madh shoqëror për mospranim të këtyre posteve. Në njësitet ku integrimi ka shkuar relativisht mirë, duket se presioni shoqëror është duke u forcuar. Në korrik, dy serbë nga një njësit i tillë kanë kërkuar që të transferohen në veri të Ibrit; njëri prej tyre ka dhënë shpjegim se "Unë konsiderohem si tradhtar në veri. Unë konsiderohem si i dyshimtë në jug".[165]

Pamundësia e vazhdueshme e policëve që të punojnë në territorin tjetër etnik, poashtu kontribuon në brishtësinë e komandës rajonale. Një hetues i aftë shqiptar që mirret me rastet e dhunës së brendshme, të cilit së voni i është dhënë detyra në stacionin verior, nuk mund ta kryejë detyrën nëse viktima ose i dyshuari është serb. Ai dhe të tjerët janë të kufizuar në kontrollimin policor të komuniteteve të izoluara shqiptare. Ata nuk do të gjenin bashkëpunim në komunitetin serb dhe me gjasë edhe do të sulmoheshin. Edhe nëse tensionet ulen do të ketë barriera gjuhësore, pasi që shumë policë shqiptarë nuk flasin gjuhën serbe dhe anasjelltas -- gjë që nuk ka qenë kërkesë për t'u pranuar në polici. Në një njësit rajonal -- të trafikut -- i cili rregullisht ka pasur patrulla të përziera në veri dhe jug të Ibrit, gjuha shkakton probleme të vazhdueshme në marrëdhëniet me publikun.

Thënë shkurt, po që se nuk i ofrohet më shumë ndihmë se sa që është planifikuar tani, komanda rajonale e Mitrovicës ka mundësi që gjatë procesit të statusit final të ndahet.

[161] Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë të lartë të UNMIK-ut, Prishtinë, 31 gusht 2005.
[162] Intervista të Grupit të Krizave, korrik 2005.
[163] Një burim nga shtylla e UNMIK-ut e udhëhequr nga OSBE raportohet të ketë shprehur shqetësimin për këtë. Shih Artan Mustafa, "Jo-Ministër shqiptar", *Express*, 2 gusht 2005.
[164] Ata e respektuan një paralajmërim nga autoriteti komunal i Zveçanit që të qëndrojnë larg ceremonisë së transferimit të komandës së stacionit policor në Zveçan në fillim të dhjetorit të vitit 2004. Ata po ashtu nuk kanë marrë pjesë në ceremoninë e transferit të stacionit të veriut të Mitrovicës më 17 gusht 2005.
[165] Intervistë e Grupit të Krizave me një komandant të policisë, korrik 2005.

# VI. PROJEKTIMI I ZGJIDHJES

Secila mënyrë e zgjidhjes për Mitrovicën dhe veriun e Kosovës nuk mund të jetë shumë e ndryshme nga status quo-ja e gjashtë vjetëve të fundit pasi që asnjëra anë nuk do dojë t'i lejojë tjetrit diçka që nuk është merituar nga forca lokale. Çdo propozim që e lë veriun e Kosovës brenda një Kosove të pavarur rrezikon provokimin e rebelimit të serbëve, pa marrë parasysh si janë të sistemuar ata. Balanci i forcave në veri është delikat, derisa rreziku se një zgjidhje e negociuar ose nuk do të arrihet ose nuk do të mbijetojë është i lartë. Zgjidhja duhet të merr parasysh forcën serbe në terren si dhe mungesën e legjitimitetit që kanë institucionet qeverisëse të Prishtinës. Por ajo duhet të pasqyrojë edhe garancinë e Grupit të Kontaktit mbi integritetin territorial dhe pamundësinë e kthimit të kontrollit të Serbisë mbi Kosovë. Ekuilibri ndërmjet këtyre përparësive relative kontradiktore nuk është i vendosur. Shumë do të varet nga perceptimi i palëve se sa janë të vendosur garantuesit e tyre reciprok. A do të mbizotërojë vendosmëria e Serbisë për të qenë faktor dominant në veri të Kosovës ndaj përkushtimit e Grupit të Kontaktit për të garantuar mosndarjen?

Qëllimi i komunitetit ndërkombëtarë duhet të jetë një arkitekturë shtetërore e Kosovës që u lejon serbëve të veriut një autonomi praktike të konsiderueshme dhe siguri ndaj dominimit shqiptar, por jo të drejtën për ndarje apo për të rikthyer elementet e shtetit serb të cilat nuk janë në pajtueshmëri me Qeverinë e Kosovës. Roli i Mitrovicës duhet të jetë si qendër shërbimi për serbët e tërë Kosovës, dhe Prishtina t'ia transferojë asaj elementet e qeverisjes për të administruar me ato shërbime.

## A. PROCESI

### 1. Afati kohor

Lënja e Mitrovicës për fund, duke pritur kompletimin e pjesës tjetër të procesit të statusit final, do të krijonte një peng të rrezikshëm që do të mund të devijonte tërë procesin. Mosdhënia e kujdesit të duhur kësaj çështjeje, në ndërkohë, do të përkeqësonte rreziqet e njërës apo tjetrës anë duke dashur të imponojë një zgjidhje jashtë procesit. Njëjtë, Mitrovica dhe veriu nuk do të zgjidhen pa mjete kushtëzuese të vendimeve të marra për statusin e përgjithshëm të Kosovës. Këta faktorë duhet ta drejtojnë Grupin e Kontaktit dhe të dërguarin e KB-së në strukturimin e procesit të statusit final. Ata së paku duhet të shënojnë fillimin e saj duke shprehur një bindje mbi zgjidhjen e preferuar: që Kosova të bëhet një shtet funksional, me pavarësi të kushtëzuar përbrenda kufijve të saj të vendosur.

Qartësia më e paktë do të lë negociatat mbi statusin e Kosovës në rrezik që të mbingarkohen nga zhvillimet që do të kërkonin menaxhim të krizave. Gjithashtu do ta bënte të vështirë përpjekjen e koncentruar për ta zgjidhur çështjen e Mitrovicës dhe Veriut që do të duhej të ndiqej në mënyrë energjetike në fillim të procesit. Zyrtarët ndërkombëtar në Kosovë e konsiderojnë Administrimin e Përkohshme të KB-së në Sllavoninë Lindore -- Kroaci (UNTAES) si modelin rajonal më të suksesshëm dhe më të përshtatshëm për ta aplikuar në veriun e Kosovës dhe Mitrovicë. Elementi thelbësor në suksesin e saj ka qenë që rezultati i dëshiruar është krijuar që në fillim, ndryshe nga Brçko në Bosne ku çështja është lënë e hapur për raundet e ardhshme të gjykimit. Një zyrtar i lartë i UNMIK-ut ka komentuar: "Idetë e ngjashme me Brçkon më tmerrojnë. Neve nuk na duhet edhe një mision i bllokuar".[166]

Po që se kjo përpjekje do të ketë fërkime me protagonistët, duhet të ketë një shkallë të sigurisë paraprake se çfarë do të jetë sistemi përfundimtar për Kosovën, pasi që asnjëra palë, përderisa pozicionet e tyre maksimaliste mbesin në lojë, nuk do të dojë të lëvizë rreth çështjes së Mitrovicës. Mbajtja e një pamjeje të jashtme që mund të jetë çfarëdo që protagonistët pajtohen është e padobishme. Maksimalizimi i shkallës së përmbajtjes së elementeve për të cilat pajtohen palët për zgjidhjen e ardhshme është e dëshirueshme, natyrisht për shkak se e ulë rrezikun për konflikte të reja. Megjithatë, vetëm ngushtimi progresiv nga komuniteti ndërkombëtar i mbështjellësit si dhe perspektiva e gjykimit kanë mundësi që të prodhojnë një situatë të tillë. Komuniteti ndërkombëtar duhet të detajizojë në mënyrë më të theksuar kornizën e vet të statusit final në mënyrë që të ndihmojë suksesin e Mitrovicës e cila do të rezultojë me qartësimin e mëtutjeshëm të rregullave bazë për pjesën tjetër të procesit të statusit final.

[166] Intervistë e Grupit të Krizave, 30 gusht 2005. UNTAES pas Marrëveshjes së Erdutit të nëntorit të vitit 1995 veproi nga janari 1996 deri në janar 1998 për të ri-integruar Sllavoninë Lindore në Kroaci të mbajtur nga serbët. Mandati i qartë i misionit dhe uniteti i komandës civile dhe ushtarake nën një administrator të fuqishëm ndihmoi në arritjen e qëllimit kryesor, edhe pse një numër i rëndësishëm i popullatës serbe të këtij rajoni u zhvendos. Marrëveshja e Dejtonit e vitit 1995 e la statusin final të qytetit strategjik Brçko të Bosnës të hapur për arbitrim, një proces i cili përfundimisht në qytet solli një regjim ndërkombëtar. Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.49, *Thyerja e Shtegut: Kthimi i Refugjatëve në Kroaci*, 9 nëntor 1998; dhe raportin për Evropë të Grupit të Krizave nr.144, *Bosnia's Brcko: Getting In, Getting On and Getting Out*, 2 korrik 2003.

## 2. Ndërtimi i kapaciteteve

Përpjekja për zgjidhjen e çështjes së Mitrovicës dhe Veriut, duhet të udhëhiqet nga një Komisioner Special në rang të zëvendësit të PSSP-së i cili do të ishte i lidhur ngushtë me negociatorët dhe me forca të besueshme të sigurisë nën autoritetin e tij/saj. Grupi i Kontaktit do ta zgjedhte një zyrtar të tillë -- më së miri nga një shtet anëtar i NATO-s me përvojë ushtarake dhe implementim civil -- i ngarkuar që të koordinojë negociatat dhe me funksione administruese dhe imponuese, i cili do t'i raportonte të Dërguarit Special të KB për negociatat për statusin e Kosovës si dhe PSSP-së. Paralelisht, komuniteti ndërkombëtar duhet të rrisë resurset njerëzore, financiare dhe ato të sigurisë në Mitrovicë dhe Veri.

Përkundër rëndësisë së saj për të ardhmen e Kosovës, Mitrovica mbetet në amulli sa i përket vëmendjes, energjisë dhe burimeve që UNMIK-u dhe komuniteti i gjerë ndërkombëtar ia dedikojnë. Dy zyrtarët e UNMIK-ut të cilët së fundi i ka angazhuar PSSP-ja që të sugjerojnë zgjidhje, kanë propozuar që të përcaktohet statusi gjendja e dëshirueshme përfundimtare dhe pastaj të identifikohen hapat e nevojshëm.[167] Megjithatë, UNMIK-u ka një trashëgimi të hapave të pa-përmbushur dhe pritjeve të rrënjosura të dështimit për tejkalim të situatës. Edhe masat me dukje të jashtme si të suksesshme, rezultojnë boshe nga ekzaminimi i afërt, siç ishte hapja formale 24 orëshe e urës kryesore të Mitrovicës. Siç e shpreh këtë ish-Kryeministri i Kosovës Bajram Rexhepi, "ekziston një zbrastirë e madhe në mes të menduarit, fjalëve dhe veprimeve në këtë fushë"[168]

Kërkohet një mekanizëm i ri më energjik, koherent dhe me autoritet të vërtetë në mënyrë që t'i zbatojë politikat ndërkombëtare në Mitrovicë. Në fakt, shkalla e stabilitetit të thyeshëm që deri tash ekziston atje është një nënprodukt i besimit Serb në paaftësinë e UNMIK-ut që ta thyejë këtë gjendje stagnimi. Përpjekja pa entuziazëm e komunitetit ndërkombëtar në Mitrovicë duhet t'i lëshojë rrugë ndjenjës së përshpejtimit të procesit. Komisioneri Special duhet të shfrytëzojë dhe koordinojë burimet ekzistuese ndërkombëtare si dhe të sjellë më shumë nga ato, në mënyrë që të forcojë kapacitetet dhe t'i mbushë zbrazëtirat e identifikuara. Orientimi duhet të dallojë nga puna rutinore në formë të projekteve. Stafi ndërkombëtar në qytet, privatisht shprehin brengosjen se ata nuk kërkohen që të punojnë drejt një strategjie koherente. Ata kanë bindjen se informacionet e tyre nuk mirren parasysh në zyrat qendrore të UNMIK-ut, prej nga jipen udhëzime pa asnjë konsultim.[169]

Është me rëndësi jetike që gjatë periudhës së negociatave të ketë në dispozicion më shumë kapacitete të sigurisë. Niveli i sigurisë duhet të rritet për dallim nga ajo që është duke ndodhur tani. Plani për transferimin e përgjegjësive komanduese në stacionet policore lokale dhe atë regjional duhet të ngadalësohet, e gjithshtu në mënyrë që të lejohet që gjatë bisedimeve për statusin final të adresohet edhe çështja e përbërjes së komandës rajonale veriore të SHPK-së. Shtimi i kontingjentit të ri të besueshëm dhe të rëndësishëm të trupave të KFOR-it për Mitrovicën dhe Veriun, si dhe shpërndarja nën mbrojtje të UNMIK-ut të një trupi të rëndësishëm të policëve paraushtarak të Forcës Evropiane të Xhandarmërisë[170] do të kishte efekt stabilizues dhe do të sinjalizonte një vendosmëri të re. Nuk mund të pritet nga serbët që t'i braktisin apo minimizojnë rolin e strukturave të tyre paralele të sigurisë pa një garanci më të fortë të sigurisë nga ana e komunitetit ndërkombëtar. Riorganizimi i propozuar i KFOR-it -- zëvendësimi i brigadave rajonale me një strukturë të re të task forcave -- ofron një prezencë më efikase, dhe do të ketë për qëllim përmisimin e sigurisë në veri.

Faktor tjetër në suksesin e UNTAES ishte se administratori, në mënyrë të drejtpërdrejtë, kontrollonte forcat ndërkombëtare të sigurisë dhe që në fillim e bëri me dije se ishte i vendosur se do t'i përdorte ato.[171]Në të kundërtën, përpjekjet për të bashkuar pjesët e ndara siç është rasti me Mostarin, hasi në sukses më të vogël, kur nuk iu kushtuan vëmendje të duhur mungesës së sigurisë[172]

---

[167] Intervista të Grupit të Krizave me Craig Jenness, këshilltarë për minoritete brenda zyres së PSSP-së, dhe Gerard Gallucci, përfaqësuesi i UNMIK-ut në regjionin e Mitrovicës, korrik 2005.

[168] Intervistë e Grupit të Krizave, jug i Mitrovicës, 12 korrik 2005.

[169] Intervista të Grupit të Krizave, Mitrovicë, 13 maj dhe 23 qershor 2005.

[170] Forca e Xhandarmërisë Evropiane është themeluar në shtator 2004 për pikërisht qëllime të tilla. Me bazë në Viçencë të Italisë dhe personel nga Italia, Spanja, Franca, Portugalia dhe Holanda, pritet të bëhet operacionale në javët e ardhshme. Intervistë e Grupit të Krizave me Sekretariatin e Këshillit të BE-së, 6 shtator 2005.

[171] Shefi i parë i UNTAES, Jacques Klein, i vendosi forcat e KB-së në operacione agresive ushtarake kundër forcave paraushtarake serbe. Ata e bënë arrestimin e parë të një të akuzuari të Tribunalit Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi (ICTY). Paraushtarakët serbë e morën mesazhin dhe shumë prej tyre u larguan duke i mundësuar Klein të vazhdojë me pjesën civile të misionit të tij.

[172] Vlen të përmendet se edhe Mostari e edhe Mitrovica ishin zona nën përgjegjësinë ushtarake të francezëve dhe dështimet në siguri në të dy qytetet kanë ngjashmëri të caktuara.

### 3. Ndërtimi i një vizioni për marrëveshje

Ashtu sikur me statusin final të Kosovës, përcaktimet kryesore lidhur me Mitrovicën dhe Veriun do të vijnë nga ana e komunitetit ndërkombëtar, por elitat shqiptare dhe serbe duhet të jenë të gatshme që t'i bëjnë të funksionojnë ato. As Prishtina, Beogradi e as Mitrovica ende nuk janë të fokusuara në gjetjen e një marrëveshjeje. Është e paqartë se kush nga të dy anët do të jenë partnerët. Udhëheqja politike shqiptare është e ndarë dhe e dobët. Qeveria e Koshtunicës në Beograd i ka bllokuar përpjekjet e Listës Serbe për Kosovë dhe Metohi, të përkrahur dobët, të Oliver Ivanoviq-it që të përfaqësojë serbët e Kosovës, derisa KNS të cilën Koshtunica e preferon ka refuzuar deri tani të punojë me UNMIK-un apo IPVQ-të. Lufta e pakryer në Kosovë dhe fitorja e pjesshme e shqiptarëve bën që elitat ende t'i qasen rezultatit përfundimtar si një loje pokeri. Vizioni politik mungon. Çështja është si të stimulohet ky vizion.

Kur partitë politike të shqiptarëve të Kosovës -- duke shpresuar se shumë shpejt -- të akordohen për një format të grupeve punuese për të përgatitur parimet negociuese për bisedimet për statusin final, UNMIK-u duhet t'ua bëjë me dije se ata, përbrenda parametrave ndërkombëtare që përjashtojnë ndarjen dhe të përcaktojnë decentralizim e plotë, duhet të punojnë në ndërtimin e një platforme të veçantë për të zgjidhur çështjen e Mitrovicës dhe Veriut,. Figurat e shoqërisë civile të interesuara në Mitrovicë duhet të ftohen në grupet punuese për Mitrovicën. Komisioneri Special duhet të punojë me këtë grup dhe të përpiqet të stimulojë zhvillime të ngjashme në anën e serbëve të Kosovës përmes kryetarëve të tri komunave të veriut, udhëheqjes së Listës Serbe për Kosovë dhe Metohi dhe KNS-së.

Një kombinim i përfaqësuesve nga mbarë Kosova dhe Mitrovica në këto organe platformë-ndërtuese duhet të reflektojë faktin se zgjidhja e statusit të përgjithshëm final dhe Mitrovica do të ndikojnë në njëra tjetrën. Komuniteti lokal shqiptarë dhe ai serb e kanë të ditur se nuk kanë udhëheqje të duhur për të negociuar zgjidhjen e Mitrovicës. Sidoqoftë, ata ende duan të jenë të përfshirë. Disa në jug të Mitrovicës shprehin shqetësime të pabaza se propozimi i ESI-t i shkurtit të vitit 2004 për të formuar një komunë serbe në verin e Mitrovicës dhe Zveçan që ishte gati për t'u implementuar ishte një element që shpiu te trazirat e muajit vijues.[173] Çfarëdo zgjidhje e diskutuar në Mitrovicë, thonë ata, ka shanse më të mira për t'u pranuar sesa cilado formulë e gatshme e përgatitur diku tjetër. Ata duan një shkallë të madhe të kontrollit mbi procesin që është i hapur për pjesëmarrje të gjerë. Serbët e Mitrovicës duan që Beogradi të negociojë për ta por së pari të konsultohet dhe të caktohen nevojat dhe kërkesat e tyre. Shumica e tyre janë të irituar me faktin se Beogradi i cakton pozicionet pa i konsideruar pikëpamjet e tyre.

Komuniteti ndërkombëtar duhet të orkestrojë pjesën e madhe të debatit nëpër forume. Në veçanti duhet të bind të dy elitat që njëra tjetrës t'i bëjnë oferta të matura dhe të kushtëzuara. Sa më tepër që principet e qeverisjes së Mitrovicës dhe Veriut të jenë të ndërtuara në kundërshtim e jo në pajtim me ofertat e tyre, aq më pak ka gjasa që ato të jenë të qëndrueshme. Megjithatë, zgjidhja e Mitrovicës dhe e Veriut nuk duhet të bëhet peng ndaj mosfunksionimit politik të shqiptarëve të Kosovës e as të bojkotit serb. Të dy palët mund të mos japin oferta adekuate politike përbrenda kohës së paraparë -- muajve të hershëm të procesit të statusit final. Komisioneri Special duhet të jetë i gatshëm që të përshpejtojë lëvizjet.

Komisioneri Special duhet të sajojë një proces që rritë shanset që zgjidhja të mund të transformojë e jo vetëm të zyrtarizojë ndarjen ekzistuese të Mitrovicës dhe Veriut. Ai ose ajo duhet të zhvilloj forumet që do të kanë pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve në procesin e negociatave më mirë sesa kjo t'iu lihet e tëra ekskluzivisht elitave politike. Komisioneri Special duhet gjithashtu të jep ide të shumta për të zgjeruar agjendën e negociatave dhe të merr parasysh forumet e dialogut të cilat po ndërtohen nga ana e përfaqësuesve të tanishëm rajonal të UNMIK-ut.

Shqiptarët janë qetësuar me Jo-në e Grupit të Kontaktit për ndarjen e Kosovës, e cila nga ana tjetër në masë të njëjtë ka shqetësuar shumë serbë. Komuniteti ndërkombëtarë duhet t'ua shpjegojë shqiptarëve se nuk duhet të bazohen në këtë garanci. Ata duhet t'i ofrojnë diçka serbëve të veriut të Kosovës e cila do të siguronte që ata të pranojnë parimin e mosndarjes. Për të inkurajuar formulimin e një vizioni realist për qeverisje të Mitrovicës dhe veriut, komuniteti ndërkombëtar duhet ta thotë qartë që:

- Kontrolli i centralizuar i veriut nga Prishtina nuk është i zbatueshëm; duhet të përcaktohet karakteri i decentralizimit dhe balanci i përgjegjësive qendër-rajon, autoriteti si dhe kompetencat;
- Vonesa në paraqitjen e ofertave serioze do të rrisë mundësinë që Beogradi të fitojë hapësirë për të paraqitur argumentet për kompensim territorial; dhe

[173] Intervistë e Grupit të Krizave me personelin e Nansen Dialogue, jug i Mitrovicës, 1 dhjetor 2004. Në fakt, propozimi i ESI-t nuk ishte as afër implementimit. Sidoqoftë, interesimi me të cilin në atë kohë ishte përshëndetur nga ana e udhëheqësve shqiptarë të Kosovës siç ishin Kryeministri Rexhepi dhe Veton Surroi, dhe adaptimi retorik i tanishëm i Marko Jakshiçit lidhur me të, sugjeron se ai përmban elemente premtuese të një zgjidhjeje të mundshme kompromisi. Ky raport ka synuar të bazohet në disa nga këto elemente.

- Një ofertë e mirë do të ndihmonte themelimin e një strukture të sigurisë të Kosovës, pasi që mungesa e qartësisë për atë se si strukturat e dominuara nga shqiptarët mund të operonin në relacion me Mitrovicën dhe veriun është një nga faktorët që vonon zhvillimin e tyre.

Shqiptarët duhet të ofrojnë plane për:

- Shkallën e autoritetit që do të decentralizohet në tri komunat e dominuara nga serbët në veri, parimin e njësive komunale serbe brenda Mitrovicës, dhe si këto marrëveshje mund të hyjnë në kushtetutën e Kosovës; dhe
- strukturat përmes të cilave veriu duhet të bashkëveprojë me institucionet qendrore të Kosovës dhe të gëzojë bashkëpunim dhe ndërveprim me Beogradin, si dhe për mundësinë dhe institucionalizimin e zëvendës kryeministrit serb dhe lëvizjen e dy apo tri ministrive në Mitrovicë.

Duhet të ofrohen mekanizma të tjerë për garanci të sigurisë së serbëve në veri të Ibrit, siç janë aranzhime të cilat do të plotësojnë pjesërisht aspiratat e serbëve për të kontrolluar policinë dhe drejtësinë në zonat e tyre. Shqiptarët e Kosovës mund të pranojnë në mënyrë eksplicite rolin e autoriteteve komunale në përcaktimin e shefave lokal të policisë të propozuar në projekt rregulloren e UNMIK-ut për polici[174] dhe ata mund të ofrojnë zhvendosjen e Gjykatës Supreme në qendër të Mitrovicës. Për regjionin e Mitrovicës mund të propozojnë një bord mbikëqyrës të sigurisë me përfaqësim të fuqishëm të serbëve, votë vendimtare të ndërkombëtarëve për aprovim paraprak të operacioneve të gjera policore apo lëvizjeve të forcave mbrojtëse të Kosovës atje.[175] Për të avancuar marrëveshje për siguri të përbashkët, shqiptarët do të mund të ofrojnë që zyra qendrore rajonale e SHPK-së në jug të Mitrovicës t'i nënshtrohet vendimeve të bordit mbikëqyrës, me kusht që zyra qendrore rajonale e MPB-së në veri të Mitrovicës të shuhet[176]

Mitrovica mund të propozohet si qendër e shëndetësisë, edukimit, shërbimeve sociale dhe mbështetëse kulturore e të gjithë serbëve të Kosovës, bashkë me bisedat e detajizuara për të realizuar këtë. Shqiptarët mund të ofrojnë njësinë komunale serbe përbrenda Mitrovicës, me kusht që të modifikohen lidhjet me Beogradin. Për shembull, mund të propozohet që një njësi e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me bazë në Mitrovicë, me shumicë serbe të personelit, e udhëhequr nga zëvendës ministri i përkatësisë serbe, të administrojë dhe të financojë -- nga buxheti i Kosovës, komuniteti ndërkombëtar si dhe nga Beogradi -- institucionet të cilat mund të dalin nga institucioneve paralele ekzistuese.

Njëlloj, Grupi i Kontaktit dhe Komisioneri Special duhet të kërkojnë më tepër përgjegjësi nga ana e Beogradit për veprimet e të autorizuarve të tij në verin e Mitrovicës. Ata duhet ta angazhojnë Beogradin në dialog për të ardhmen e qytetit dhe të punojnë me të në dhënien e formave legjitime udhëheqjes serbe në qytet.

## B. SUBSTANCIALE

### 1. Transformimi i shërbimeve

As udhëheqja e spitalit rajonal nga Milan Ivanoviçi e as udhëheqja e universitetit nga Radivoje Papoviçi nuk duhet të mbijetojnë. Me mbështetje të fortë nga ana e Grupit të Kontaktit, Komisioneri Special do të duhej të veprojë shpejt me të dy postet, duke vendosur afate kohore për përcaktimin e shefave të ri dhe duke i kërcënuar në mënyrë implicite me ndërhyrje fizike nga ana e forcave ndërkombëtare të sigurisë në rast të kundërshtimit nga ana e Beogradit dhe KNS-së. Komisioneri Special duhet të ofrojë formula për zgjedhjen e udhëheqësve të rinj, për shembull aprovim me konsensus nga ana e ministrive serbe dhe kosovare dhe të UNMIK-ut. Nëse konsensusi nuk është i mundshëm, Komisioneri Special dhe UNMIK-u do të mund të emërojnë kandidatët të cilët i konsiderojnë si më të përshtatshëm.

Për të siguruar lidershipin e ri për të implementuar mandatet e zgjeruara, donatorët duhet të sigurojnë fonde periodike përmes Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Spitali rajonal duhet të përcaktohet për të pranuar personel shqiptarë dhe të trajtojë pacientë shqiptarë, ndoshta 10 deri në 20% në vitin e parë, duke e rritur pjesëmarrjen e personelit deri në 30% dhe për pacientë deri në 50%.

Shefi i ri i universitetit duhet të ndjek kursin të cilin e ndoqën institucionet nën Gojko Saviçin, por më fuqimisht. Të pajisur me fondin periodik dhe dekretin nga UNMIK-u (dhe në mënyrë ideale një nga ana e Beogradit) që e anulon emërimin e Popoviçit, rektori duhet të modernizojë dhe riorganizojë fakultetet, të joshë stafin nga rajoni i gjerë i Ballkanit, përfshirë edhe shqiptarë, të konsiderojë caktimin e Anglishtes si gjuhë të ligjërimit në disa nga fakultetet, të organizojë shkëmbime me Universitetin e Prishtinës, veçanërisht rreth Universitetit Veror të UP-së në vitin 2006, dhe në vitin e dytë akademik të ketë së paku 10% të numrit total studentë jo-serbë.

---

[174] Ngjashëm me marrëveshjen e arritur në Maqedoni, rregullorja përcakton që komisioneri i policisë do të propozonte disa kandidatë nga të cilët autoritetet komunale mund të zgjedhnin.

[175] Organe të tilla mbikëqyrëse të sigurisë mund të themelohen në të gjitha pesë komandat tjera rajonale të policisë.

[176] Çfarëdo transformimi i SHPK-së është e mundur që ta centralizojë atë në Prishtinë, dhe të përjashtojë shumë nga strukturat e tanishme territoriale të zonave.

Komisioneri Special do të kryesojë gjithashtu me dy shërbime të reja shtesë të dizajnuara që të zgjerojnë rolin e Mitrovicës në relacion me komunitetin e tërësishëm serb. Ai do të ndërmjetësojë me Beogradin dhe me Qendrën Koordinuese në veriun e Mitrovicës për të mbikëqyrur publikimin për punë, përzgjedhjen dhe procesin e emërimeve në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) për të rekrutuar stafin për njësinë e ndarë, dhe të jetë i vendosur në lokacionet e Qendrës Koordinuese. Kjo do të ishte fillimi i autonomisë jo territoriale të serbëve në tërë Kosovën, të administrimit kulturor dhe personal në shëndetësi, edukim dhe në të gjitha sferat shoqërore. Donatorët duhet të ndihmojnë në fillimin e kësaj me një fond tjetër periodik, të shpërndarë përmes MEF-it, ashtu që stafi do të arrinte në Qendrën Koordinuese me "pajën" e tyre. Për t'i dhënë Beogradit nxitje për të bashkëpunuar me Prishtinën në këtë drejtim, për disa vite fonde të njëjta do të duhej t'iu sigurohen strukturave paralele, me kusht që të ecin kësaj rruge paralele. Nëse Beogradi refuzon t'i shkrijë strukturat e tij paralele në IPVQ me këto kushte të favorshme në vitin 2006, oferta do të tërhiqet. BE-ja, FMN-ja dhe bankat për zhvillim do të ngushtonin politikat e tyre për të parandaluar Serbinë në përdorimin e ndihmës së tyre dhe të kredive të buta për të mbështetur struktura ilegale në Kosovë.

Një tjetër donacion duhet të ndihmojë në themelimin e një njësie të re të televizionit publik të Kosovës, RTK-së, në mënyrë që të startohet me kanalin RTK2 në gjuhën serbe dhe me shtrirje në gjithë Kosovën. Në mënyrë ideale, i vendosur në jug të lumit në zonën qendrore, do të ishte një nyje profesionale që do t'i shpinte komunitetet drejt njëri tjetrit në qendër të Mitrovicës.

## 2. Organizimi i ri komunal i Mitrovicës

Duke marrë parasysh të tërë bagazhin që do ta merr Mitrovica në Kosovën e pas statusit, cila formulë ofron perspektivë më realiste për një qytet të qëndrueshëm e të unifikuar? Logjika e pilot projekteve të decentralizimit në Kosovë, I mandatuar nga ana e Këshillit të Sigurimit dhe Grupit të Kontaktit pas trazirave të Marsit të vitit 2004, e bënë të duket e pashmangshme që cilado zonë e rëndësishme me shumicë serbe të mund të bëhet njësi me qeverisje lokale. Në të vërtetë, strukturë e tillë e një komune të re ka ekzistuar në veriun e Mitrovicës që nga fundi i vitit 2002, vetëm se ishte e udhëhequr nga një administrator i UNMIK-ut, e jo nga një kryetar i zgjedhur komune. Shumica serbe atje është pasojë e pastrimit etnik të pas-luftës por stafi ndërkombëtar jo publikisht pranon se dhënia e statusit të njësisë komunale është sigurisht e vetmja rrugë që parandalon ndarjen. Një njësi e tillë do të mund të vendoste për herë të parë udhëheqje serbe legjitime dhe të votuar në qytet.

Strategjitë alternative sugjerojnë që rikonfigurimi i Mitrovicës ose do të absorbonte veriun e Mitrovicës në Zveçan ose do ta ndajë qytetin në nën-njësi, të lidhur me bordin e përbashkët komunal. Qasja e parë, e propozuar nga ESI në vitin 2004, do të shihte Mitrovicën si një pikë takimi të dy vendeve fqinje, prandaj edhe do të zbehte ndjenjën e identitetit të qytetit. Qasja e dytë, e përkrahur ndër të tjerë edhe nga ana e Oliver Ivanoviçit, do të kërkonte të lartësohej veçantia e qytetit, duke e bërë atë qendër të fuqishme të gravitetit[177]

Bashkimi i veriut të Mitrovicës me Zveçanin do t'u ofronte serbëve sigurinë në numër gjë e cila do t'i inkurajonte për të kryer më tepër aktivitetet përtej Ibrit. Afro 20.000 serbë, edhe në rastin e kthimit maksimal të shqiptarëve në veri të Mitrovicës, do t'ia kalonin në numër shqiptarëve me raport dy me një. Është një pyetje e hapur, sidoqoftë, nëse dy administratat do të pranonin me dëshirë unifikimin. Komuna e Zveçanit dhe administrata me personel serb e UNMIK-ut në veriun e Mitrovicës i kanë zhvilluar interesat e tyre burokratike, dhe me mungesë të vendeve të punës, dhe asnjëra prej tyre nuk mirëpresin shkrirjen.

Gjithashtu është pyetje e hapur nëse veriu i Mitrovicës pa 7.000 serbët e Zveçanit mund të formojnë shumicë të qëndrueshme serbe. Edhe pse veriu i Mitrovicës si komunë në vete mund të lejonte më tepër luhatje politike në veri të Ibrit, mungesa e sigurisë për qëndrueshmërinë e shumicës serbe mund ta bëjë atë më pak të bindshme ndaj sundimit të ligjit dhe ndaj kthimit të shqiptarëve, si dhe më të sigurt për masat e sferave të shquara jokompatibile me të drejtat pronësore dhe lirinë e lëvizjes. Komisioneri Special duhet të vendosë deri në fund të vitit 2005, duke u bazuar në konsultime të gjera dhe informata mbi numrin e popullatës, përfshirë këtu edhe personat e zhvendosur me pronë të pa-shitur në veriun e Mitrovicës. Ai nga ana e udhëheqësve serbë do të duhet të siguronte kthimin e shqiptarëve në kompensim me demaskimin e kufijve të rinj. Komisioneri Special ka mundësi të vendosë që të emërojë këshilltarë fillimisht në vend se të shkohet menjëherë me zgjedhje komunale në veri, pasi që përpilimi i listave elektorale do të mund të ishte shumë delikate dhe do të duheshin së paku disa muaj.

Në të vërtetë mundësimi i kthimit në vitin 2006 do të kërkoje vëmendje taktike nga ana e Komisionerit Special. Propozimi i ESI-të ka paraparë dhënien e komunës së re serbëve të Mitrovicës vetëm kur ata të kenë pranuar kthim të konsiderueshëm të shqiptarëve. Suksesi mund të jetë më i arritshëm nëse vendoset lidhja midis fazave të themelimit të komunës së re me nivel të caktuar të kthimit.

---

177 Oliver Ivanoviqi sugjeron ndarjen e Mitrovicës në tri njësi komunale, gjë që do të zbehte dualitetin e theksuar shqiptaro-serb.

### 3. Hapësirë për unifikim

Nëse Mitrovica i lihet dualitetit të thjeshtë midis komunës serbe në veri të lumit Ibër dhe një komune shqiptare në jug të saj, atëherë do të ketë më pak arsye për cilindo komunitet që të planifikojë aktivitete apo të bashkëpunojë me tjetrin. Në vend të gjetjes së modaliteteve për ngjalljen e vendeve të përbashkëta, tendenca do të jetë që të ndërtohen zëvendësimet për çfarëdo që mungon në gjysmën e tyre të qytetit, dhe nëse, që është shumë e mundur, nuk ka mjete të mjaftueshme, atëherë të vazhdohet edhe pa to.

"Zona e besimit" në qendër e mbajtur për pesë vjetët e fundit nuk duhet të shpërbëhet. Një zonë apo qark që do të shtrihej në të dy anët e lumit duhet të ekzistojë për të shërbyer si zonë ndër-komunale, të zbusë dhe minimizojë ndarjen dhe të krijojë më tepër politikë fluide të qytetit. Komisionerit Special i duhet të përcaktojë aranzhimet elektorale. Qendra kulturore dhe kompleksi sportiv i qytetit, të dyjat në bregun jugor duhet të jenë pjesë e saj, sikurse që duhet të jetë edhe biblioteka e qytetit dhe t'i nënshtrohen menaxhmentit të përbashkët dhe mirëmbajtjes. Zona qendrore mund të strehonte institucionet me funksione të lidhjes ndëretnike, në nivel të qytetit dhe të shtetit, kjo e fundit ndoshta të përmbajë edhe RTK2 e propozuar, njësinë e re të MEF-it dhe pjesë tjera të ministrive dhe institucioneve të zhvendosura nga Prishtina sikurse është Gjyqi Suprem i Kosovës dhe departamentet me personel serb të ministrive tjera të inkuadruara në administrimin e sistemit të përgjithshëm autonom të edukimit, shëndetësisë, shërbimet shoqërore dhe kulturore të Kosovës për serbët që do të absorbonin strukturat paralele të Beogradit. Sa më tepër që Prishtina të transferohet në Mitrovicë aq më tepër ka gjasa që serbët dhe Serbia ta pranojnë një rol për qytetin si nyje nëpërmes së cilës mund të bashkëpunojnë për mbështetjen e komunitetit serb në tërë Kosovën, dhe të gëzojnë fjalën në institucionet qendrore dhe në qeveri.

Si pjesë përbërëse të aranzhimeve të reja, Komisioneri Special duhet të themelojë një bord të përbashkët të qytetit, me seli në zonën qendrore dhe të përbërë nga zyrtarë të deleguar nga të dy komunat. Sikurse që MEF-i zvogëlon një pjesë të buxhetit të Mitrovicës për të financuar administratën e përkohshme të UNMIK-ut në veriun e Mitrovicës, secila nga dy komunat me kufi të rinj, duhet të drejtojnë një pjesë të buxhetit të tyre në bordin e përbashkët në mënyrë automatike. Detyrat e tij do të përfshinin çështjet e menaxhimit të mbarë qytetit, menaxhimin e vendeve të përbashkëta siç janë qendra kulturore, kompleksi sportiv dhe biblioteka, dhe -- deri në masën sa ekziston gatishmëri -- çështjet e iniciativave zhvillimore të qytetit dhe ato ndërkomunale.

### 4. Ekonomia e qytetit

Një program shumë-dimenzional për investime nevojitet për të ringjallur ekonominë, por vetëm për nevoja afatshkurtëra pa gjeneruar një flluskë të paqëndrueshme. Infrastruktura e qytetit është e shkatërruar dhe e ndotur. Niveli i edukimit është i ulët, dhe shkathtësitë e fuqisë punëtore janë të papërdorshme. Çmimet rekorde botërore të plumbit dhe zinkut kanë bërë të mundur rifillimin e kufizuar të punës së minierave por menaxherët e Trepçës flasin për kapacitete të ulëta dhe motivim të dobët në mesin e fuqisë punëtore serbe dhe shqiptare si sfida më të mëdha për veprimtari. Planifikohet të hapet fabrika për riciklim të baterive të automjeteve në Zveçan dhe është duke u bërë një studim për riaktivizimin e shkritores së zinkut dhe linjës prodhuese të baterive të automjeteve në veriun e Mitrovicës.[178] Sidoqoftë, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës e ngarkuar për ti zgjidh qështjet kontestuese rreth privatizimit, përkrahë kërkesat e çfarëdo kompanie të huaj që ka punuar me menaxhmentin Serb të kohës së Milosheviçit gjatë viteve '90, dhe me gjasë Trepça do të likuidohet. Mbështetje kërkohet për krijimin e Ndërmarjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Gjetja dhe ofrimi i fondeve zhvillimore përmes bankave do të stimulonte sistemin bankarë dhe do të rriste kërkesën për ndihmë tek sistemi i gjykatave të UNMIK-ut/Kosovës, siç u diskutua më lartë. Të dy programet, ai për ndihmë ndërmarrjeve afariste dhe tenderëve për një numër të projekteve për infrastrukturë duhet të jetë i kushtëzuar me rekrutim të stafit nga të dy komunitetet. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet transparencës dhe proceseve të tenderimit.

### 5. Marrëveshet për sigurinë për veriun e Kosovës

Përcaktimi i çfarëdo zgjidhjeje në veri që nuk është ndarje i duhet të ketë në vete përfshirje më të madhe të UNMIK-ut dhe veçanërisht KFOR-it në çështjet e sigurisë. Ky i fundit duhet ta bëjë qartazi Mitrovicën dhe Veriun fokus primar operacional dhe të riaranzhojë strukturën e brigadave ashtu që t'i përshtatet kësaj. Policia ndërkombëtare dhe doganierët nevojiten në kufirin me Serbinë dhe Malin e zi në Leposaviq dhe në Zubin Potok, dhe siç u diskutua gjerësisht më lartë, planet e UNMIK-ut për të transferuar përgjegjësitë në policinë vendore në rajonin e Mitrovicës, duke e konsideruar atë sikurse edhe rajonet tjera, janë jorealiste dhe të rrezikshme. Komandantët ndërkombëtarë dhe policët duhet të vazhdojnë të përkrahin komandën rajonale dhe stacionin policor në veriun e Mitrovicës derisa nuk arrihet një konsensus shqiptaro-serb mbi sigurinë dhe ai të implementohet. Tërësia territoriale e Kosovës varet nga

[178] Intervistë e Grupit të Krizave me Charles Carron Brown, 20 prill 2005.

arritja dhe mbështetja e një vizioni të përbashkët të shqiptarëve dhe serbëve për menaxhim të sigurisë në veri. Nëse negociatat janë kundër tërheqjes së ndërkombëtarëve, kjo do të jetë një stërvitje në ndarjen e tanishme.

Balanci i vështirë i nevojshëm përfshinë pranimin nga ana e serbëve të statusit të Kosovës në kundërshpërblim për garancitë e shqiptarëve për aranzhimet nënkontraktuese mbi sigurinë në veri. Të dy palët kërkojnë mekanizëm të besueshëm mbikëqyrës që siguron përjashtim të strukturave të sigurisë në veriun e Kosovës dhe që forcat e ardhshme të Kosovës të dominuara nga shqiptarët të mos operojnë në veri pa pengesë. Komisioneri Special duhet të punojë për të siguruar apo arbitruar një koncept të tillë të përbashkët dhe të vendosë një organ të përbashkët koordinues të sigurisë ndërkombëtare serbo-shqiptarë në zonën qendrore të Mitrovicës për të mbikëqyrur implementimin e saj. Ai duhet të jetë i përfshirë në këtë organ dhe në menaxhmentin e çështjeve tjera të rëndësishme të sigurisë që nevojiten të adresohen në viti 2006, përfshirë këtu largimin e stacionit të MPB-së (MUP) nga veriu i Mitrovicës dhe futjen në përdorim të tabelave të regjistrimit të veturave të Kosovës.

Bisedat e strukturuara shqiptaro-serbe mund të vendosin mbi elemente të rëndësishme nën-kontraktuese për policinë dhe menaxhimin e kufirit në veri nga ana e ndërkombëtarëve në një bazë vazhdueshme. Kufiri me Serbinë ilustron këtë nevojë. Edhe mbikëqyrja e përbashkët, aranzhimet e kuotave dhe oraret me rotacion nuk do të zgjidhin problemin këtu. Serbët mund t'i shohin shqiptarët gjatë kontrollimit të kufirit si një kërcënim për ekzistencë. Siç tha njëri, "në një fazë shqiptarët nuk do të jenë në gjendje të fshehin oreksin e tyre për pushtet në veri. Ata do t'i vendosin njerëzit e tyre në kufi me Serbinë dhe konflikti do të shpërthejë"[179] Shqiptarët me gjasë do ta konsiderojnë pavarësinë e tyre të rrezikuar nëse ata nuk do të mund të kontrollojnë të gjithë sektorët në atë kufi, edhe vetëm po që se për shkak se mundësitë e kontrabandimit do të -- siç është rasti tani -- zvogëlojnë rritjen e të hyrave dhe rregullimin e ekonomisë.

Nën-kontraktimi i përgjegjësive të kontrollit të kufirit tek ndërkombëtarët, mund të jetë një zgjidhje kompromisi, një zgjidhje që mund të vendosë presedan për fushat tjera të zgjidhjes finale, përfshirë gjykatat e larta, prokurimin, dhe zyrën e auditorit të përgjithshëm. Sa më tepër të jenë ndërkombëtarët të përfshirë në një strukturë të shtetit të ardhshëm të Kosovës, aq më tepër do të jenë serbët të sigurt. Derisa shqiptarët mund të ngrihen kundër rolit të vazhdueshëm ndërkombëtarë, stabiliteti i zgjidhjes në fund të fundit varet nga perceptimi i secilit komunitet sesa shteti i ri do t'i sigurojë ata. Arkitektura e përgjithshme kushtetuese është e rëndësishme të paktën sa edhe strukturat e policisë dhe sigurisë. Ajo duhet të përmbajë aranzhime të kompetencave në të gjitha nivelet, jo vetëm në veri, që do t'i lidhte serbët, siç janë dhoma e Parlamentit për rishqyrtim të shkallës së dytë në mënyrë që t'i favorizojë komunitetet e pakicave; në pozitat e zëvendësministrave të jenë serbë; dhe panele të gjykatës kushtetuese me përbërje të barabartë të gjykatësve shqiptarë, serbë dhe ndërkombëtarë dhe jo vetëm të një shumice etnike.

## 6. Strukturimi në Kontestin e Përgjithshm

Serbia së fundi ka refuzuar integrimin e serbëve në institucionet qendrore të Prishtinës, dhe në anën tjetër ka vazhduar të kërkojë ndarjen territoriale etnike përbrenda Kosovës.[180] Nëse nuk mund të sigurojë ndarjen, ajo do të kërkojë së paku organizim të Kosovës të bazuar në modelin e Bosne Hercegovinës, dhe serbët të jenë një nga dy etnitetet përbërëse të Kosovës. Sovraniteti do t'i takojë secilit entitet, të cilët entitete do të dakordoheshin për ta bashkuar këtë sovranitet në institucione të përbashkëta për çështje të kufizuara. Kjo marrëveshje do të hapte rrugë për ndarje të mëvonshme.

Grupi i Kontaktit e ka përkrahur konceptin e PSSP Jessen-Petersenit mbi decentralizimin si një proces të udhëhequr nga Prishtina që e delegon pushtetin nga institucionet qendrore në njësi komunale dhe në njësi të reja të krijuara. Janë 30 komuna. Pesë pilot projekte që janë në diskutim do të shtonin edhe pesë të tjera, përfshirë këtu dy komuna të reja me shumicë serbe (Graçanica dhe Parteshi) dhe dy ekzistuese në jug të Ibrit (Shtërpce dhe Novo Bërdë), duke krijuar kështu një kundërpeshë në rritje për tri komunat në veri. Propozimet e Këshillit të Evropës për reformën e qeverisjes lokale në Kosovë në vitin 2003 kanë përfshirë një shtresë të re të ulët të njësive të shumta nën komunale, ndërsa në fillim të gushtit të vitit 2005 Oliver Ivanoviç kërkoi 70 nën divizione në 70 komuna. UNMIK-u dhe Grupi i Kontaktit janë duke mbajtur një kurs të mesëm ndërmjet kërkesave të shqiptarëve për të privilegjuar institucionet qendrore, duke i dhëne komunave vetëm privilegje lokale, dhe kërkesave të Beogradit që komunat serbe të marrin pushtet të gjerë që do të përshinte policinë dhe drejtësinë dhe që pjesën e tyre të përbashkët ta kenë të përcaktuar me kushtetutë si "rajon".[181]

Grupi i Kontaktit nuk e ka lejuar as pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të Beogradit në procesin e decentralizimit e

[179] Intervistë e Grupit të Krizave me Nenad Radosavleviqin, Leposaviq, 23 qershor 2005.

[180] Shih Raportin e Grupit të Krizave, Kosova: Drejt Statusit Final, fq. 16-17.

[181] Shih, po aty, lidhur me diskutimin mbi planin e propozuar nga Qeveria e Serbisë në prill të vitit 2004.

as entuziazmin për bashkimin e komunave serbe nën ndonjë autoritet të ndryshëm prej atij qendror, por e ka bërë të ditur se zonat kompakte të banuara nga serbët i konsideron si bazë për komuna të reja të cilave do të duhej t'ju dorëzohej në masë të konsiderueshme pushtet mbi policinë. Nëse Grupi i Kontaktit në muajt vijues do të kërkonte një rol për Beogradin në negocimin e decentralizimit në Kosovë, së pari do të duhej të lëshojë një deklaratë se decentralizimi duhet të diskutohej si pjesë përbërëse e një shteti funksional dhe kushtimisht të pavarur.

Me një garanci të tillë, shqiptarët duhet të ndihmojnë në krijimin e komunave të suksesshme me shumicë serbe në anën jugore të Ibrit, në mënyrë që të ruajnë unitetin territorial të Kosovës dhe do të duhej të ofrojnë garanci për të drejtat e komunave përballë autoriteteve qendrore në marrëveshje të reja kushtetuese. Kjo do të siguronte serbët se pushteti i transferuar tek ata në të ardhmen nuk do të mundet t'u merret me urdhëresë si dhe të përforcojë marrëdhëniet ndërmjet qeverisë qendrore dhe komunave drejtpërsëdrejti, duke mos lejuar nivele ndërmjetësuese territoriale apo qeveritare.

Shqiptarët do të duhej të kushtonin kujdes të veçantë për të lejuar që komuna e re e Graçanicës, në jug të Prishtinës, të zgjerohet në kufijtë që serbët lokal do t'i konsideronin si të natyrshme. Sa më e madhe dhe e fuqishme të bëhet (dhe do të jetë e rrethuar nga komunat e banuara me shumicë shqiptare) aq më tepër Serbia do të jetë e obliguar që ta konsiderojë atë në statusin final sesa të negocion për ndarje të Kosovës tek Ibri. Kufijtë e komunës së Graçanicës do të mund të shtriheshin në jug për të përfshirë fshatrat serbe dhe tokat e tyre bujqësore që tani i takojnë komunës së Lipjanit.

Prishtina fillimisht provoi të kufizojë pilot projektet e decentralizimit vetëm në fshatin e madh të Graçanicës pa zonat përreth. Pasi që Grupi i Kontaktit urdhëroi qeverinë ta marr sërish në shqyrtim, ajo erdhi me kufij më të gjerë, që përfshinin fshatin shqiptar me shkallë të lartë të rritjes, Hajvalinë dhe ende e përjashtonte nga strategjia fshatin matanë rrugës magjistrale, Çagllavicën. Ky riaranzhim nuk i kënaqte serbët e Çagllavicës pasi që do të krijonte një përzierje të barabartë të serbëve dhe shqiptarëve, duke siguruar një shumicë shqiptare në vitet e ardhshme. Ndërtimet e reja të shqiptarëve kanë arritur deri në skajin verior të kësaj zone, dhe serbët me arsye frikësohen se blerjet me rëndësi strategjike nga ana e shqiptarëve janë hapat e parë të largimit të serbëve nga komuniteti i tyre.[182] Qeveria, ngjashëm ka propozuar shtimin e një fshati shqiptarë në njësinë e komunës pilot të Parteshit që do të zvogëlonte shumicën serbe në minimum.

Partitë shqiptare të opozitës e sulmojnë qeverinë për akomodim të serbëve dhe të ndërkombëtarëve derisa nuk fitohen garanci të mjaftueshme për statusin final dhe gjoja se kjo mund të sjell ndarjen. Qeveria e konsideron propozimin e saj si operacion zotërues për të qetësuar komunitetin ndërkombëtarë dhe nuk ka pasur guximin të ofrojë ndonjë koncesion kuptimplotë serbëve para se të arrihet konsensusi për platformën e negociatave me opozitën. Por, koncesionet strategjike nevojiten tani. Siç është tani situata, propozimet e qeverisë ndihmojnë në arritjen e ambicieve latente të shqiptarëve për të fshirë prezencën e serbëve në qendër të Kosovës.

Kushtetuta e ardhshme e Kosovës, përveç skicimit të pushtetit dhe marrëdhënieve të komunave dhe autoriteteve qendrore, mundet poashtu të kodifikojë sistemin e propozuar ndër-ministror, jo territorial për edukim, shëndetësi dhe shërbime shëndetësore autonome, të cilat do t'i lejonin komunave serbe të koordinojnë politikat dhe zhvillimet pa u shkëputur nga qeveria qendrore. Pa koncesione eksplicite të një baze të "popullit themelues" për entitetin serb -- në kushtet e tanishme kjo do të ishte një hap drejt ndarjes -- kushtetuta do të ofronte një kombinim të zgjidhjeve institucionale që do t'iu mundësonin komunave në veri të ndërtojnë për ta diç shumë të ngjashme me rajone autonome. Komunat me shumicë serbe në veri të Ibrit munden poashtu të marrin pjesë në baza të shoqërimit vullnetar përmes njësive shërbyese serbe të ministrive qendrore relevante (të vendosura në Mitrovicë, Prishtinë dhe Graçanicë), që do të ndihmonte në koordinimin e iniciativave dhe mundësinë që komunat të bashkohen në miratimin e ligjeve në nivel komune. Autonomia virtuale e komunave në veriun e Kosovës me shumicë serbe mund të mbikëqyret nga ana e organit të përbashkët serbo-shqiptaro-ndërkombëtarë për koordinim të sigurisë në Mitrovicë, ashtu siç është propozuar.

Garanci të mëtejshme mund të mirren në konsideratë për të shtuar fuqinë joshëse të këtyre opcioneve për serbët e Kosovës dhe për vet Serbinë. Serbëve të Kosovës mund t'u ofrohet shtetësi e dyfishtë dhe garancione se kufiri me Serbinë të jetë i hapur dhe se cilido qoftë kodi të ri i sistemit telefonik për Kosovën në të ardhmen, thirrjet e tyre në Serbi nuk do të kushtonin sa tarifat e larta ndërkombëtare. Roli i Serbisë në mbështetjen e komunitetit Serb përmes institucioneve qendrore të qeverisë së Kosovës mund të vendoset përmes takimeve të rregullta në Mitrovicë, në prani ndërkombëtare, midis përfaqësuesve të qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Forume të tilla mund të luajnë rol të ngjashëm me trupat tej-kufitare të aranzhuara dhe dakorduara sipas modelit të zgjidhjes për

[182] Shih M. J. Radonjiq, "Albanski obruc oko Caglavice" (Unaza shqiptare rreth Çagllavicës), Veçernje Novosti, 2 gusht, 2005.

Irlandën Veriore[183] të vitit 1998 dhe mund të jenë pjesërisht të adaptuara nga grupet punuese të dialogut ekzistues Prishtinë-Beograd. Ato do t'i krijonin mundësi Beogradit, planifikimin dhe zhvilimin e jetës kulturore dhe sociale për të gjithë serbët e Kosovës. Serbët e veriut të Kosovës, do të mund ta gjejnë veten si qendër për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve për të gjithë së sbët e Kosovës. Kjo do të ishte ne dobi të tyre dhe rajoni I tyre do të vazhdonte të jetë I një interesi të veçantë I cili do të tërheqë investime ndërkomëtare, në vend se të mbeten një zonë e prapambetur ekonomikisht e jugut gjithashtu të prapambetur të Serbisë.

Pra, akomodimi I Veirut te Kosoves brenda saj siç u tha më lart do të sillte shume beneficione së pari për serbët atje.

**Prishtinë/Beograd/Bruksel, 13 shtator 2005**

[183] Marrëveshja e Belfastit e vitit 1998 (Seksioni 4) themeloi Këshillin Ministror Veri-Jug, i cili administron një numër të agjencive administrative me shtrirje në tërë Irlandën, që i përgjigjet autoriteteve autonome të Irlandës Veriore dhe qeverisë së Republikës së Irlandës. Këto kanë të bëjnë me rrugët ujore nëntoksore, sigurinë e marinës, sigurimin e ushqimit, promovimin e tregtisë, çështjet gjuhësore dhe administrimin e fondeve të BE-së. Shih webfaqen e Këshillit Ministror Veri-Jug, http://www.northsouthministerialcouncil.org

# SHTOJCA A

# HARTA E KOSOVËS



# SHTOJCA B

# HARTA E VERIUT TË KOSOVËS



# SHTOJCA C

# HARTA E MITROVICËS



(c) HCIC - Kosovo Community Information Center, adapted with permission by Crisis Group

## SHTOJCA D

## INDEXI I SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

| | |
|---|---|
| **B92** | Kanal radio-televiziv serb i pavarur dhe web-faqe |
| **QKK** | Qendra Koordinuese për Kosovë dhe Metohi e qeverisë së Serbisë dhe Malit të Zi |
| **COMKFOR** | Komandanti i KFOR-it, deri më 1 shtator 2005 ishte gjeneral Yves de Kermabon nga Franca, ndërsa tani është gjeneral Giuseppe Valotto nga Italia |
| **PDS** | Partia Demokratike e Serbisë, partia e Kryeministrit Koshtunica. |
| **ESI** | Iniciativa Evropiane për Stabilitet, organizatë që mirret me analiza. |
| **BE** | Bashkimi Evropian. |
| **EUA** | Shoqata Evropiane e Universiteteve. |
| **G-17 plus** | Parti politike në Serbi, pjesë e koalicionit qeverisës. |
| **HABITAT** | Drejtorati për Çështje Pronësore Banesore. |
| **TPNJ** | Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi. |
| **IDP** | Personat e zhvendosur përbrenda kufijve të vendit të tyre. |
| **IWPR** | Instituti për Raportim në Luftë e Paqe. |
| **KFOR** | Forca paqeruajtëse në Kosovë e udhëhequr nga NATO-ja. |
| **KIPRED** | Instituti kosovar për hulumtime dhe zhvillim të politikave, një OJQ kosovare dhe që mirret me analiza. |
| **UÇK** | Ushtria Çlirimtare e Kosovës. |
| **TMK** | Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, struktura trashëguese për mbrojtje civile e UÇK-së. |
| **SHPK** | Shërbimi Policor i Kosovës. |
| **AKM** | Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit. |
| **LDK** | Lidhja Demokratike e Kosovës, partia më e madhe politike në Kosovë, jozyrtarisht e udhëhequr nga Ibrahim Rugova. |
| **MPB (MUP)** | Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë. |
| **NATO** | Organizata e Traktit Atlantiko-Verior. |
| **OSBE** | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. |
| **PDK** | Partia Demokratike e Kosovës, trashëguese kryesore politike e UÇK-së dhe partia më e madhe opozitare, e udhëhequr nga Hashim Thaçi. |
| **IPVQ** | Institucionet e Përkohshme të Vet-Qeverisjes në Kosovë. |
| **PTS** | Kompania shtetërore për telekomunikacion e Serbisë. |
| **RTK** | Radio-Televizioni i Kosovës, shërbimi i transmetimit publik. |
| **KNS** | Këshilli Nacional Serb. |
| **SPS** | Partia Socialiste Serbisë, më parë e udhëhequr nga Sllobodan Millosheviq. |
| **PSSP** | Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, aktualisht Soren Jessen-Petersen nga Danimarka. |
| **UNDP** | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara. |
| **UNHCR** | Komisioneri i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara. |
| **UNMIK** | Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë. |
| **UNTAES** | Administrata e përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Sllavoninë Lindore (Kroaci, 1996-1998) |

# SHTOJCA E

# PËR GRUPIN NDËRKOMBËTAR TË KRIZAVE

Grupi Ndërkombëtar i Krizave (Grupi i Krizave) është organizatë e pavarur, joprofitabile dhe jo-qeveritare, me mbi 100 të punësuar në pesë kontinente, të cilët punojnë të parandalojnë dhe zgjidhin konfliktet e përgjakshme nëpërmjet analizave të gjendjes në terren dhe avokimit në nivelet e larta.

Puna e Grupit të Krizave bazohet në hulumtimet në terren. Ekipe të analistëve politikë janë të vendosur në apo afër vendeve të rrezikuara nga shpërthimi, eskalimi apo rishfaqja e një konflikti të dhunshëm. Bazuar në informacionet dhe vlerësimet nga terreni, përpilon raporte analitike që përmbajnë rekomandime praktike që u drejtohen vendim-marrësve kryesorë ndërkombëtarë. Grupi i Krizave publikon edhe *"Crisis Watch"*, broshurë mujore me dymbëdhjetë faqe në të cilat ofron përmbledhje të rregullta të gjendjes në të gjitha vatrat e krizës apo konfliktet potenciale nëpër botë.

Raportet si dhe broshurat tjera të Grupit të Krizave u shpërndahen, nëpërmjet postës elektronike apo të shtypura, zyrtarëve të ministrive të jashtme dhe organizatave ndërkombëtare e në të njëjtën kohë vihen në dispozicion edhe në faqen në Internet, në www.crisisgroup.org. Grupi i Krizave bashkëpunon afër me qeveritë dhe me ata që kanë ndikim në to, përfshirë edhe mediat, për t'i vënë në vëmendje të tyre, sa më shumë që të jetë e mundur, analizat e krizave si dhe për të siguruar përkrahje për politikat që i rekomandon.

Bordi i Grupit të Krizave -- që përbëhet nga personalitete prominente nga fusha e politikës, diplomacisë, biznesit dhe mediave -- është i angazhuar në mënyrë të drejtë për drejtë që të bëjë që raportet dhe rekomandimet të merren parasyshë nga nivele më të larta të polikë-bërjes në tërë botën. Grupi i Krizave kryesohet nga Lordi Patten nga Barnes, ish-Komisioner Evropian për Marrëdhënie të Jashtme. Kryetar dhe Shef i Ekzekutivit që nga janari i vitit 2000 është ish-Ministri i Jashtëm i Australisë, Gareth Evans.

Grupi i Krizave selinë ndërkombëtare e ka në Bruksel dhe ka zyre për avokim në Washington DC (ku është e vendosur si subjekt ligjor), New York, Londër dhe Moskë. Organizata aktualisht ka nëntëmbëdhjetë zyre në terren (në Amman, Beograd, Bishkek, Dakar, Dushanbe, Islamabad, Gjakartë, Kabul, Nairobi, Pretoria, Prishtinë, Quito, Seul, Shkup and Tbilisi), me analistë që veprojnë në më tepër se 50 vende the territore të prekura nga krizat në katër kontinente. Në Afrikë vepron në Angolë, Burundi, Bregun e Fildishtë, Republikën Demokratike të Kongos, Eritre, Etiopi, Guine, Liberi, Ruandë, rajoni Sahel, Sierra-Leone, Somali, Sudan, Ugandë and Zimbabve; në Azi në Afganistan, Indonezi, Kashmir, Kazakistan, Kirgistan, Mjanmar/Burma, Nepal, Kore e veriut, Pakistan, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Uzbekistan; në Evropë, në Shqipëri, Armeni, Azerbaixhan, Bosnjë e Hercegovinë, Gjeorgji, Kosovë, Maqedoni, Moldovë, Mal i Zi e Serbi; në Lindjen e Mesme, në tërë pjesën nga Afrika Veriore deri në Iran; si dhe në Amerikën Latine, në Kolumbi, rajonin e Andeve dhe në Haiti.

Grupi i Krizave mbledh fonde nga qeveri, fondacione bëmirëse, kompani dhe donatorë individualë. Fonde aktualisht sugurohen nga këto departamente dhe agjensi qeveritare: Agence Intergouvernementale de la francophonie, Australian Agency for International Development, Austrian Federal Ministry of Foreign Affairs, Belgian Ministry of Foreign Affairs, Canadian Department of Foreign Affairs and International Trade, Canadian International Development Agency, Canadian International Development Research Centre, Czech Ministry of Foreign Affairs, Dutch Ministry of Foreign Affairs, Finnish Ministry of Foreign Affairs, French Ministry of Foreign Affairs, German Foreign Office, Irish Department of Foreign Affairs, Japanese International Cooperation Agency, Principality of Liechtenstein Ministry of Foreign Affairs, Luxembourg Ministry of Foreign Affairs, New Zealand Agency for International Development, Republic of China (Taivan) Ministry of Foreign Affairs, Royal Danish Ministry of Foreign Affairs, Royal Norwegian Ministry of Foreign Affairs, Swedish Ministry for Foreign Affairs (Suedi), Swiss Federal Department of Foreign Affairs, Turkish Ministry of Foreign Affairs, United Kingdom Foreign and Commonwealth Office, United Kingdom Department for International Development, U.S. Agency for International Development.

Donatorët e sektorit privat dhe fondacioneve përfshijnë Atlantic Philanthropies, Carnegie Corporation nga Nju Jorku, Compton Foundation, Ford Foundation, Fundação Oriente, Fundación DARA Internacional, Bill & Melinda Gates Foundation, William & Flora Hewlett Foundation, Hunt Alternatives Fund, Korea Foundation, John D. & Catherine T. MacArthur Foundation, Moriah Fund, Charles Stewart Mott Foundation, Open Society Institute, Pierre and Pamela Omidyar Fund, David and Lucile Packard Foundation, Ploughshares Fund, Sigrid Rausing Trust, Rockefeller Foundation, Rockefeller Philanthropy Advisors and Sarlo Foundation of the Jewish Community Endowment Fund.

**shtator 2005**

# SHTOJCA F

# RAPORTET DHE PUBLIKIMET TJERA PËR EVROPË TË GRUPIT TË KRIZAVE QË NGA VITI 2002

***Rishikim i aftësive të BE-së për t'u përballur me kriz***a, Raport për Evropë numër 160, 17 janar 2005

## BALLKAN

***Udhëzues për Kosovën I: Çështja e statusit fina***l, Raport për Evropë numër 124, 28 shkurt 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe atë serbe)

***Udhëzues për Kosovën II: Standardet e brendshm***e, Raport për Evropë numër 125, 1 mars 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe atë serbe)

***Stagnimi i reformave në Beograd: Shkak për shqetësim ndërkombëtar,*** Raport për Evropë numër 126, 7 mars 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën serbe)

***Dështimi i gjyqësisë: Keq-sundimi i ligjit në Bosnjë e Hercegovin***ë, Raport për Evropë numër 127, 26 march 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën boshnjake)

***Serbi: Intervenimi ushtarak kërcënon reformat demokratik***e, Raport për Evropë numër 25, 28 mars 2002 (në dipozicion edhe në gjuhën serbe)

***Implementimi i barazisë: Vendimet e "popullit votues" në Bosnjë e Hercegovin***ë, Raport për Evropë numër 128, 16 Prill 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën boshnjake)

***Ende duke blerë kohë: Mali i Zi, Serbia dhe Bashkimi Evropia***n, Raport për Evropë numër 129, 7 maj 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën serbe)

***Vëzhgimi i policisë në Bosnjë: Agjenda e reformave të mëtutjeshm***e, Raport për Evropë numër 130, 10 maj 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën boshnjake)

***Barra më e rëndë e UNMIK-ut në Kosovë: Qasja ndaj ndarjes së Mitrovicës:*** Raport për Evropë numër 131, 3 qershor 2002 (në dispozicion edhe në gjuhen shqipe dhe në ate serbe)

***Lufta për të kontrolluar forcat ushtarake jugosllave,*** brifing për Evropë numër 26, 12 korrik 2002

***Aleanca për ndërrime (të vogla) në Bosnj***ë, Raport për Evropë numër 132, 2 gusht 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën boshnjake)

***Sekreti public i Maqedonisë: Si po e fundosë vendin korrupcion***i, Raport për Evropë numër 133, 14 gusht 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën maqedone)

***Në kërkim të barazisë: Nivelet e drejtësisë në Kosov***ë, Raport për Evropë numër 134, 12 shtator 2002

***Bërja e Maqedonisë e vet-mjaftueshme: Qasje e re sigurisë për NATO-n dhe BE-n***ë, Raport për Evropë numër 135, 15 nëntor 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën maqedone)

***Armët e Sadamit: Lidhja jugosllav***e, Raport për Evropë numër 136, 3 dhjetor 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën serbe)

***Sfida e përhershme e kthimit të refugjatëve në Bosnjë e Hercegovin***ë, Raport për Evropë numër 137, 13 dhjetor 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën boshnjake)

***Mirëseardhje me gjysëm-goje: Kthimi i refugjatëve në Kroac***i, Raport për Evropë numër 138, 13 dhjetor 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën kroate)

***Kthimi në pasiguri: Të zhvendosurit e Kosovës dhe procesi i kthimi***t, Raport për Evropë numër 139, 13 dhjetor 2002 (në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe atë serbe)

***Shqipëri, në çfarë gjendje është kombi, 200***3, Raport për Evropë numër 140, 11 mars 2003

***Serbia pas Gjingjiqi***t, Raport për Evropë numër 141, 18 mars 2003

***Martesa e pakëndshme: Mali i Zi 200***3, Raport për Evropë numër 142, 16 prill 2003

***Dilema etnike e Kosovës: Nevoja për një kontratë social***e, Raport për Evropë numër 143, 28 maj 2003 (në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe atë serbe)

***Bërçko e Bosnjës: Të hysh, të pastrosh, të shkos***h, Raport për Evropë numër 144, 2 qershor 2003

***Selaniku dhe pas tij I: Agjenda e BE-së për Ballkani***n, Brifing për Evropë numër 27, 20 qershor 2003

***Selaniku dhe pas tij II: BE-ja dhe Bosnj***a, Brifing për Evropë numër 28, 20 qershor 2003

***Selaniku dhe pas tij III: BE-ja, Serbia, Mali i Zi dhe Kosov***a, Brifing për Evropë numër 29, 20 qershor 2003

***Reformat në Serbi ndalen përsër***i, Raport për Evropë numër 145, 17 korrik 2003 (në dispozicion edhe në gjuhën serbe).

***Qeveritë nacionaliste të Bosnjës: Paddy Ashdown dhe paradokset e shtet-ndërtimi***t, Raport për Evropë numër 146, 22 korrik 2003.

***Dy për Tango: Agjendë për PSSP-në e r***i, Raport për Evropë numër 148, 3 shtator 2003 (në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe atë serbe)

***Maqedoni: Nuk ka kohë për kënaqës***i, Raport për Evropë numër 149, 23 tetor 2003 (në dispozicion edhe në gjuhën maqedone)

***Ndërtimi i urave në Mosta***r, Raport për Evropë numër 150, 20 nëntor 2003 (në dispozicion edhe në gjuhën boshnjake)

***Paqja e brishtë në Serbinë Jugor***e, Raport për Evropë numër I52, 9 dhjetor 2003

***Monitorimi i armëpushimit në Irlandën Veriore: Mësimet nga Ballkan***i, Brifing për Evropë numër 30, 23 janar 2004

***Pan-shqiptarizmi: sa vërtetë e kërcënon stabilitetin e Ballkanit?,*** Raport për Evropë numër 153, 25 shkurt 2004 (në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe në atë serbe)

***Kthim prapa në Serb***i, Raport për Evropë numër 54, 26 mars 2004

***Kollapsi në Kosov***ë, Raport për Evropë numër 155, 22 prill 2004 (në dispozicion edhe në gjuhën shqipe dhe në atë serbe)

***EUFOR: Ndërrimi i mekanizmit të sigurisë në Bosnj***ë, Brifing për Evropë numër 31, 29 qershor 2004 (në dispozicion edhe në gjuhën boshnjake)

***Relievi i ndryshueshëm politik në Serb***i, Brifing për Evropë numër 32, 22 korrik 2004

***Maqedoni: Pajtim a ndarj***e, Brifing për Evropë numër 33, 3 gusht 2004

***Kosova: Drejt Statust Final***, Raport për Evropë nr.161, 24 janar 2005 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse, shqipe dhe në atë serbe)

***Maqedonia: Ende jo jashtë pyjeve***, Brifing për Evropë nr.37, 25 shkurt 2005

***Sanxhaku i Serbisë: Ende i harruar***, Raport për Evropë nr.162, 7 prill 2005 (në dispozicion edhe në gjuhën serbe)

***Sërbia: Rrotullimi i rrotave***, Brifing për Evropë nr.39, 23 maj 2005 (në dispozicion edhe në gjuhën serbe)

***Kosova pas Haradinajt***, Raport për Evropë nr.163, 26 maj 2005 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse, shqipe dhe në atë serbe)

***Reforma policore e ndalur në Bosnë Bosnia's Stalled Police Reform: Pa progres, Jo BE***, Raport për Evropë nr.164, 6 shtator 2005

## CAUCASUS

***Gjeorgji: Çka tash***?, Raport për Evropë numër 151, 3 dhjetor 2003 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse)

***Azerbeixhan: Faqe e re***?, Raport për Evropë numër 156, 13 maj 2004 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse)

***Suksesi i Saakashvili Ajara: A mund të përsëritet në pjesët tjera të Gjorgjisë***? Brifing për Evropë numër 34, 18 gusht 2004 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse)

***Armeni: Destabilizimi i brendshëm ka zënë prit***ë, Raport për Evropë numër 158, 18 tetor 2004 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse)

***Gejorgji: Evritimi i luftës në Osetinë Jugor***e, Raport për Evropë numër 159, 26 nëntor 2004 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse)

***Georgji-Eseti jugore: refugjatët e sjellin prapa rrugën për paqe***, Brifing për Evropë nr.38, 19 prill 2005 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse)

## MOLDOVË

***Moldovë: Pa shërim të shpejt***ë, Raport për Evropë numër 147, 12 gusht 2003

***Moldovë: Tensionet rajonale rreth Transdniestris***ë, Raport për Evropë numër 157, 17 qershor 2004 (në dispozicion edhe në gjuhën ruse)

## RAPORTET DHE PUBLIKIMET TJERA

Për raportet dhe publikimet tjera të Grupit të Krizave për:

- Azi
- Afrikë
- Amerikë latine dhe Karaibe
- Lindje të Mesme dhe Afrikë Veriore
- Çështjet tematike
- *CrisisWatch*

ju lutem na vizitioni në: www.crisisgroup.org

# SHTOJCA G

# ANËTARËT E BORDIT TË GRUPIT TË KRIZAVE

*Kryesues*

**Lord Patten of Barnes**
Ish-Komisioner Evropian për Marrëdhënie me Jashtë, Britani e Madhe

*Kryetar dhe Shef i Ekzekutivit*

**Gareth Evans**
Ish-Ministër i Jashtëm i Australisë

*Komiteti Ekzekutiv*

**Morton Abramowitz**
Ish-Ndihmës i Sekretarit të Shtetit të SHBA-së dhe Ambasador në Turqi

**Emma Bonino**
Anëtare e Parlamentit Evropian; ish-Komisionere Evropiane

**Cheryl Carolus**
Ish-Komisioner i Lartë i Afrikës së Jugut në Britaninë e madhe; ish-Sekretar i Përgjithshëm i ANC.

**Maria Livanos Cattaui***
Sekretar i Përgjithshëm, Oda Ekonomike Ndërkombëtare

**Yoichi Funabashi**
Korrespodent dhe columnist diplomatic, "The Asahi Shimbun",në Japoni

**William Shawcross**
Gazetar dhe shkrimtar, Britani e Madhe

**Stephen Solarz***
Ish-Kongresmen amerikan

**George Soros**
Kryesues ,"Open Society Institute"

**William O. Taylor**
Kryesues "Emeritus", "The Boston Globe", SHBA

**Vice-Chair*

**Adnan Abu-Odeh**
Ish-Këshilltar Politik i Mbretit Abdullah II dhe Mbretit Hussein; ish-përfaqësues permanent i Jordanisë në OKB

**Kenneth Adelman**
Ish-Ambasador amerikan dhe Drejtor i Agjensisë për Kontrollimin e Armatimit dhe Çarmatim

**Ersin Arioglu**
Anëtar i Parlamentit, Turqi; Kryesues "Emeritus", Grupi "Yapi *Merkezi"*

**Diego Arria**
Ish-Ambasador i Venecuelës në OKB

**Zbigniew Brzezinski**
Ish-Këshilltar për Siguri Kombëtare i Kryetarit të SHBA-së

**Victor Chu**
Kryesues, "First Eastern Investment Group", Hong Kong

**Wesley Clark**
Ish-Komandant Suprem për Evropë i NATO-s

**Pat Cox**
Ish-Kryetar i Parlamentit Evropian

**Ruth Dreifuss**
Ish-kryetar, Zvicër

**Uffe Ellemann-Jensen**
Ish-Ministër i Jashtëm, Danimarkë

**Mark Eyskens**
Ish-kryeministër, Belgjikë

**Leslie H. Gelb**
*Kryetare emeritus e Këshillit për marrëdhënie me jashtë, SHBA.*

**Bronislaw Geremek**
Ish-Ministër i Jashtëm, Poloni

**I.K. Gujral**
Ish-Kryeministër, Indi

**Carla Hills**
Ish-Sekretare e çështjeve rezidente, SHBA; ish-përfaqësuese për tregti e SHBA-së.

**Lena Hjelm-Wallén**
Ish—Zëvendës Kryeminisre dhe Ministre e Punëve të Jashtme, Suedi

**James C.F. Huang**
Ish-Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm i Kryetarit, Taiwan

**Swanee Hunt**
Themeluese dhe kryesuese e "Women Waging Peace"; ish-Ambasadore e SHBA-së në Austri

**Asma Jahangir**
Raportuese Speciale e OKB-së për Ekzekutimet e paligjshme e abritrare; ish-kryesuese e Komisionit për të drejtat e njeriut në Pakistan

**Shiv Vikram Khemka**
Themelues dhe Drejtor Ekzekutiv (Rusi) i "SUN Group", Indi

**James V. Kimsey**
Themelues dhe Kryesues "Emeritus" i "America Online, Inc."(*AOL)*

**Bethuel Kiplagat**
Ish-Sekretar Permanent, Ministria e Punëve të Jashtme, Keni

**Wim Kok**
Ish-Kryeministër, Holandë

**Trifun Kostovski**
Anëtar i parlamentit, Maqedoni; themelues i "Kometal Trade Gmbh"

**Elliott F. Kulick**
Kryesues, "Pegasus International", SHBA.

**Joanne Leedom-Ackerman**
Gazetare dhe noveliste, SHBA.

**Todung Mulya Lubis**
Shkrimtar dhe avokat për të drejtat e njeriut, Indonezi

**Ayo Obe**
Kryesues i Komitetit Drejtues të "World Movement for Democracy", Nigeri

**Christine Ockrent**
Gazetare dhe shkrimtare, Francë

**Friedbert Pflüger**
Ish-Zëdhënës për punë të jashtme i Grupit Parlamentar CDU/CSU në Bundestagun gjerman

**Victor M. Pinchuk**
Anëtar i parlamentit, Ukrainë; themelues i "Interpipe Scientific and *Industrial Production Group"*

**Surin Pitsuwan**
Ish-Ministër i Punëve të Jashtme, Tailandë

**Itamar Rabinovich**
Kryetar i Universitetit të Tel-Avivit; ish-Ambasador i Izraelit në SHBA dhe krye-negociator me Sirinë

**Fidel V. Ramos**
Ish-Kryetar i Filipineve

**Lord Robertson of Port Ellen**
Ish-Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s; ish-Sekretar i Mbrojtjes, Britani e Madhe

**Mohamed Sahnoun**
Këshilltar Special për Afrikë i Sekretarit të Përgjithshëm të *Kombeve tëBashkuara*

**Ghassan Salamé**
Ish-Ministër, Liban; professor i Mardhënieve ndërkombëtare, Paris

**Salim A. Salim**
Ish-kryeministër i Tanzanisë; ish-Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës së Unitetit Afrikan

**Douglas Schoen**
Partner themelues i "Penn, Schoen & Berland Associates", SHBA.

**Pär Stenbäck**
Ish-Ministër i Jashtëm, Finlandë

**Thorvald Stoltenberg**
Ish-Ministër i Jashtëm, Norvegji

**Grigory Yavlinsky**
Kryesues i partiesë "Yabloko"dhe fraksionit në Dumë, Rusi

**Uta Zapf**
Kryesues i Nën-komitetit të Bundestagut gjerman për çarmatim, kontrollim të armatimit dhe mos-shtim

**Ernesto Zedillo**
Ish-kryetar i Meksikos; Drejtor i "Yale Center for the Study of *of Globalization"*

## BORDI KËSHILLËDHËNËS NDËRKOMBËTAR

*Bordi Këshillëdhënës Ndërkombëtar i Grupit të Krizave përbëhet nga donatorë të mëdhenj individualë e korporata, që kontribuojnë në mënyrë të rregullt në punën e Grupit të Krizave me këshilla dhe ekspertizë.*

**Rita E. Hauser (Kryesuese)**

**Marc Abramowitz**
**Anglo American PLC**
**APCO Worldwide Inc.**
**John Chapman Chester**
**Peter Corcoran**
**Credit Suisse Group**
**John Ehara**
**Equinox Management Partners**
**Thomas Harley**
**JP Morgan Global Foreign Exchange and Commodities**
**George Kellner**
**George Loening**
**Douglas Makepeace**
**Anna Luisa Ponti**
**Quantm**
**Michael L. Riordan**
**Sarlo Foundation of the Jewish Community Endowment Fund**
**Baron Ullens**
**Stanley Weiss**
**Westfield Group**
**Yasuyo Yamazaki**
**Sunny Yoon**

## KËSHILLTARËT E LARTË

*Këshilltarët e lartë të Grupit të Krizave janë ish-anëtarë të Bordit (që aktualisht nuk mbajnë poste ekzekutive) që mbajnë lidhje me Grupin e Krizave dhe këshillat e përkrahja e të cilëve kërkohet kohë pas kohe.*

Oscar Arias
Zainab Bangura
Christoph Bertram
Jorge Castañeda
Eugene Chien
Gianfranco Dell'Alba
Alain Destexhe
Marika Fahlen
Stanley Fischer
Malcolm Fraser
Max Jakobson
Mong Joon Chung
Allan J. MacEachen
Barbara McDougall
Matt McHugh
George J. Mitchell
Cyril Ramaphosa
Michel Rocard
Volker Ruehe
Simone Veil
Michael Sohlman
Leo Tindemans
Ed van Thijn
Shirley Williams

**Deri në shtator 2005**